

**DEMOKRACIA KRISTIANE:
PARIME DHE POLITIKËBËRJE**

**MANUAL PËR BASHKËPUNIMIN EVROPIAN DHE NDËRKOMBËTAR
TË FONDACIONIT KONRAD-ADENAUER**

Botues

Fondacioni Konrad Adenauer

Konceptimi

Katja Plate, Drejtore e programit rajonal për Dialog Politik në Kaukazin Jugor

Karsten Grabow, Ekspert për Bashkëpunimin Ndërkombëtar midis Partive dhe Parlamenteve

Redaktimi

Karsten Grabow

Email: Karsten.Grabow@kas.de

Tel.: +49 (0)30 26996 32 46

Asistenca

Tim Kallweit, Isabel von Griesheim

Autorë

Nino Galetti (3.4)

Karsten Grabow (kapitulli 1; kapitulli 2 me Manfred Agethen, Rudolf Uertz dhe Reinhard Willig; 3.1 dhe 3.2 me Matthias Schäfer)

David Jonathan Grunwald (4.2)

Christine Henry-Huthmacher (3.3)

Tim Kallweit, Christopher Beckmann (4.1; 4.3-4.7)

Patrick Keller dhe Anika Wirtz (3.5)

Helmut Reifeld (3.6)

Wolfgang Stock (4.8)

Ekspertë

Christopher Beckmann

Prof. Dr. Hanns Jürgen Küsters

Frank Spengler

Prof. Dr. Hans-Joachim Veen

Prof. Dr. Bernhard Vogel, ish-Kryeministër

Klaus Weigelt

www.kas.de

Për të gjitha pjesët e këtij botimi mbrohet e drejta e autorit. Çdo përdorim duhet të miratohet nga Fondacioni Konrad Adenauer e.V. Kjo vlen veçanërisht për shumfishimet, përthimet, mikrofilmimet dhe ruajtjen në sisteme elektronike dhe përpunimin nga këto sisteme.

© 2010, Fondacioni Konrad-Adenauer e.V., Sankt Augustin/Berlin

Formati: SWITSCH Kommunikationsdesign, Këln. Botuar me mbështetjen financiare të Republikës Federale Gjermane. Printed in Germany.

ISBN 978-3-941904-88-0

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

1. DEMOKRACIA KRISTIANE: ÇFARË PËRFAQËSON?

2. HISTORIA E ZHVILLIMIT TË DEMOKRACISË KRISTIANE NË EVROPË

2.1. Teoria kristian-demokrate dhe politika në periudhën midis luftërave botërore

2.2. Demokracia kristiane që prej 1945

3. POLITIKA KRISTIAN-DEMOKRATE NË DITËT E SOTME:

FUSHA TË PËRZGJEDHURA NGA POLITIKA

3.1. Politika ekonomike

3.2. Politika sociale

3.3. Politika familjare

3.4. Politika mjedisore

3.5. Politika e jashtme dhe politika e sigurisë

3.6. Solidariteti ndërkombëtar dhe bashkëpunimi për zhvillim

4. KRISTIANDEMOKRATË TË NJOHUR NË EVROPË

4.1. Konrad Adenauer

4.2. Ludvik Erhard

4.3. Alcide De Gasperi

4.4. Robert Shuman

4.5. Helmut Kol

4.6. Vilfrid Martens

4.7. Jean-Claude Juncker

4.8. Angela Merkel

5. BURIMET DHE LITERATURË SHITESË

AUTORËT DHE BASHKËPUNËTORËT

PARATHËNIE

Prej disa dekadash Partitë Kristian-Demokrate janë përcaktuese në politikën e shumë shteteve evropiane dhe në procesin e bashkimit të Evropës, të cilin ato e kanë iniciuar dhe ndërtuar me sukses. Për Fondacionin Konrad Adenauer, i cili që prej vitit 1964 mban emrin e Kancelarit të parë gjerman, vlerat e Demokracisë Kristiane dhe emri që ai mban janë njëkohësisht mision dhe detyrim. Modeli i punës sonë është botëkuptimi kristian për njeriun si një krijesë e Zotit me vlera të njëjta, me individualitet dhe dinjitet të veçantë dhe si krijesë jo e përkryer. Mbi këtë bazë Fondacioni Konrad Adenauer angazhohet në Gjermani, në Evropë dhe në mbarë botën për mbështetjen e demokracisë së lirë, bazave të shtetit të së drejtës dhe të Ekonomisë Sociale të Tregut. Parimet tona janë liria, drejtësia dhe solidariteti.

Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar nuk synohet që “të eksportohen” tek të gjitha shtetet partnere koncepte të parapërgatitura mbi demokracinë dhe Ekonominë Sociale të Tregut. Qëllimi i angazhimit ndërkombëtar të KAS-it është para së gjithash dhënia e kontributit së bashku me partnerët tanë lokalë për zhvillimin dhe stabilizimin e demokracisë, vlerave të saj themelore, politikave dhe institucioneve të tyre. Vlerat e Demokracisë Kristiane nga njëra anë dhe politikat konkrete bazuar mbi këto vlera nga ana tjetër janë orientim dhe mbështetje për ndërmarrjen e politikave të rëndësishme. Pikërisht Ekonomia Sociale e Tregut mund të jetë një shembull, i cili mund të kontribuojë për kalimin e pasojave të krizës globale financiare dhe ekonomike dhe për zhvillimin e qëndrueshëm në shtetet ku realizohen projektet tona.

Kjo broshurë është një vështrim i përgjithshëm mbi vlerat e Demokracisë Kristiane, historinë e zhvillimit të saj dhe qëndrimet kristian-demokrate në sektorë të përzgjedhur të politikës. Përveç kësaj në fund të broshurës ndodhen të dhëna biografike për disa kristian-demokratë evropianë të rëndësishëm. Kjo broshurë është një produkt i përbashkët i disa departamenteve të Fondacionit Konrad Adenauer, e cila para së gjithash mund t’u vihet në dispozicion filialeve jashtë shtetit, në mënyrë që gjatë punës së projektit të Fondacionit në mbarë botën të vihen në zbatim ide, vlera dhe politika të Demokracisë Kristiane. Unë i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtorët e Fondacionit Konrad Adenauer, të cilët kanë kontribuar për realizimin e kësaj broshure. Një falënderim i veçantë shkon për ish-drejtorin e hulumtimeve në KAS, Prof.Dr. Hans-Joachim Veen, i cili në ditët e sotme është drejtuesi i Fondacionit Ettersberg në Vaimar dhe për Drejtuesin e Agjencisë për Konsulencë Mediatike dhe PR Coinvincet GmbH, Prof.Dr. Wolfgang Stock, për bashkëpunimin e tyre miqësor.

Dr. Gerhard Wahlers

Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Fondacionit Konrad Adenauer

1. DEMOKRACIA KRISTIANE: ÇFARË PËRFAQËSON AJO?

Demokracia Kristiane është një lëvizje politike, e cila u formua në Evropë në mesin e shek. 19 (Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Holandë, Austri dhe Zvicër). Rrënjët e saj organizative gjendeshin kryesisht në Shoqatat katolike në fushat e kulturës, shërbimeve sociale dhe të grupimeve të punëtorëve, prej të cilave u krijuan parti politike (shikoni kapitullin 2). Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore u themeluan Parti Kristian-Demokrate, të cilat si parti popullore ndërfitare u drejtoheshin kryesisht të gjitha shtresave të popullsisë dhe i integronin ato politikisht. Krijimi i një Unioni politik me të krishterët e dy feve (dhe krahas tyre me mbështetësit liberalë dhe konservatorë) nga Kancelari i parë gjerman dhe Kryetari shumëvjeçar i CDU-së Konrad Adenauer ishte shumë i rëndësishëm për suksesin e vazhdueshëm të Demokracisë Kristiane në Gjermani.

Prej dekadash Partitë Kristian-Demokrate janë përcaktuese në politikën e shumë shteteve evropiane dhe në procesin e bashkimit evropian, i cili është iniciuar dhe ndërtuar me sukses prej tyre. Etika sociale e kishave kristiane, tradita liberale e edukimit dhe e përkujdesjes ndaj vlerave qytetare, lidhjeve dhe mënyrave të jetesës, dhe para së gjithash familja si njësi më e vogël sociale përbëjnë bazat shpirtërore dhe politike të Demokracisë Kristiane. ***Modeli i Demokracisë Kristiane është koncepti kristian për njeriun.*** Ai mbështetet tek individualiteti i veçantë dhe dinjiteti i paprekshëm i çdo njeriu. Sipas konceptit kristian për njeriun, njeriu nuk është eksponent i një klase sociale – si për shembull në marksizëm – por është unik dhe i paprekshëm. Në dallim nga ideologjitë totalitare koncepti kristian për njeriun nuk synon formimin e “një njeriu të ri”, por e pranon njeriun, ashtu si ai është, me të mirat, dobësitë dhe kufijtë e tij. Dinjiteti i paprekshëm i gjithsecilit nuk do të thotë individualizëm i pakufizuar. Koncepti kristian për njeriun e vë theksin më shumë tek natyra e dyfishtë e tij: njeriu është një individ me të drejta të patjetërsueshme dhe qenie sociale, e cila realizohet vetëm gjatë bashkëjetesës me njerëzit e tjerë. Derivat i këtij koncepti të Demokracisë Kristiane për njeriun është e drejta e gjithsecilit për pjesëmarrje aktive, me të drejta të barabarta dhe përgjegjshmëri në politikë dhe shoqëri.

INFORMACIONE SHITESË: ETIKA SOCIALE KRISTIANE

Teoria sociale katolike dhe Etika sociale evangjeliste përbëjnë bërthamën e historisë së përmbajtjes të Etikës sociale kristiane. Ato u zhvilluan në shek. XIX si reagim ndaj ndryshimeve shoqërore gjatë industrializimit (formulimi i një doktrine sociale ortodokse ka vijuar më vonë për shkak të situatës politike midis viteve 1917 dhe 1989). Më parë etika merrej me faktin, se cilat opinione dhe veprime të njerëzve konsiderohen “të mira” (etika individuale) apo se cili shtet mund të konsiderohet “i mirë” (etika politike). Me ndryshimin e jetës ekonomike dhe sociale në shek. XIX nevojitej një etikë e bashkëjetesës shoqërore në shoqërinë e industrializuar (etika personale dhe etika sociale apo teoria e etikës sociale).

Teoria sociale katolike lindi gjatë trajtimit të çështjes sociale dhe të teorive ekonomike të Liberalizmit dhe të Socializmit që konkurronin njëra-tjetrën dhe u ndikuan ndjeshëm nga Enciklikat (qarkore e përgjithshme) e Papës Leo XIII. (*Renum Novarum*, 1891) dhe Piu XI. (*Quadragesimo Anno*, 1931).

Ndërsa Liberalizmi e priste “mirëqenien e kombeve” nga liria e tregjeve, Socializmi dhe më vonë para së gjithash Komunizmi ishin të bindur për domosdoshmërinë e luftës së klasave, e cila në një proces historik do të çonte nëpërmjet “diktaturës së proletariatit” tek një shoqëri pa klasa. Nuk u kundërshtua teoria e rendit liberal, por programi i socialistëve: ky program nuk ofronte një zgjidhje të shpejtë dhe dëmtonte vetë klasën punëtore. Në kundërshtim me Liberalizmin Leo XIII kërkoi një barazi pagash, e cila e bënte relativ parimin e pastër të tregut, vlerësoi lirinë e krijimit të koalicioneve (lirinë për krijimin e sindikatave) të punëtorëve si e drejtë natyrale dhe kërkoi një politikë sociale shtetërore në mbështetje të punëtorëve. Pra, për të ishte e mundur që liria, si vlerë themelore, dhe dy institucionet e tregut që lidhen me atë, të bashkohen në mënyrë të tillë me idenë e barazisë sociale, që midis tyre të krijohej një balancim në funksion të rendit ekonomik.

Etika sociale evangjeliste, e cila bazohet në punimet e teologëve Alexander von Oettingen (*Statistika e moralit dhe teoria kristiane për traditat*, 1867), Adolf von Harnack (veçanërisht *Thelbi i Krishërimit*, 1900) dhe Ernst Troeltsch (*Teoritë sociale të kishave dhe grupimeve kristiane*, 1912), krahas çështjes sociale (krijimi i institucioneve bamirëse për të ndihmuar të varfrit) iu përkushtua para së gjithash çështjeve morale dhe zakonore, raporteve midis njerëzve dhe përgjegjësisë – si të gjithsecilit për veten e tij ashtu edhe përgjegjësisë kolektive. Kështu nuk ka vetëm përgjegjësi të një sipërmarrësi, por edhe të sipërmarrjeve, jo vetëm përgjegjësi të një shkencëtari, por edhe të shkencës, jo vetëm përgjegjësi të një politikani, por edhe të politikës. Nga kritika e marrëdhënieve sociale të kohës në periudhën rreth fundit të shekullit (shek. 19/20) Etika sociale evangjeliste u përpoq të përcaktonte norma morale për rendin e shoqërisë moderne. Një rol të rëndësishëm ka luajtur këtu raporti konfliktual midis rregullave të brendshme të mundshme p.sh. zhvillimeve ekonomike apo sociale dhe përgjegjësisë së kufizuar të njeriut, e cila lind prej tyre.

Bërthama e Etikës sociale kristiane është subsidiariteti. Ky term e ka prejardhjen nga *subsidium* (“rezervë, zëvendësim”). Pra kuptimi i fjalës “subsidiaritet” është i qartë: njësitë e vogla të shoqërisë si familja, bashkitë apo komunitat duhet të jenë aktorët e vërtetë të jetës shoqërore, ata duhet të jenë në gjendje t’i japin formë përgjegjësisë së tyre në jetë. Shteti dhe njësitë shoqërore të niveleve më të larta qëndrojnë fillimisht si “rezervë”, dmth. ata aktivizohen vetëm kur njësitë më të vogla nuk është në gjendje të bëjnë një jetë të përgjegjshme. Pra shteti ushtron vetëm një funksion ndihmës dhe shërbyes ndaj njësitë më të vogla. Parimi i subsidiaritetit përbëhet nga dy komponentë: “privati përpara shtetit” dhe “i vogli përpara të madhit”. Formulimi klasik i parimit të subsidiaritetit gjendet në Enciklikën e Piu të XI-të *Quadragesimo Anno* të vitit 1931. Atje thuhet: “[...] Ashtu si çdo njeriu nuk mund t’i marrësh atë që ai e realizon me iniciativën e vet dhe me fuqitë e veta [...], po ashtu është në kundërshtim me drejtësinë, që ajo çka realizojnë qeniet më të vogla dhe të shtresave të ulëta [...], të merret nga shoqëria tjetër dhe e shtresave më të larta.”

Paraqitja sipas: Roos (2005), Honecker (2006), Koecke dhe Sieben (2010: 16-17).

Nga pranimi i dinjitetit dhe lirisë individuale të njeriut si edhe i teorisë, se njeriu është një subjekt aktiv, me ndërgjegje, i pajisur me përgjegjësi dhe aftësi gjyquese, lindin orientime dhe qëllime politike bazë të Demokracisë Kristiane:

1. Respektimi i demokracisë së lirë dhe të shtetit të së drejtës si rendi i vetëm politik, në të cilin mund të realizohen parimet e Demokracisë Sociale. Gjatë polemikës me socialistët dhe para së gjithash me komunistët në fund të shek. 19 dhe në fillim të shek. 20 kjo nënkuptonte edhe realizimin e ndryshimit social dhe politik nëpërmjet përmirësimeve graduale (p.sh. hartimit të kushtetutës) dhe jo nëpërmjet rrëzimeve revolucionare.
2. E drejta e garantuar me ligj për të synuar në liri dhe me përgjegjësi vetërealizimin politik dhe ekonomik për veten dhe të tjerët, tek e cila reflektohen parimet e liberalizmit, të shtetit të së drejtës dhe të etikës sociale kristiane.
3. Gatishmëria për të perceptuar, por edhe për të ndarë përgjegjësinë, decentralizimi politik dhe përgjegjësia individuale në vend të kujdesit të centralizuar dhe autoritar, ku reflektohet para së gjithash parimi i subsidiaritetit (shiko kapitullin 2).
4. Solidaritet me më të dobët si kërkesë për dashurinë ndaj tjetrit dhe për logjikë politike, ku reflektohen gjithashtu qëllimet bamirëse të etikës sociale kristiane si edhe kërkesa për përgjegjësi ndaj personave në nevojë.

Këto orientime dhe qëllime politike bazë kanë mbetur të pandryshuara deri në ditët e sotme. Partitë e sotme Kristian-Demokrate vazhdojnë të ndërthurin idetë e liberalizmit me ato të konservatorizmit të vlerave dhe të teorisë sociale kristiane. ***Vlerat e saj bazë janë: liria, drejtësia dhe solidariteti.*** Këto vlera bazë zbatohen si në rendin politik dhe atë ekonomik, ashtu edhe në jetën shoqërore.

Në hapësirën politike ***liria*** realizohet nëpërmjet të drejtave themelore të garantuara në Kushtetutë dhe të patjetërsueshme (të drejta dhe liri pozitive), si liria e besimit dhe e fesë, liria e mendimit, shtypit, tubimeve dhe e grupimeve apo e drejta aktive dhe pasive për të zgjedhur. Në fushën e ekonomisë ajo realizohet nëpërmjet të drejtës së pronës, të drejtës për shpalosjen e lirë të personalitetit, lirisë për zgjedhjen e profesionit dhe të lirisë së veprimit. Por m.q.se liria e njërit në asnjë rast nuk duhet të cenohet lirinë e tjetrit, ajo u nënshtrohet kufizimeve ligjore (të drejtat dhe liritë negative, detyrimi ligjor i drejtuesve politikë), të cilat synojnë të pengojnë kufizimin nga të tjerët të lirisë individuale dhe të lirive të tjera themelore apo të së drejtës për shpalosjen e lirë të personalitetit. Kjo mënyrë e konceptimit të lirisë është liberale në kuptimin klasik dhe i përgjigjet bazave të shtetit liberal të së drejtës. Ajo shpjegon gjithashtu, se përse Partitë Kristian-Demokrate janë mbrojtëse në parim të ekonomisë së tregut, e cila sigurisht që synon balancën sociale.

Vlerën ***e drejtësisë*** Demokracia Kristiane e argumenton nga njëra anë me barazinë e dinjitetit që Zoti u ka dhënë të gjithë njerëzve dhe nga ana tjetër me barazinë e tyre përpara ligjit. Në shtetin liberal të së drejtës drejtësi do të thotë “e njëjta e drejtë për të gjithë” dhe se askush nuk duhet të përfitojë apo të diskriminohet me ligj për shkak të besimit, punës, origjinës apo tipareve të tjera. Në fushën e ekonomisë dhe të politikës sociale konceptet e Demokracisë Kristiane dallojnë qartësisht nga konceptet e tjera, veçanërisht nga ato të socialistëve dhe të komunistëve, por edhe nga ato të

socialdemokracisë. Në plan të parë në konceptin kristian-demokrat për drejtësinë nuk qëndron synimi për një rishpërndarje të pronës dhe të të ardhurave me qëllim mënjanimin e plotë të shpërndarjes së pabarabartë, por drejtësi në shpërndarje dhe balancë sociale pa barazimtari dhe para së gjithash duke krijuar shanse të barabarta. Sipas këtij konceptimi duhet që çdo njeriu t'i krijohet mundësia që të shpalolet në përputhje me dëshirat dhe aftësitë e tij. Për këtë Demokracia-Kristiane ofron kuadrin politiko-ligjor (shteti liberal i së drejtës) dhe konceptin për ekonominë sociale (ekonomia sociale e tregut) dhe ofron oferta në sektorin e arsimit dhe të formimit profesional si edhe në politikën familjare, të cilat mund të pranohen në përputhje me dëshirat dhe aftësitë individuale.

Modeli i politikës ekonomike dhe sociale i Demokracisë Kristiane është Ekonomia Sociale e Tregut¹. Në këtë koncept ndërthuren praktikisht me njëri-tjetrin “liria” dhe “drejtësia”. Ai u zhvillua pas Luftës së Dytë Botërore para së gjithash nga ekonomistët gjermanë Walter Eucken dhe Alfred-Müller-Armack (i cili më vonë ishte presidenti i Fondacionit Konrad Adenauer) së bashku juristin me Franz Böhm dhe u zbatua nga ish-Ministri Federal i Ekonomisë, Kancelari i mëvonshëm dhe Kryetari i CDU-së Ludwig Erhard.

Nga liria buron me të drejtë pranimi i qartë i një ekonomie tregu, dmth. të bazuar në pronën private, në aktivitetin e lirë sipërmarrës dhe në konkurrencë. M.q.se qëllimi primar i ekonomisë së tregut, pra furnizimi optimal i popullsisë me të mira dhe shërbime, nuk mund të arrihet vetëm nga institucionit e tregut të lirë, të parregulluar, i cili herë pas here sjell pasoja sociale të padëshiruara (p.sh. kriza ekonomike, papunësi), atëherë shteti, në konceptin e ekonomisë sociale të tregut, përcakton kushtet ligjore, brenda të cilave duhet të realizohet veprimtaria e tregut. Krahas rregullave për mbrojtjen e konkurrencës së lirë, p.sh. nëpërmjet garantimit të lirisë tregtare dhe kontraktore, kontrollit të monopoleve dhe të drejtës kartelore si edhe ndërhyrjeve të përkohshme të shtetit në rastin e ngërçeve të rënda në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik (kriza ekonomike botërore), Ekonomia Sociale e Tregut plotëson si një qëllim të dytë krijimin e raporteve humane në punë. Në praktikë këto qëllime garantohen nëpërmjet ndalimit të punës së fëmijëve dhe punës me detyrim, përcaktimit të kohës javore të punës ose (varion nga Landi në Land) të rregullave për mbrojtjen nga pushimi nga puna. Edhe pranimi i lirisë së punëtorëve për t'u organizuar dhe e drejta e sindikatave për të negociuar për pagat dhe kushtet e punës (autonomia tarifore) janë të sanksionuara në konceptin e Ekonomisë Sociale të Tregut.

Në kuadrin e këtij koncepti ekonomik, i cili për iniciuesit nuk përbënte vetëm një sistem ekonomik, por edhe një etikë sociale, Demokracia Kristiane thekson ***detyrimin social të pronës private***. Prona private, iniciativa private si edhe prania e faktorëve prodhues lindin, ashtu si edhe përgjegjësia sipërmarrëse dhe risqet që lidhet me to, nga vlera themelore e lirisë dhe nga e drejta që rrjedh prej saj për shpalojen e lirë të personit. Megjithatë Demokracia Kristiane nënvijëzon, se prona private është e lidhur me detyrime, dmth. se ajo nuk duhet të sjellë dobi vetëm për pronarin, por edhe për komunitetin. Mbrojtja dhe

¹ Ky koncept ekonomik dhe social është karakteristik para së gjithash në Demokracinë Kristiane Gjermane. Në vende të tjera Kristian-Demokratët kanë ndjekur qëllime të ngjashme, por me emërtim tjetër, p.sh. „kapitalizmi socialist“ (Holandë), „shteti i mirëqenies korporatistike“ (Austri).

detyrimi social i pronës private në Gjermani janë të sanksionuara si në Kushtetutë (neni 14, parag. 2 i Kushtetutës) ashtu edhe janë pjesë përbërëse e programit kristian-demokrat (CDU Gjermani 2007:49).

Vlera themelore e **solidaritetit** karakterizon së pari një qëndrim të përgjithshëm njerëzor, i cili buron nga ideja e humanizmit dhe e dashurisë për të tjerët. Ajo e detyron “të fortin” që t’i japë dorën “të varfrit”. Në Ekonominë Sociale të Tregut solidariteti ndërhyt atje, ku njeriu (përkohësisht) nuk mund të jetë (më) pjesë e tregut të punës. Kjo lidhet para së gjithash me të sëmuret, me gratë shtatzëna, me të moshuarit dhe me të papunët. Për të përmbushur detyrimet e tij në politikën sociale (dhe të detyrave të tjera të shtetit si garanci për sigurinë e brendshme dhe të jashtme, arsimin dhe infrastrukturën), shteti mbledh taksa dhe kontribute mbi të ardhurat nga të ardhurat e punëtorëve dhe nga të ardhura të tjera. Taksapaguesit dhe të punësuarit përfitojnë nga kjo të drejtën për përkujdesje, qoftë kjo edhe e përkohshme, si në rast sëmundjeje apo papunësie, apo e vazhdueshme, si në rastin e pensioneve të pleqërisë. Por në Ekonominë Sociale të Tregut nuk janë edhe aq kristian-demokrate qëllimet (solidaritet me të dobëtit, pengimi i papunësisë si edhe përjashtimi nga jeta ekonomike) sesa argumentimi dhe mjetet e përdorura (shiko 3.2). Në dallim nga teoritë e tjera ekonomiko-sociale politika sociale kristian-demokrate thekson nga njëra anë kërkesën për individualitet personal, i cili duhet të mbrohet pavarësisht nga të ardhurat dhe pozicioni në jetën ekonomike (i punësuar apo i papunë, paaftësi për punë për shkak të sëmundjes apo në pension), por nga ana tjetër thekson, se krahas garantimit solidar ndaj risqeve të jetës nga shteti apo nga sistemet e tij të sigurimeve shoqërore duhet të qëndrojë edhe kujdesi dhe garantimi privat ndaj luhatjeve të jetës. Krahas kësaj politika sociale kristian-demokrate thekson, se marrësi i shërbimeve publike sociale është i detyruar për përgjegjësi dhe iniciativa private.

Politika ekonomike dhe sociale kristian-demokrate mbështet shtetin stimulues, por ajo është kundër “gjithëpushtetshmërisë” së tij. Vlen parimi: Aq shumë shtet sa është e nevojshme (p.sh. për hartimin e politikave rregulluese të ekonomisë së tregut apo për garantimin e risqeve të jetës), por sa më pak shtet sa të jetë e mundur. Në dallim nga modelet sociale dhe politike të socialistëve apo të socialdemokratëve shoqëritë e karakterizuara nga kristian-demokracia ua delegojnë shumë detyra publike njësisive të pavarura nga shteti. Kjo përputhet me idenë e subsidiaritetit, sipas së cilës shteti nuk merr përsipër përmbushjen e atyre detyrave, të cilat mund të realizohen nga njësi të veçanta apo më të vogla.

Demokracia Kristiane ka një **marrëdhënie të veçantë me kishat e krishtera**, por ajo nuk është “krahu i tyre politik”. Demokracia Kristiane vlerëson ndarjen e shtetit dhe kishës, megjithatë Demokracia Kristiane dhe kishat ndajnë të njëjtat vlera. Ndër to bëjnë pjesë modeli i njeriut kristian, pranimi i dinjitetit individual të njeriut, respektimi i lirisë dhe i përgjegjësisë, mbrojtja e jetës së palindur, ruajtja e krijesës dhe vlera e veçantë e familjes, si njësi më e vogël e shoqërisë. Përveç kësaj kishat vlerësohen si instanca drejtuese etike dhe morale dhe si vende të nxitjes së shpirtit qytetar dhe të mirëqenies publike. Marrëdhënia e veçantë me kishat në vendet e karakterizuara nga Kristian-Demokracia vihet re edhe në faktin, që Partitë Kristian-Demokrate angazhohen për ofrimin e mësimin për fenë kristiane në shkolla si lëndë e rregullt mësimore. Madje në shumë shtete të

karakterizuara nga Kristian-Demokracia (Danimarkë, Gjermani, Itali, Austri, Zvicër, Suedi, Spanjë) shteti mban taksa për kishat. Së fundmi Demokracia-Kristiane angazhohet për ruajtjen e simboleve dhe të festave kristiane – në tolerancë të plotë me fetë e tjera.

Që prej vitit 1945 Partitë Kristian-Demokrate kanë ndikuar ndjeshëm në politikën e shumë vendeve të Evropës Perëndimore si edhe në rrafshin evropian. Pjesërisht ato janë aktualisht në (bashkë)qeverisje – si në Belgjikë, Gjermani, Luksemburg, Hungari apo Sllovaki. Sukseset e saj të vazhdueshme Kristian-Demokracia ia dedikon para së gjithash faktit, që ajo ka integruar rryma dhe këndvështrime të ndryshme politike dhe në këtë mënyrë është pozicionuar dhe ka përfaqësuar politikën e qendrës. Parimisht Demokracia-Kristiane është e orientuar drejt ekonomisë së tregut, por ajo nuk është mbështetëse e një liberalizmi të shfrenuar të tregut. Ajo bën politikë duke u bazuar në konceptim kristian për njeriun, por thekson, se nga besimi kristian nuk rrjedh ndonjë program praktik dhe për këtë arsye ajo në hapësirën politike nuk është zgjatimi i krahut të kishave. Ajo është liberale, por në krahasim me partitë e tjera është përfaqësuese më e fortë e mendimit, se në shtetin e së drejtës lirisë individuale i duhen vënë kufij, në mënyrë që të garantohet një rend politik i qëndrueshëm si edhe siguri e brendshme dhe e jashtme. Ajo është tolerante ndaj feve të tjera, është kozmopolitane dhe përpiqet për një politikë të fqinjësisë së mirë si edhe për vazhdimin e integritit evropian. Por ajo e ve theksin edhe tek lidhja me vendlindjen, tek identiteti kombëtar dhe rajonal, simbolet dhe vlerat kombëtare (në Gjermani para së gjitha Kushtetuta, vlerat kristiane dhe kultura gjermane) dhe nuk është mbështetëse e një bashkëjetese multilaterale pa rregulla.

Për një kohë të gjatë politika kristian-demokrate përputhej me vlerat dhe pritshmëritë politike të shumicës së popullatës në vendet e Evropës Perëndimore. Partitë Kristian-Demokrate janë kthyer në **Parti Popullore të Qendrës** me një numër të lartë anëtarësh, me përbërje sociale heterogjene dhe me performancë të lartë politike. Kjo është arsyeja se përse për shumë vite me radhë nuk ka qenë e mundur apo vazhdon të mos jetë i mundur formimi i Qeverive pa ato. Sigurisht që Partitë Kristian-Demokrate në Evropë qëndrojnë përpara sfidave të reja. Nga njëra anë ato vuajnë nga shkëputja e lidhjeve partiake tradicionale të zgjedhëseve dhe zgjedhësve, nga dobësimi i aftësisë partiake për të mobilizuar si edhe nga tendencat individualizuese dhe desolidarizuese. Veçanërisht në qytetet e mëdha është duke u bërë gjithnjë e më e vështirë për Partitë Kristian-Demokrate që të mobilizojnë shumicat, ndërsa zonat rurale vazhdojnë të jenë bastionet e tyre me një numër të lartë aktivistësh kristianë, bujqër dhe sipërmarrës të mesëm. Nga ana tjetër shteti social, nën drejtimin e Partive Kristian-Demokrate, bazuar në ndryshimet demografike dhe në pasojat sociale të globalizimit, ka arritur kufijtë e performancës së tij.

Partitë Kristian-Demokrate duhet të reagojnë ndaj tyre me përmbajtjen e programit, por edhe me strategji dhe organizim, por pa hequr dorë nga parimet dhe besueshmëria e tyre. Nga pikëpamja e politikës shoqërore kjo mund të realizohet p.sh. duke kërkuar mbështetës të rinj në të ashtuquajturën qytetari liberale në qytetet e mëdha (specialistë të aftë me të ardhura të mira), duke kërkuar partnerë të rinj për koalicion, bazuar tek vlerat e përbashkëta apo tek dialogu me besimtarët dhe institucionet e feve të tjera duke ruajtur vlerat kristiane, por me theksin tek gjërat e përbashkëta, p.sh. në fushën e familjes.

Politikisht Partitë Kristian-Demokrate përpiqen që t'ju ofrojnë mbështetësve të tyre forma tërheqëse për të marrë pjesë në jetën politike, për shembull nëpërmjet një jete aktive të partisë lokale, nëpërmjet më shumë proceseve demokratike të drejtpërdrejta, p.sh. gjatë diskutimit dhe miratimit të programit apo përzgjedhjes së kandidatëve, nëpërmjet hapjes në rrafsh lokal për personat që nuk janë anëtarë apo nëpërmjet mundësisë për anëtarësi të përkohshme. Në politikën e sotme ekonomike synohet, që tregjet vendase të rregullohen në mënyrë të tillë, që ato të mos e çojnë në buzë të humnerës – si në rastin e krizës së tregjeve financiare dhe ekonomike 2008/2009 - të gjithë ekonominë dhe në këtë mënyrë të diskreditojnë ekonominë e tregut, por në të njëjtën kohë të mos e ngushtojnë shumë hapësirën për angazhime private në ekonomi. Formësimi i Politikës së Ekonomisë Sociale të Tregut në kushtet e Globalizimit është – krahas përpjekjeve, që duke ruajtur vlerat themelore të saj t'ju drejtohet edhe grupeve të tjera të mbështetësve, por pa humbur grupet e mbështetësve tradicionalë – një nga sfidat më të mëdha, me të cilat duhet të përballen në ditët e sotme Partitë Kristian-Demokrate.

2. HISTORIA E ZHVILLIMIT TË DEKOKRACISË KRISTIANE NË EVROPË²

Demokracia Kristiane në radhë të parë është një dukuri³ e Kontinentit Evropian. Ajo lindi si reagim ndaj Revolucionit Francez të vitit 1789 dhe ndaj liberalizimit dhe sekularizimit të jetës politike dhe sociale në Evropë, që buronte nga Franca. Nocioni *démocratie chrétienne* është përdorur për herë të parë në vitin 1791 gjatë një takimi ligjvënës nga peshkopi Lamourette von Lyon, por fillimisht kishte një kuptim të pastër fetar. Synimi i tij ishte koncepti ideal për kishën demokrate gjatë periudhës së gjenezës së krishterimit dhe këtë ai e përdorte për organizimin kishtar. Ky nocion synonte strukturat komunale demokratike si edhe shkatërrimin e organizmave hierarkike. Midis viteve 1830 dhe 1848 nocioni “Demokraci Kristiane” mori konture sociale dhe politike. Protagonistë ishin fillimisht katolikët, të cilët u përpoqën, që të ndërtonin një urë lidhëse midis qëndrimit kishtar dhe realitetit politik. Për evangjelistët pyetja për themelimin e një politike kristiane – pas opinioneve të lëkundura gjatë periudhës midis dy Luftërave Botërore – u shtrua vetëm pas vitit 1945. Për shkak të qëndrimit të tyre të ndryshëm kishtar dhe social-etik dhe për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me Fronin dhe Altarin në shtet monarkike, ata kishin një qasje tjetër ndaj idesë kristian-demokrate. Ata iu drejtuan të krishterëve evangjelistë me antropologjinë teologjike dhe jo me të drejtën natyrore. Krahas kësaj shkalla e lidhjeve me forumet dhe partitë ishte më e dobët se në Katolicizëm. Për këtë arsye në Protestantizëm mbetën dominuese qëndrime konservatore, fetare-karitative dhe kristian-sociale. Përveç kësaj në vendet me shumicë protestante të popullsisë (para së gjithash në Skandinavi dhe në Britaninë e Madhe) partitë nuk u karakterizuan nga konflikti i mëvonshëm midis kishës dhe shtetit. Në shek. 17 në Danimarkë dhe në Britaninë e Madhe u bënë përpjekje për të aplikuar detyrimin e përgjithshëm për ndjekjen e shkollës nën mbikëqyrjen e shtetit, dmth. me mbikëqyrje publike. Për këtë arsye situata nuk ishte e ngarkuar me shumë konflikte, sepse kisha shtetërore luteriane dhe anglikane u shpallën si partnerë të shtetit me të drejta të barabarta. Gjatë diskutimit politik me përfaqësuesit liberalë, protestantët në shtetet e sipërpërmendura formuan Aleanca me Konservatorët dhe synonin që të mbronin Monarkinë.

Nga prifti breton Robert Lamennais dhe nga mbështetësit e tij, Charles de Montalembert dhe Henri Dominique Lacordaire u shpalos për herë të parë më hollësisht ideja kristian-demokrate. Duke iu referuar lëvizjes konstitucionale belge të vitit 1830, e cila u mbështet nga Liberalët dhe Katolikët (“Mendimi i Unionit”), ata kërkuan ndarjen e kishës nga shteti si edhe lirinë fetare, të mendimit, të mësimin, të shtypit dhe të krijimit të organizatave. Megjithatë lidhja midis Demokracisë dhe Krishtërimit bazohej në koncepte teologjike-tradicionale. Nuk u hartua një program i gjerë politik. Kontributi i Lamennaisit ishte

² Ky kapitull bazohet në tekstin e Rudolf Uertz (2004). Për këtë broshurë atë e përshtati Karsten Grabow. Autorët falënderojnë për kontributin e çmuar Janine Dombush, studente për „European Studies“ në Universitetin e Mاستrihtit, e cila në korrik 2009 bëri një praktikë në ekipin e KAS-it për Amerikën Latine.

³ Mbi historinë e krijimit të Demokracisë Kristiane në Amerikën Latine shiko p.sh. Caldera (1977/2002), Jung (1983) si edhe Hennig dhe Weigelt (1997).

sigurisht, se ai dalloi në kohë rëndësinë e madhe të popullit si një faktor veprimi (Sovraniteti i popullit) si edhe çështjen sociale si faktorë përcaktues të rendit politik-shoqëror në shek. 19.

Në rast se shteti modern në shtetet evropiane do të zhvillohej si një “revoltë kundër Zotit dhe fesë” dhe sundimit absolut shekullor të “mëshirës së Zotit”, atëherë Laménais fenë dhe demokracinë nuk i konsideroi aspak si kontradikta, por si madhësi që ndërthuren me njëra-tjetrën. Lirinë, drejtësinë dhe barazinë ai i kuptoi si elementë teologjikë, konceptimin fetar-tradicional të të cilëve ai e ndau nga liberalizmi individualist. Manennais shpresonte që në të ardhmen të krijohej një aleancë midis forcave kristian-liberale dhe liberalizmit individualit-shekullarist, e cila ende nuk ishte në dukje.

Në vitin 1862 peshkopi i Maincit, Wilhelm Emmanuel Freiherr von Ketteler, në botimin e tij “Liri, autoritet dhe kishë” shpali modelin bazë për qëndrimin e katolikëve ndaj pushtetit të shtetit, për raportin midis kishës dhe shtetit, për angazhimin politik të katolikëve dhe përfaqësimin e të drejtave të tyre në rendin kushtetues. Ai mbronte konstitucionalizmin dhe u rekomandoi katolikëve që të merrnin në konsideratë të gjitha mundësitë politike, parlamentare dhe komunikative (p.sh. organet e shtypit) në favor të interesave katolike. Ketteler parashtronte në mënyrë pragmatike parime të moderuara liberale dhe të shtetit të së drejtës. Ai ishte kundër absolutizmit dhe shtetit policor, përballë të cilëve ai vendosi “shtetin e vërtetë të së drejtës”, i cili bazohej “tek liria dhe vetëqeverisja”. Kërkesa të tjera ishin: garancia e shtetit për mbrojtjen e së drejtës, diferencimi i duhur midis rendit shtetëror dhe privat, një rend gjyqësor administrativ, një Gjykatë të Lartë për Raihun si edhe një gjyqësor i pavarur. Sipas kësaj, baza e shtetit të së drejtës është rendi i tij normativ, “një njësi matëse e drejtë për të matur, një Ligj i drejtë për të gjykuar”. Por ai dështoi në kërkesën e tij për të sanksionuar në Kushtetutën e Raihut të vitit 1871 lirinë kishtarë si liri themelore. Megjithatë Ketteler përfaqëson Katolicizmin liberal në sistemet konstitucionale. Njëkohësisht ai i hapi rrugën një reforme sociale kristiane. Deri në fund të shek. 19 shkrimet e tij formësuan mendimet bazë të Katolicizmit politik, ashtu siç u përfaqësuan në organizatat ndërfraksionare nga anëtarët katolikë të Asamblesë Kombëtare të Frankfurtit 1848/49.

Partitë Kristiane në Evropë kanë filluar të themelohen qysh prej vitit 1870. Shkak për këtë ishin nga njëra anë forcimi i borgjezisë dhe i filozofisë të saj politike, dhe nga ana tjetër Revolucioni Industrial dhe dukuritë e tij sociale që e shoqëruan.

Liberalizmi nuk parashtrroi vetëm kërkesa revolucionare politike si kërkesat për një shtet borgjezo-demokratik, zbatimi i së drejtës së përgjithshme të votës (për meshkuj), forcimi i Parlamenteve dhe themelimi i partive politike. Borgjezia, pjesërisht në bashkëpunim me forcat konservatore, konkurroi gjithnjë e më shumë kishën (katolike) në çështjet e shkollimit dhe të edukimit.

Në Gjermani për shembull pas Bashkimit të Rajhut në vitin 1871 katolikët ishin në minorancë. Për të kundërshtuar dominimin e aristokracisë prusiane që mbështeste Kancelarin e Rajhut Otto von Bismarck – ai u përpoq që të dobësonte pushtetin e kishës katolike – deputetët katolikë themeluan në vitet 1869/70 Partinë e Qendrës. Ndërsa

politika e Kancelarit synonte që të krijonte në Gjermani një politikë të qendrës, Partia e Qendrës përkrahu rendin federativ dhe u angazhua për një pavarësi më të madhe të Shteteve të Federatës. Arsyja kryesore e konfliktit me Qeverinë e Rajhut, me forcat politike prusiane-konservatore dhe veçanërisht me forcat politike liberale ishin përpjekjet e Kancelarit të Rajhut për të dobësuar ndikimin e kishës katolike – sidomos në çështjet e arsimit dhe të formimit – dhe të krijonte një monopol arsimor shtetëror dhe laik. Jo vetëm kisha katolike, por veçanërisht organizatat fetare, përfaqësia katolike në Raih, kërkuan pavarësinë e institucioneve kishtarë (katolike). Sipas mendimit të Qendrës edhe shkollat fetare dhe mbikëqyrësit e shkollave fetare duhet të vazhdonin punë e tyre. Prusianët protestantë i sfiduan katolikët në Gjermani, në ballë të të cilëve qëndronte Partia e Qendrës si lëvizje politike, në të ashtuquajturën luftë kulturash (dëbimi i Urdhrit të Jezuitëve; Rregullimi i shqetësimeve shpirtërore nëpërmjet ndalimit të predikuesve, procesioneve; anulimi i legjislacionit fetar për lidhjen e martesës etj.), çka në fund të fundit çoi në përforcimin e katolicizmit politik dhe në formimin e themelimit të Partisë Qendrore të Rajhut Gjerman në vitin 1870.

Krahas qasjes kulturore-politike me partitë liberale (dhe pjesërisht konservatore) themelimi i Partive Kristian-Demokrate buron nga pasojat e Revolucionit Industrial dhe nga pozicionimi i Kishës Katolike ndaj gjendjes së punëtorëve. Dukuritë shoqërore të Revolucionit Industrial ishin midis të tjerave urbanizimi masiv, gjendja e vështirë dhe mjerimi social i grupeve të mëdha të popullsisë. Gjendjen e përkeqësuar sociale të punëtorëve – krahas organizatave me prirje socialiste - e shprehën para së gjithash edhe lëvizje katolike-sociale. Bazuar në teorinë karitative-solidare të Krishtërit – ndihmë për njerëzit dhe integrim social – lëvizjet katolike-sociale synonin të arrinin zgjidhjen e çështjes sociale nëpërmjet luftës morale kundër liberalizmit politik dhe ekonomik. Këto synime integruese si edhe orientimi drejt ideve për një rend të klasës punëtore gjetën mbështetje organizative tek shoqatat katolike dhe tek lëvizjet sindikaliste kristiane dhe nëpërmjet tyre ushtruan ndikimin e tyre tek legjislacioni social i mëvonshëm në shtetet e Kontinentit Evropian.

INFORMACIONE SHITESË:

DEMOKRACIA KRISTIANE DHE TEORIA SOCIALE E PAPËS LEO XIII.

Teoria e Leos XIII (1878-1903) për shtetin dhe shoqërinë ishte shumë domethënëse për Demokracinë Kristiane jo vetëm në këndvështrimin teorik-programatik, por edhe social-politik:

Leo XIII e nxori kishën katolike nga qëndrimi i saj restriktiv, të cilin e mbanin paraardhësit e tij, p.sh. Piu IX me *Syllabus errorum* (1864) ndaj Liberalizmit dhe ndaj çdo forme të ideve të reja sociale dhe politike, dhe e hapi me kujdes kishën dhe Etikën Sociale për çështje të reja. Në Enciklikat e tij (qysh prej vitit 1881) Leo u bëri thirrje katolikëve të Francës dhe të vendeve të tjera, në të cilat ishte vendosur rendi republikan, që t'i praninin këto. Megjithatë ai mbajti qëndrim asnjës në çështjen e formës së shtetit (e ashtuquajtura teza neutrale për shtetin) dhe njëkohësisht nuk i mbështeti aktivitetet dhe

lëvizjet politike të katolikëve, të cilat (detyrimisht) ishin në mbështetje të Demokracisë dhe përbënin kërcënim për rrëzimin e monarkive ekzistuese. Por parimisht me pranimin e rendit republikan nga Papa, qëndrimi i kishës ndaj formës së shtetit dhe të qeverisë u lidh me mundësitë dhe zhvillimet faktike të shteteve në fushën e shtetit konstitucional dhe të së drejtës. Në vitin 1891 Leo XIII në Enciklikën *Rerum novarum: Mbi çështjen e punëtorëve* (1891) botoi Qarkoren e Parë të Papës për çështjet sociale në kishën katolike. Atje krahas kërkesave për drejtësi në pagë dhe aktivizim më të fuqishëm të shtetit në ekonomi shprehet edhe e drejta e punëtorëve për të krijuar koalicione. Në dokument konstatohet, se vetëm mbrojtja e punëtorëve është e pamjaftueshme dhe ngulmon në krijimin e organizatave moderne të punëmarrësve. Në lidhje me parimin e mosndërrhyrjes (i ashtuquajturit shteti i rojtarëve të natës) Enciklika thekson detyrimin e shtetit për të mbështetur mirëqenien publike. *Rerum novarum* solli një propagandim të programit social të lëvizjes kristian-sociale (koncepte për zgjidhjen e të ashtuquajturës çështje sociale apo çështje e industrisë dhe e punëtorëve). Në mënyrë indirekte Enciklika për zbatimin e kërkesave social-etike kërkonte krijimin e lëvizjeve politike apo të partive, por këto tendenca lindën nga aksionet solidare të katolikëve. Krahas shtetit dhe kishës Qarkorja përmend bashkëveprimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve si faktorët më të rëndësishëm për zgjidhjen e Çështjes Sociale. Në këtë mënyrë nga Dokumenti Social lindën tendenca të qarta sociale dhe politike-demokratike, edhe pse të krijuara në mënyrë indirekte.

Në Belgjikë, Gjermani, Zvicër, Francë dhe Itali si edhe në shumë vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore në vijim të Qarkores së Papës u krijuan një numër i madh qarqesh dhe grupimesh studimore, në mënyrë që duke u bazuar tek Enciklika Sociale të shpalosnin koncepte social-politike dhe të vepronin në këtë drejtim. Detyrimisht që këto grupe – pjesërisht ishin edhe grupe parlamentare – duhej të merrnin një karakter politik apo partiak.

Sigurisht që Leoja këto zhvillime nuk i dëshironte për veten e tij. Për arsye kishtare dhe kishtare-politike ai donte që të kontrollonte zhvillimet politike të shoqatave dhe të partive politike dhe t'i kufizonte aktivitetet kristian-demokrate vetëm në aktivitete sociale dhe karitative. Në Enciklikën *Graves communi: Mbi Demokracinë Kristiane* (1901), në të cilën për herë të parë një dokument i Papës mban qëndrim ndaj Demokracisë Kristiane, Papa e refuzonte Demokracinë Kristiane si një lëvizje politike dhe kërkonte, që të ndalohej çdo gjë, që mund t'i jepte një kuptim politik emërtimit “Demokracia Kristiane”. Sepse “ligjet e natyrës dhe evangjelizmi duhet të jenë të pavarura nga çdo formë e Kushtetutës së Shtetit, sepse karakteri i saj juridik qëndron mbi luhatjet e jetës së njeriut; por ai duhet të jenë në përputhje me çdo formë të shtetit, sa kohë që kjo nuk është në kundërshtim me moralin dhe drejtësinë”. Sipas saj, një katolik duhet të respektojë neutralitetin e kishës në çështjen e formës së shtetit dhe të qeverisë dhe të mos lejojë, që të parapëlqehet një formë e caktuar e shtetit përpara një forme tjetër dhe të ndihmojë në realizimin e saj. Papa Leo XIII nocionin “Demokraci Kristiane” në Enciklikë e ngushton thjesht për qëllime sociale; kërkesat shtetërore-politike kundërshtohen shprehimisht. Leoja shprehet, se nocioni ka një “shije të rrezikshme”, sepse ai synon demokracinë në kuptimin e demokracisë popullore; për këtë arsye ai nuk pajtohet me teorinë katolike dhe me qëndrimin e saj neutral ndaj formave të ndryshme të shtetit.

Rreth fundit të shek. 19 partitë kristiane të sapokrijuara në Evropë duhej të përballëshin me forcat liberale – si p.sh. në Gjermani – dhe protestante-konservative. Edhe Vatikani fillimisht e kundërshtoi ashpër krijimin e tyre dhe “lojën” politike sekulare me qëllimin për të fituar mbështetës, vota, vende në Parlament dhe pushtet politik. Papa Piu IX (1846-1878) në vitin 1874 fillimisht ua ndaloi me dekret (*non expedit*) katolikëve të Italisë çdo aktivitet politik. Kjo çoi në një konflikt të ashpër midis Selisë së Shenjtë dhe institucioneve pararendëse të *Democrazia Cristiana* (1942-1994), të *Partito Popolare Italiano* (PPI) dhe të *Azione Cattolica*. Këto ishin organizata politike-sociale, të cilat ishin krijuar për ta shndërruar Katolicizmin në një lëvizje popullore për ripërtëritjen e merituar sociale të politikës dhe të shoqërisë dhe njëkohësisht për të nxjerrë jashtë loje Socializmin, në formën e përfaqësimit të tij nëpërmjet partive dhe sindikatave të lëvizjeve popullore.

Nën presionin e Liberalizmit dhe të Revolucionit Industrial nga njëra anë dhe të dinamikës së themelimit të organizatave politike dhe sociale me orientim katolik në shumë vende të Evropës Perëndimore (Belgjikë, Gjermani, Itali, Holandë, Austri, Zvicër) nga ana tjetër, Vatikani më në fund hoqi dorë nga kundërshtimi i krijimit të partive kristiane. Me rëndësi për arritjen e kësaj ishte nga njëra anë Teoria e Papës Leo XIII mbi Shtetin dhe Shoqërinë (shiko në faqen 15). Nga ana tjetër lëvizja sociale kristian-katolike deri në fund të shek. 19 kishte arritur të krijonte një rrjet të dendur me shoqata, forume, sindikata dhe pjesërisht me parti, të cilat politikisht u drejtoheshin njësoj të krishterëve (katolikëve), i integronin ata në rrjetin e dendur politik dhe social, u ofronin atyre një “vendlindje” politike dhe sociale dhe – një këndvështrim mjaft i rëndësishëm për Vatikanin – përbënin një kundërrymë ndaj partive, sindikatave dhe ideologjive me prirje marksiste.

Partitë Kristiane në Evropën Perëndimore – në Austri Partia Kristian-Sociale, në Zvicër Partia Katolike-Konservatore, në Itali *Democrazia Cristiana*, në Holandë Partia Popullore Katolike dhe në Gjermani Partia e Qendrës – ishin shndërruar në parti në mirëorganizuar, të cilat gëzonin mbështetjen e pjesës më të madhe të zgjedhësve katolikë, pavarësisht nga pozicioni i tyre social apo ekonomik. Partitë Kristian-Demokrate integruan sipërmarrës, nëpunës, zejtarë, pronarë ndërmarrjes dhe lokalesh si edhe punëtorë, çka ishte shumë e rëndësishme për suksesin e tyre të mëvonshëm. Kështu për shembull, Partia e Qendrës duke filluar nga zgjedhjet parlamentare të vitit 1874 ka marrë në mënyrë të vazhdueshme rreth 30% të votave dhe ka dërguar rregullisht midis 90 dhe 100 deputetë në Rajstagan Gjerman. Ajo ishte shndërruar në një forcë politike të qëndrueshme në Rajstagan Gjerman, në mënyrë të ngjashme si partitë e saj simotra në vendet evropiane fqinje.

2.1 TEORIA KRISTIAN-DEMOKRATE DHE POLITIKA NË PERIUdhËN MIDIS LUFTRAVE BOTËRORE

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore Papa Benedikti XV (1914-1922) abrogoi jo vetëm dekretin e Piu IX (*non expedit*), por ai madje miratoi edhe krijimin e një Partie Kristiane në Itali. Me *Partito Popolare Italiano* (PPI) të themeluar nga Luigi Sturzo në vitin 1919 lindi nga lëvizjet e Katolicizmit politik dhe social një parti, e cila mbronte Teorinë Sociale

Katolike, angazhohej për reforma demokratike, p.sh. për aplikimin e të drejtës së votës për femrat dhe mobilizonte me sukses anëtarë dhe zgjedhës nga të gjitha klasat shoqërore.

Për Austrinë dhe Gjermaninë periudha e pasluftës solli ndryshime thelbësore në raportet politike: fundin e Monarkisë dhe krijimin e Republikave Demokratike. Partia e Qendrës, mbështetur në direktivat e saj të vitit 1922, u pozicionua si “një parti popullore kristiane, e cila [...] është plotësisht e vendosur, për të realizuar parimet e Krishtërimin tek shteti dhe shoqëria, tek ekonomia dhe kultura”. Detyrat e saj ligjore dhe shtetërore përcaktoheshin nga “konceptet kristiane për shtetin dhe nga karakteri i trashëguar si parti kushtetuese”. “Ndryshim radikal i gjendjes kushtetuese” u kritikua ashtu si edhe gjithëfuqishmëria e shtetit dhe “mohimi apo fshirja e konceptit për shtetin”. U pohua ideja “për shtetin popullor gjerman, forma e të cilit duhet të përcaktohet nga vullneti i popullit me rrugë kushtetuese”. Populli, si burimi i autoritetit shtetëror, duhet të mbushet me ndjenjën e përgjegjësisë për fatet e shtetit. Prandaj qytetarët e të gjitha shtresave të popullsisë duhet të marrin pjesë në mënyrë të pavarur në çështjet publike [...]”.⁴

Pas përfundimit të periudhës perandorake Partia e Qendrës u përpoq që ta argumentonte rendin demokratik-republikan me të drejtën natyrore kristiane. U mbështet sovraniteti i popullit, të drejtat themelore qytetare dhe formimi i vullnetit demokratik. Një pikë tjetër e programit të Partive Kristiane dhe Kristian-Demokrate në Evropë midis periudhës së Luftërave Botërore ishte synimi për të rifituar stabilitetin e humbur të rendit të mëparshëm nëpërmjet një shteti të fuqishëm – por aspak totalitar.

Përpjekjet për të bërë dallimin në komunitet midis kompetencave individuale, sociale dhe shtetërore dhe për të përcaktuar kriteret mbi rregullat adekuate për kompetencat u reflektuan qartë në Enciklikën Sociale të Papës Piu XI *Quadragesimo anno: Mbi rendin shoqëror* (1931), e cila, si dikur *Rerum novarum*, bëri një jehonë të madhe. Pa dyshim që kjo Enciklikë me parimin e subsidiaritetit kishte formuluar parimin më të rëndësishëm social-etik dhe politik të lëvizjes kristian-demokrate. Pas vitit 1945 ai luajti një rol të rëndësishëm në programin shtetëror, ekonomik dhe social të pjesës më të madhe të Partive Kristiane. Më vonë ai u bë pjesë e programit të Partive Liberale dhe Socialdemokrate si edhe e përmbajtjes të Traktatit së Mastrihtit për Bashkimit Evropian (1992).

Parimi i subsidiaritetit është një koncept i qartë anti-etatistik. Ai përbën bërthamën e etikës sociale kristiane. Nocioni “subsidiaritet” e ka prejardhjen, siç u shtjellua më lart, nga *subsidium* (“rezervë, zëvendësim”). Sipas parimit të subsidiaritetit realizimi i lirisë presupozon krijimin e një jete personale të përgjegjshme. Njësitë më të vogla të shoqërisë si familja, bashkitë apo komunat duhet të jenë aktorët e vërtetë të jetës shoqërore dhe duhet të jenë në gjendje ta ndërtojnë me përgjegjshmëri jetën e tyre. Sipas këtij parimi shteti duhet të heqë dorë nga ato detyra, të cilat mund t’i përmbushë gjithsecili apo grupe më të vogla komunitare. Atë çka qytetari mund ta bëjë i vetëm në familje dhe në bashkëpunim të lirë me të tjerët, i duhet lënë atij në dorë. Shteti dhe njësitë më të larta shoqërore qëndrojnë fillimisht “në rezervë” ndaj tyre dhe të ndërhyjnë, kur njësia më e vogël nuk është në gjendje të bëjë një jetë të përgjegjshme. Në këtë mënyrë parimi i

⁴ Direktivat e Partisë Gjermane të Qendrës (1922), në: Mommsen (1960: 486-489).

subsidiaritetit është një parim përgjegjësish, i cili korrespondon edhe me konceptet federaliste.

Quadragesimo anno është njëkohësisht shprehja e ambivalencës së Katolicizmit social dhe politik. Edhe pse dokumenti distancohej nga fashizmi (italian) dhe kritikonte totalitarizmin, u shfaqën indiferenca politike domethënëse. Ashtu si Enciklika, edhe Teoria Katolike për Shtetin dhe Shoqërinë e periudhës midis Luftërave Botërore nuk i dha përgjigje çështjes së garantimit parimor të të drejtave themelore demokratike-politike dhe ekonomike.

Megjithëse Partia e Qendrës në Gjermani vepronte në terrenin e Kushtetutës së Rajhut të Vajmarit, ajo ishte shprehur për demokracinë parlamentare dhe kontribuoi në zgjerimin e shtetit social, në Republikat e reja në Gjermani dhe në Austri u shfaqën konflikte midis mbështetësve dhe kundërshtarëve të demokracisë parlamentare. Gjatë diskutimeve midis kundërshtarëve të demokracisë, fashistëve dhe nacionalsocialistëve nga njëra anë dhe komunistëve nga ana tjetër, dhe mbështetësve të tyre, Partitë Kristiane u renditën në anën e demokratëve dhe lidhën aleanca me kundërshtarët e tyre të dikurshëm, me partitë liberale dhe konservatore. Megjithatë ato nuk ishin në gjendje të pengonin ardhjen në pushtet të fashistëve dhe të nacionalsocialistëve. Në vitin 1926 Moussolini e shpërndau PPI-në italiane, Sekretari i saj i Përgjithshëm, Alcide de Gasperi, u arrestua (shiko 4.3). Në Gjermani Ministri për Propagandën Joseph Goebbels i bëri thirrje kryesisë së Qendrës, që “ta mbyllnin sa më shpejt dyqanin e tyre”, sepse ai nuk donte të shihte më me sy “eksperimentet” e kësaj partie me reformat sociale. Shpërndarja e Qendrës dhe e partive të tjera demokratike si edhe e sindikatave disa muaj pas ardhjes në pushtet të nacionalsocialistëve në Gjermani në vitin 1933 vijoi me largimin nga detyra të politikanëve kristian-demokratë, përndjekjen e tyre si edhe ndalimin e partive kristian-demokrate në vendet e Evropës të pushtuara nga nacionalsocialistët. Si shumë politikanë dhe kundërshtarë të tjerë demokratë të regjimit të NS edhe politikanë të Qendrës e paguan me jetën e tyre opozitën ndaj nacionalsocialistëve.

2.2. DEMOKRACIA KRISTIANE QYSH PREJ 1945

Pas Luftës së Dytë Botërore u themeluan apo rithemeluan Parti Kristian-Demokrate dhe Kristian-Sociale në Itali, Luksemburg, Francë, Austri, Gjermani, Belgjikë, Norvegji, më vonë në Finlandë, Zvicër, Holandë dhe më pas në Spanjë. Partitë Kristiane në Evropën Lindore të rithemeluara pas vitit 1945 bënë një qëndresë shumë të shkurtër ndaj presionit të pushtetit komunist.

INFORMACIONE SHITESË:

DEMOKRACIA KRISTIANE NË KOMUNIZËM: CDU-ja NË DDR

Pasi pushtuesit sovjetikë me urdhrin nr. 2 të datës 10 qershor 1945 lejuan krijimin e partive politike, në datën 26 qershor në Berlin u krijua CDU-ja. Ajo synonte të ishte një

lëvizje gjithëpërfshirëse kristiane dhe njëkohësisht përtej kufijve të fesë. Shumë nga personalitetet themeluese të saj, si kryetari i parë Andreas Hermes dhe pasuesi i tij Jakob Kaiser vinin nga radhët e rezistencës kundër nacionalsocializmit.

Themelimi i partisë së re, ashtu si partia e saj simotër, Partia Liberal-Demokrate Gjermane (LDPD), iu nënshtrua shprehimisht urdhrave dhe kontrollit të pushtuesit. Në fillim ishte e pamundur të realizohej një shpalesje e lirë. Synimi ishte që nëpërmjet largimit të Partive Demokratike, emërimeve në administratën dhe në institucionet publike si edhe shtetëzimit radikal të tregtisë, industrisë dhe sistemit bankar të krijohej në SBZ/DDR një sistem komunist sipas modelit sovjetik. Kundër këtyre synimeve politikanët fillimisht ndoqën rrugën e vetëafirmimit dhe të kundërshtimit, si për shembull shprehja e Jacob Kaiserit gjatë ditës së dytë të Konventës së Partisë SBZ-CDU në shtator 1947: “Ne duhet dhe duam të jemi valëthyesit e marksizmit dogmatik dhe të tendencave të tij totalitare!”

Megjithatë pas themelimit të DDR-së në tetor 1949 sovjetikët dhe Partia Komuniste SED i intensifikuan represionet e tyre kundër politikanëve demokratë. Me kërcënime, arrestime arbitrare, terror fizik dhe psikik ata i detyruan politikanët demokratë të tërhiqeshin dhe të përshtateshin në përmbushjen e detyrave të tyre dhe shpesh të arratiseshin për në Perëndim. Deri në tetor 1950 CDU-ja humbi në DDR rreth 25% të anëtarëve të saj. Gjatë Konventës së 6-të të Partisë në tetor 1952 në Berlin ajo ishte e detyruar të pranonte “pa kundërshtime” drejtimin e SED-së.

Në periudhën e mëvonshme imazhi i CDU-së në DDR përfaqësohej nëpërmjet funksionarëve besnikë të SED-së. Në statutin e Partisë ishte sanksionuar “besimi për socializmin” si edhe dëshira “për një bashkëpunim të besueshëm me partinë e klasës punëtore”. Gatishmëria në dukje, por në fakt e imponuar, për të bashkëpunuar me SED-në dhe për t’iu nënshtruar asaj dhe rolit të saj drejtues në “bllokun e bashkuar” të partive, i shndërroi anëtarët e CDU-së në “flautistë të bllokut”. Por duhet bërë dallimi midis elitave funksionare të Partisë nga njëra anë dhe anëtarësisë nga ana tjetër. Për shumë të krishterë në DDR CDU-ja ishte mundësia e vetme për t’iu shmangur presionit të SED-së.

Në këtë mënyrë vijoi qëndrimi opozitar i bazës së CDU-së në Lindje ndaj SED-së dhe ndaj gatishmërisë për përshtatje të vetë kryesisë së partisë në vitet 1950 dhe 1960. Në momente nevralgjike të historisë së DDR-së si p.sh. gjatë kryengritjes popullore në qershor 1953, gjatë ndërtimit të Murit në vitin 1961, gjatë marshimit sovjetik në Çekosllavaki në vitin 1968 apo gjatë miratimit të Ligjit të Luftës në Poloni në vitin 1981 u rrit ndjeshëm kritika nga radhët e anëtarëve.

Tek anëtarësia e CDU-së në Lindje fshihej një potencial opozitar latent, i cili filloi të zgjohej gradualisht qysh prej mesit të viteve '80 me ngjarjet e “Glasnostit” dhe “Perestrojkës” në Bashkimin Sovjetik, lëvizjeve reformuese në Poloni dhe Hungari dhe gjatë aktiviteteve të “Lëvizjes së Pavarur për Paqe” në DDR. “Letra nga Vajmari”, të cilën ia dërguan kryesisë së partisë së tyre katër anëtarë të CDU-së në datën 10 shtator 1989, të gjithë anëtarë me emër të kishës evangjeliste, u kthye në pikë kristalizimi si një kërkesë e fortë për reforma nga baza. Në datën 2 nëntor 1989 kryetari në detyrë i Partisë Gerlasd Götting, i cili e ushtronte detyrën qysh prej vitit 1966, u detyra të japë dorëheqjen nën

presionin e reformatorëve. Po në atë muaj CDU-ja e hoqi nga statuti i saj pranimin e rolit drejtues të SED-së dhe u tërhoq nga “Blloku Demokratik Qendror” që drejtohej nga SED-ja. Gjatë një konvente të jashtëzakonshme të Partisë më 15/16 dhjetor 1989 në Berlin ajo prezantoi rishtazi personelin, programin dhe organizimin e ri të saj. Ajo e pranoi pjesën e saj të fajit për deformimet dhe gabimet në DDR, u distancua nga socializmi, premtoi një demokraci ndërpartiake dhe shtetërore dhe mbështeti Ekonominë Sociale të Tregut dhe Bashkimin e Kombit Gjerman.

Gjatë zgjedhjeve për Parlamentin e DDR-së më 18 mars 1990 CDU-ja në kuadër të “Aleancës për Gjermaninë” arriti një fitore surprizë me 40,6% të votave. Kryetari i Partisë, Lothar de Maizière u bë Kryeministër. Në bazë të Traktatit të Unifikimit dhe Konventës Dy-Plus-Katër, dhe të Bashkimit Monetar, Ekonomik dhe Shoqëror, mbështetur edhe në nenin 23 të Kushtetutës, ai e afroi DDR-në me Republikën Federale Gjermane dhe në këtë mënyrë me Bashkimin e Gjermanisë, i cili u realizua më 3 tetor 1990. Dy ditë më parë gjatë një konvente të Partisë në Hamburg CDU-ja e Lindjes dhe e Perëndimit u bashkuan për herë të parë në një CDU të vetme.

Vendimtare në përhapjen e Demokracisë Kristiane në Evropën Perëndimore ishin përvojat me totalitarizmin, dmth. sistemet nacionalsocialiste dhe komuniste. Këto përvoja çuan edhe në pranimin e demokracisë – edhe nga ana e Vatikanit. Kështu Konstitucioni pastoral *Gaudium et Spes* (1965), një dokument i Koncilit të Dytë të Vatikanit (1962-1965), thekson, se demokracia e lirë, e shtetit të së drejtës dhe e ndarjes së pushteteve është ajo formë qeverisjeje, e cila ofron kushte të favorshme për garantimin e të drejtave themelore të njeriut dhe të politikës si edhe për garantimin e mirëqenies së komunitetit. E drejta për demonstrata, për t’u organizuar në shoqata dhe e drejta e mendimit u theksuan ashtu si edhe e drejta private dhe publike për të pranuar fenë. *Gaudium et Spes* kërkon qartësisht: “Zgjedhja e qeverisë (duhet) t’i lihet në dorë vullnetit të lirë të qytetarëve” (Vatikan 1965, Kapitulli IV, veçanërisht pikët 73-75, citati nga pika 74).

Përvojat dhe kërcënimet e diktaturës, arsyet e dështimit të demokracisë në vitet ’30 dhe ambicia për një pjesëmarrje politike të qytetarëve çuan në një pranim të qartë të demokracisë jo vetëm nga Vatikani, por mbështetën shprehimisht konceptet demokratike të Partive Popullore, dmth. një formë partiake, e cila gjen shprehje tek përfaqësuesit e të gjitha profesioneve, shtresave sociale dhe të gjitha feve. Koncepti i vjetër gjithëpërfshirës në programin e Unionit Kristian-Demokrat dështoi në sintezën e tregut liberal dhe të konkurrencës nga njëra anë dhe të rendit social nga ana tjetër (në Republikën Federale Gjermane Ekonomia Sociale e Tregut).⁵ Shprehjen e tij organizative koncepti i Unionit në

⁵ Vetëm në fillim të viteve ’60 Kisha Evangjeliste u bashkua me traditën e Enciklikave Sociale të Papës dhe me dokumentin “Formimi i pronës nën përgjegjësinë sociale”. Në vitin 1962 paraqet për herë të parë një dokument, i cili u pasua edhe me të tjerë. Në këtë mënyrë dialogu ekumenik, por edhe dialogu midis Kishës Evangjeliste dhe politikës, dhe veçanërisht me Kristian-Demokratët, u gjallërua dhe u thellua. Një kulmim ishte botimi i Enciklikës Sociale “Centesimus Annus” dhe i dokumentit të EDD-së “Mirëqenia e komunitetit dhe dobia individuale – masat ekonomike nën përgjegjësinë e së ardhmes”, të dy në vitin 1991, pra me rastin e 100-vjetorit të botimit të “Rerum Novarum”, të cilët janë shumë afër konceptit të Ekonomisë Sociale të Tregut. Në vitin 1998 u realizua “Mendimi i përbashkët mbi situatën ekonomike dhe sociale” i të dy kishave si shembull i bashkëpunimit ekumenik, me ndikime të mëdha tek diskutimi politik (krahaso Weigelt 1991 dhe 1994).

CDU-në Gjermane e gjeti edhe në themelimin e grupimit të punëtorëve evangjelistë të CDU-së dhe CSU-së (EAK) në vitin 1952 nga Kryetari i mëparshëm i Bundestagut Gjerman Hermann Ehlers. Qëllimi i EAK-së ishte që në fillim sigurimi i mbështetjes së protestantëve për qëllimet e CDU-së dhe CSU-së dhe bashkëpunimi me njërën nga dy partitë (anëtarësimi në parti nuk ishte i detyruar), krijimi i një platforme për interesat e anëtarëve evangjelistë të dy partive tek partitë me shumicë katolike, zgjerimi i lidhjeve me Kishat Evangjeliste dhe nxitja e bashkëpunimit të besueshëm midis feve në CDU dhe CSU.

Bazat normative të programit politik të Demokracisë Kristiane janë etika dhe kultura kristiane oksidentale. Shumë qartësisht programet e Demokracisë Kristiane pas 1945 – më fort se në periudhën midis Luftërave Botërore – theksojnë parimet kristiane personalistike: përgjegjësi dhe të drejta të patjetërsueshme të njeriut, e drejta për liri individuale politike, ekonomike dhe fetare. Vlerësimi më i rëndësishëm i konceptit të lirisë pas vitit 1945 dhe pohimi i palëkundur i të drejtave të njeriut, parimet e të cilave nuk duhet të shfuqizohen, ishin pasojat e përvojave negative me kolektivizmin nacionalsocialist, fashist dhe autoritar. Në këtë mënyrë konceptet liberal-kristiane përbëjnë në kundërpeshë ndaj nënshtrimit dhe përbuzjes së individit në emër të popullit, të partisë, të kombit, të klasës dhe të ideologjive të tjera totalitare.

INFORMACIONE SHITESË: DEMOKRACIA KRISTIANE NË AMERIKËN LATINE

Fillesat e Demokracisë Kristiane në Amerikën Latine i kanë rrënjët në Organizatat Studentore Katolike të viteve '30, të cilat inspiroheshin nga Teoria Sociale Katolike dhe nga Enciklikat Sociale të Papës. Lëvizjet kristian-sociale si edhe themelimi i mëvonshëm i Partive Kristian-Sociale lidhet ngushtësisht me emrin e Presidentëve të mëvonshëm të Kilit dhe Venezuelës, Eduardo Frei Montalva (1911-1982) dhe Rafael Caldera Rodriguez (1916-2009). Ngjarje të rëndësishme gjatë rrugës së themelimit të partive të para ishin nga njëra anë Kongresi i Lëvizjes Studentore Katolike gjatë ndërrimit të viteve 1933/34 në Romë dhe nga ana tjetër kriza ekonomike botërore në fillim të viteve '30.

Nën ndikimin e krizës ekonomike botërore dhe duke marrë parasysh politikën ekonomike liberale të Partisë Konservatore të Kilit, e cila para së gjithash përfaqësonte interesat e pronarëve të mëdhenj, u realizua ndarja e Organizatës Rinore të Partisë Konservatore. Me emrin *Falange Nacional* fillimisht si lëvizje dhe pas vitit 1938 si parti politike, ajo përfaqësoi para së gjithash idetë karitative dhe social-kristiane dhe u angazhua për përmirësimin e gjendjes sociale të shtresave të varfra. Rreth njëzet vjet më vonë (1957) nga *Falange* u krijua Partia Kristian-Demokrate e Kilit (PDC), kryetari i së cilës Eduardo Frei u zgjodh në vitin 1964 si Presidenti i parë kristian-demokrat i Amerikës-Latine.

Nën drejtimin e Rafael Calderas në vitin 1956 u formua në Venezuelë *Comité de Organización Político Electoral Independiente (CoPei)*, i cili buronte gjithashtu nga Rinia studentore katolike social-reformatore e vendit dhe tre vjet më vonë - duke ruajtur emërtimin e shkurtuar – e ndryshoi emrin në *Comité de Organización Política Electoral*.

Në mes të viteve 1950 dhe 1960 vijoi themelimi i partive të tjera kristian-demokrate, p.sh. në Peru, Bolivi, El Salvador, Paraguaj, Panama, në Republikën Domenikane, Uruguaj, Kosta Rika dhe Kolumbi. Kulmimi i Demokracisë Kristiane në Amerikën Latine u arrit në 1 dhjetor 1968, kur në Venezuelë Rafael Caldera u zgjodh si Presidenti i dytë Kristian-Demokrat i një vendi në Amerikën Latine.

Në programet e tyre Partitë Kristian-Demokrate u angazhuan për balancimin social të dallimeve të theksuara midis klasave, për reforma në sistemin arsimor, për reforma në bujqësi dhe për një sistem të një rendi ekonomik miks, i cili krahas pronave të kooperativave shtetërore u garantonte një vend të veçantë sipërmarrjeve të mesme dhe të vogla. (shiko p.sh. Klaus Weigelt: *Una comparación de los programas del PDC chileno y de la CDU alemana*. Santiago de Chile, 2008). Nën presidencën e Eduardoo Frei dhe Rafael Caldera në të dy shtetet u shtetëzuan nga njëra anë shumë degë kyçe të industrisë dhe produktet e bakrit, dhe nga ana tjetër puse naftë. Demokracia, liria, drejtësia dhe solidariteti ishin (dhe janë) modelet programatike të Partive Kristian-Demokrate në Amerikën latine.

Bazuar në politikën e tyre demokratike dhe të orientuar drejt balancimit social Partitë Social-Demokrate të Amerikës Latine ndodheshin gjithmonë në një “luftë me dy fronte”. Nga forcat e djathta (ushtarakët, pronarët e mëdhenj, industrialistët, organizatat e punëdhënësve, pjesërisht edhe konservatorët) të deklaruar shpesh si kundërshtarë të regjimit, dhe të ashtuquajturit socialromantikë (“*socialcristianismo*”) ose e thënë në përgjithësi “komunistët”, të pozicionuar majtas, ato konfrontoheshin me akuzën, se ishin shumë pak “revolucionare” dhe në këtë mënyrë ishin shndërruar në shtylla të pushtetit në favor të elitave jodemokratike. Problematik për pjesën më të madhe të Partive Kristian-Demokratike ishte fakti, se ato nuk ishin në gjendje të krijonin një elektorat të qëndrueshëm rreth vetes së tyre. Me gjithë përpjekjet programatike dhe praktike të Partive Demokratike dhe Social-reformatore dhe pjesërisht me gjithë rritjen e lartë ekonomike nuk u formua një shtresë e mesme e qëndrueshme dhe politikisht aktive. Përveç kësaj disa Parti Kristian-Demokrate, si për shembull COPEI në Venezuelë, gjatë qeverisjes së tyre u konsumuan si në personel dhe në përmbajtje, ose si në rastin e Partive Kristian-Demokrate në Nikaragua, dështuan pjesërisht për fajin e tyre por edhe për shkak të kushteve të vështira në vend për të vepruar. Me përjashtim të *Partido Demócrata Cristiano* (PDC) në Kili dhe të *Partido Acción Nacional* (Pan) në Meksikë – e cila për shkak të legjislacionit partiak në fuqi nuk mund të quhet “kristian-demokrate”, megjithëse ajo i ndërthur në program elementët kristian-demokratë me aspekte konservatore dhe liberale, thekson Ekonominë Sociale të Tregut si model ekonomik dhe është pjesë si e Unionit të Partive Kristian-Demokrate (ODCA) ashtu edhe e Internacionales së Partive Kristian-Demokrate (IDC) – pjesa më e madhe e Partive Kristian-Demokrate në vitet '90 u gjendën nën presion. Disfatave të pësuar gjatë drejtimit të qeverive, konsumimit të personelit në pozicionet drejtuese, mangësive organizative dhe strategjike iu shtua edhe fakti, që – ashtu si në Evropë – gjatë proceseve modernizuese, të sekularizimit dhe të individualizimit, të konstatuara edhe në Amerikën Latine, i humbën vlerat politike tërheqëse dhe mobilizuese që bazoheshin tek koncepti kristian për njeriun. Kjo ka bërë, që një numër i lartë Partish

Kristian-Demokrate, dikur të fuqishme, të humbasin në ditët e sotme fuqinë e tyre politike.

Humbja e rëndësisë së Partive Kristian-Demokrate lidhet sigurisht edhe me rënien e përgjithshme të partive – jo vetëm në Amerikën Latine. Ndër shkaqet kryesore bëjnë pjesë midis të tjerash humbja e ekskluzivitetit gjatë formimit të vullnetit politik, roli i masmediave si artikulum shtesë, personalizimi në rritje, zvogëlimi i rëndësisë së programeve dhe humbja e besimit të qytetarëve tek aftësia e politikës për të gjetur zgjidhje. Edhe zhvillimet e vetë Partive Kristian-Demokrate qysh prej viteve '90 e kanë përshpejtuar procesin e humbjes së rëndësisë. Këtu bëjnë pjesë midis të tjerash problemet me identitetin në koalicione, humbja e besueshmërisë të personelit drejtues, mos ripërtëritja e programeve, pengimi i modernizimit të partive për shkak të interesave të ndryshme, mungesa e shtrirjes së strukturave të partisë në të gjithë vendin përtej shtresës së mesme si edhe fakti, që demokratët kristianë kanë pasur lidhje me gjithçka, që në Amerikën Latine njihet me emrin “Neoliberalizëm”.

Ky liberalizim i programatikës së Demokracisë Kristiane shënoi bërjen e qartë të dallimit në Gjermani midis përgjegjësisë së një personi të krishterë dhe të qytetarit në familje, politikë dhe shoqëri nga njëra anë dhe detyrave dhe interesave kishtare-teologjike nga ana tjetër. Nëpërmjet këtij diferencimi Demokracia Kristiane synonte t'iu drejtohej edhe shtresave jo të krishtera si edhe qytetarëve dhe zgjedhësve që nuk shkonin në kishë. Ndërfetarizmi, ideja e një partie popullore dhe personalizimi kristian përbënin në këtë mënyrë kushtin, që Partitë Kristian-Demokrate në shumë vende perëndimore fituan shumicën dhe morën përsipër detyra qeverisëse. Njëkohësisht kjo shënoi një diferencim të detyrave dhe të shpërndarjes së detyrave midis kishave, shoqatave dhe lëvizjeve kishtare si edhe Partive Kristian-Demokrate.

Nuk mund të mos bjerë në sy fakti, që botëkuptimi politik kristian-demokrat, koncepti kristian për njeriun dhe etika sociale kristiane janë shprehur gjerësisht në rendin e periudhës së pasluftës. Se çfarë kuptimi kanë ekzistenca kristiane dhe përgjegjësia kristiane në situatën konkrete, kjo mund të marrë përgjigje vetëm nga ndërgjegjja e gjithsecilit. Teologjia, etika kristiane dhe kishat mund dhe duhet të ofrojnë orientime. Sigurisht që parimet e konceptit kristian për përgjegjësinë nuk përputhen me udhëzimet konkrete të klerikëve dhe të kishës.

Ndikim të ndjeshëm në diskutimet programatike të Partive Kristian-Demokrate në Evropë kishin në vitet e fundit idetë komunitariste që vinin nga hapësira anglo-saksone. Nisur nga tendencat aktuale shoqërore, si rënia e konceptit të bashkësisë, e erozionit të grupeve shoqërore dhe e uljes së angazhimit qytetar, këto ide synojnë – si korrigjim i individualizmit të tepërt në shoqëritë moderne – rigjallërimin e konceptit dhe të veprimit komunitar. Me idetë e tyre për shoqërinë dhe kërkesat për forcimin e veprimtarive vullnetare dhe qytetare komunitarizmi përputhet me parimet e konceptit kristian-demokrat dhe kristian-social. Nga pikëpamja historike dhe ideore është e vështirë që ta ndash të krishterën nga zhvillimet kishtare, sociale dhe politike, sepse besimi kristian në mënyrë të vazhdueshme është ndërmjetësuar edhe nëpërmjet kulturës. Bazat humane të kulturës evropiane, të cilat i kanë rrënjët tek Judaizmi, filozofia greke, e Drejta Romake,

Krishtërimi, Rilindja si edhe tek filozofia e Iluminizmit nuk janë zhvilluar në drejtim të kundërt, por shumë më tepër në bashkëveprim konkret me krishterimin.

Sfida e sotme e Partive Kristian-Demokrate është para së gjithash, që në kushtet e sekularizimit në rritje dhe të vazhdimt të shkatërrimit të mjedisit social të ofrojnë oferta politike dhe zgjidhje, të cilat bazohen në orientimin e vlerave kristiane dhe njëkohësisht të gjejnë zgjidhje për shumicën e zgjedhëseve dhe të zgjedhësve për problemet e tyre të përditshme që i shqetësojnë. Koncepti kristian për njeriun dhe vlerat bazë që burojnë prej tij, liria, solidariteti, subsidiariteti, drejtësia dhe orientimi drejt mirëqenies së komunitetit ofrojnë një bazë të gjerë ideore për të gjithë njerëzit – edhe për ata pa besim fetar – për të marrë pjesë aktivisht në politikë, shoqëri dhe kulturë.

INFORMACIONE SHITESË: DEMOKRACIA KRISTIANE NË AMERIKËN LATINE

Aktualisht në mbarë botën ka dy Shoqata qendrore, në të cilat janë grupuar Partitë Kristian-Demokrate, Qytetare-Konservatore, Kristian-Sociale dhe Partitë e Qendrës (së djathtë): Internacionalja Kristian-Demokrate (*Centrist Democrat International - Internationale Démocrate-Chrétienne*, CDI-IDC), e themeluar në vitin 1961 në Santiago de Chile, me seli në Bruksel nga njëra anë dhe nga ana tjetër Unioni Internacional Demokrat (*International Democrat Union*, themeluar në 1983 në Londër) me seli në Oslo. Presidentë të CDI-ISC-së janë ish-presidenti i Meksikës, Vicente Fox Quesada, si edhe ish-presidenti i Dhomës Italiane të Deputetëve, Pier Fernando Casini. Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës është Antonio López-Istúriz nga Spanja. IDU-ja drejtohet nga Kryeministri i dikurshëm australian John Howard.

Të dy organizatat qendrore ndahen në katër (CDI-IDC) përkatësisht tre (IDU) shoqata rajonale. Tek CDI-IDC janë këto në Afrikë *CDI-International-Africa* me aktualisht dhjetë anëtarë, për rajonin Azi-Paqësor *CDI Asia-Pacific* me aktualisht 14 anëtarë, për Amerikën *Organización Demócrata Cristiana de América* (ODCA) me 35 parti anëtare dhe për Evropën Partia Popullore Evropiane (EVP), e cila aktualisht numëron 48 anëtarë me të drejta të plota dhe gjashtë anëtarë të asociuar. Tetëmbëdhjetë parti kanë në EVP status vëzhguesi.

Organizatrat rajonale të Unionit Internacional Demokrat janë për Afrikën *Democrat Union of Africa* (DUA) me 14 parti anëtare, për Amerikën *Unión de Partidos Latinoamericanos* (UPLA) me aktualisht 19 anëtarë dhe për rajonin Azi-Paqësor *Asia Pacific Democrat Union* (APDU), tek i cili aktualisht bëjnë pjesë 14 parti. Seksioni evropian i PDU-së ishte deri në tetor 2002 Unioni Demokrat Evropian (EDU). Ndërkohë ai është shkruar plotësisht me EVP-në.

Qëllimet kryesore të dy shoqatave janë nxitja e bashkëpunimit mes Partive Demokratike të Qendrës me programe të ngjashme dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal. Duke u mbështetur tek përparimi i ndjeshëm i integritimit evropian ky qëllim është prioritet i qartë i EVP-së. EVP-ja e themeluar në vitin 1976 në Luksemburg nuk është vetëm një aleancë midis Partive evropiane Kristian-Demokrate, Sociale dhe Qytetare-Konservatore, ajo është një Parti evropiane me programin e saj dhe me strukturat dhe procedurat përkatëse të legjitimuara në mënyrë demokratike.

Presidenti i EVP-së është qysh prej vitit 1990 ish-Kryeministri i Belgjikës Wilfred Martens (shiko 4.6). Organi më i lartë vendimmarrës është Kongresi, i cili mbledhet të paktën çdo dy vjet me vendim të kryesisë për të zgjedhur Presidentin, Zëvendëspresidentët, përgjegjësin e financës dhe Sekretarin e Përgjithshëm (së bashku me kryetarin e grupit parlamentar të EVP-së në Parlamentin Evropian personat e

sipërpërmendur formojnë Kryesinë e Partisë) si edhe për të miratuar direktivat partiake, programin e EVP-së si edhe ndryshimet e statutit.

Në EVP ka katër lloje anëtarësimi: anëtarë me të drejta të plota, anëtarë të asociuar, vëzhgues si edhe anëtarë individualë. Anëtarë me të drejta të plota mund të bëhen Parti Kristian-Demokrate dhe parti të përafërta nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE), sa kohë që ato janë të organizuara në vendet anëtare, e përqafojnë programin e EVP-së dhe pranojnë Statutin e EVP-së (Statuti i EVP-së neni 4a).

Anëtarë të asociuar të EVP-së mund të bëhen partitë e një shteti, i cili ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në BE dhe që përmbushin kushtet e statutit të EVP-së. Anëtarët e asociuar gëzojnë të gjitha të drejtat ashtu si edhe anëtarët me të drejta të plota, por vetëm me një përjashtim: për vendimmarrjet, të cilat lidhen me politikën dhe strukturën e BE-së si edhe me sistemin e tij institucional, ato nuk mund të shprehen (neni 13c). Statusin e vëzhguesit mund ta marrin parti nga vendet anëtare të BE-së, nga shtete që kanë paraqitur kërkesën për anëtarësim, si edhe nga shtete që janë pjesë e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, krijuar në vitin 1999. Partitë me status vëzhguesi kanë të drejtë që të marrin pjesë në takimet e EVP-së. Kryetarët ose Sekretarët e tyre të Përgjithshëm ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e forumeve të partisë, por pa të drejtë vote. E njëjta gjë vlen për delegatët në kongreset e EVP-së. Anëtarë individualë mund të bëhen persona, të cilët japin një mbështetje të veçantë për EVP-në. Ata duhet të jenë pjesë e një partie anëtare, dhe sa kohë që janë MdEP, mund të jenë edhe anëtarë me të drejtë vote në organet e EVP-së. Momentalisht këtë status e gëzojnë vetëm 130 persona.

Me shtatë unionet e saj EVP-ja gëzon larminë më të madhe të grupimeve ndër partitë evropiane: Unioni Evropian për Politikën Komunale dhe Rajonale (EKRPV), Unioni Evropian i Punëmarrësve Kristian-Demokratë (EUCDA), Unioni Evropian për Sipërmarrjet e Mesme dhe Ekonominë (EMWV), Unioni Evropian i Seniorëve (ESU), Unioni i Grave të EVP-së, *European Democrat Students* (EDS) dhe Organizata Rinore YEPP. Më këta Unione, të cilët janë shumë të ngjashëm me atë të CDU-së, EVP-ja synon që të jetë një parti e vërtetë popullore, e cila mund t'ia dalë mbanë me integrimin e grupeve të ndryshme të popullsisë dhe që është në gjendje që të balancojë interesat e ndryshme.

Në zgjedhjet e fundit në 2009 për në Parlamentin Evropian EVP-ja është përsëri me 265 nga 736 deputetë grupi më i madh parlamentar. Kryetar i grupit është francezi Joseph Daul i *Union pour un mouvement populaire* (UMP).

Burimi: paraqitje personale mbështetur në të dhënat e Gehlen (2005).

3. POLITIKA KRISTIAN-DEMOKRATE NË DITËT E SOTME: FUSHA TË PËRZGJEDHURA NGA POLITIKA

3.1 POLITIKA EKONOMIKE

Modeli i politikës ekonomike të Demokracisë Kristiane është Ekonomia Sociale e Tregut, edhe pse ky nocion varion nga shteti në shtet (shiko shënimin 1). Ajo është lidhja e sprovuar dhe e suksesshme e parimeve të ekonomisë së tregut me elementë të politikës sociale për të arritur balancën sociale. Ekonomia Sociale e Tregut nuk është vetëm një sistem ekonomik, por edhe një koncept shoqëror, për të cilin në shumë demokraci në Evropën Perëndimore, para së gjithash në Gjermani, Belgjikë, Holandë, Luksemburg dhe Austri, ekziston një konsensus i gjerë.⁶ Në Ekonominë Sociale të Tregut liria dhe përgjegjësia, konkurrenca dhe solidariteti shkrihen në një njësi të vetme.

Mbështetur në vlerësimin e lirisë individuale nga Demokracia Kristiane dhe tek mendimi, se njeriu gëzon të drejtën për shpалosjen e lirë të personalitetit të tij (teoria kristiane për të drejtën natyrore), Kristian-Demokratët kanë vazhduar me vlerësimin dhe mbështetjen për iniciativën e lirë sipërmarrëse mbi bazën e pronës private me obligime sociale dhe për një konkurrencë të ndershme midis shërbimeve. Në “Direktiva për mirëqenie, drejtësi sociale dhe ekonomi të qëndrueshme”, e cila është botuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, thuhet: “Konkurrenca funksionale është motori i ekonomë së qëndrueshme. Ajo mbështet efikasitetin dhe zhvillimin, forcon veprimet e përgjegjshme dhe pengon krijimin e fuqive të njëanshme në treg.” (KAS 2009:4).

Por koncepti kristian për njeriun thekson, se njeriu zotëron ndërgjegje dhe përgjegjësi sociale, dhe po ashtu, se shoqëria mban përgjegjësi sociale ndaj anëtarëve të saj më të dobët. Për këtë arsye për solidaritet nuk zotohet vetëm Demokracia Sociale, ajo përbën edhe qëllimin e rendit të saj ekonomik dhe social, Ekonomisë Sociale të Tregut.

Ikona ekonomike model e Ekonomisë Sociale të Tregut është e ashtuquajtura “*pronarë-sipërmarrës*”, e cila përmban faktorë prodhues (kapital, makineri/pajisje, truall) – ose të paktën i disponon këto lirisht – dhe i përdor për të prodhuar të mira dhe shërbime dhe i shet këto me fitim në tregun përkatës. Fitimi i realizuar në treg shërben si për pronarin-sipërmarrës dhe për familjen e tij ashtu edhe për rikthimin në ciklin ekonomik, p.sh. nëpërmjet krijimit të vendeve të punës apo blerjes së makinerive dhe pajisjeve të reja. Pronarët-sipërmarrës mbajnë përgjegjësi me gjithë pasurinë e tyre për vendimet sipërmarrëse. Prandaj këto vendime duhet të jenë më të qëndrueshme dhe më afatgjata dhe në këtë mënyrë stabilizojnë zhvillimin ekonomik dhe social.

Në këtë sistem shteti garanton para së gjithash kushtet bazë, me të cilat pronari-sipërmarrës mund të shpалosë aktivitetet e tij, dmth. ai përcakton rregulla për konkurrencën, mbështet

⁶ Prej kohësh ky koncept është pranuar plotësisht të paktën nga Partitë Demokratike dhe nga organizatat simotra (sindikatat); gjithashtu edhe nga parti (post)komuniste dhe neofashiste. Për këtë arsye në programin parimor të CDU-së në Gjermani shkruhet: “Ekonomia Sociale e Tregut është një rend ekonomik-social në demokracitë e lira”. (CDU 2007: 48).

lirinë tregtare dhe kontraktore dhe krijon premiset materiale, që mallrat dhe shërbimet të mund të shkëmbehen në tregun përkatës, p.sh. nëpërmjet investimeve publike në rrugë dhe rrjete komunikimi.

Për këtë arsye në Ekonominë Sociale të Tregut mbështetja për sipërmarrjet, të cilat drejtohen nga vetë pronarët e tyre, luan një rol vendimtar (mbështetja për sipërmarrjet e mesme). Këto sipërmarrje të mesme⁷ janë “zemra” e Ekonomisë Sociale të Tregut; Kancelari i parë gjerman, Konrad Adenauer, e konsideroi shtresën e mesme si “shtresa që mban shtetin”. Sipërmarrjet e mesme kanë numrin më të madh të të punësuarve (në Gjermani rreth tre të katërtat e të punësuarve punojnë në sipërmarrje të mesme), ato formojnë pjesën më të madhe të praktikantëve dhe kontribuojnë me rreth gjysmën e produktit të brendshëm bruto. Prandaj mbështetje për shtresën e mesme në Ekonominë Sociale të Tregut do thotë, që shteti përpiqet për një sistem tatimor⁸ sa më të thjeshtë dhe të drejtë, i cili u ofron sipërmarrjeve të mesme hapësira të mjaftueshme për investime dhe për krijimin e vendeve të reja të punës, që t’i minimizojë apo heqë pengesat burokratike, që sipërmarrjet e mesme të merren në konsideratë gjatë tenderëve publikë ose që ato të marrin kredi me përqindje të favorshme.

Krahas kësaj Partitë Kristian-Demokrate japin edhe mbështetje aktive për ekonominë. Këtu bëjnë pjesë p.sh. struktura rajonale politike industrialiste e më gjerë, për të dhënë nxitje për krijimin e qendrave prodhuese, për të balancuar diskriminimin në zonat më pak të zhvilluara dhe për të kontribuar në mbrojtjen e aftësisë konkurruese të prodhuesve vendas. Ky lloj i politikës ekonomike realizohet për shembull nëpërmjet investimeve publike në infrastrukturë rrugore, marrjes përsipër të garancive të përkohshme shtetërore për investitorët privatë, pakësimi të rregullave ligjore apo dhënies së mbështetjes financiare për teknologji të përparuara dhe që janë në mbrojtje të mjedisit. Megjithatë Partitë Kristian-Demokrate mbajnë qëndrim skeptik ndaj ndërhyrjeve të shtetit, sepse ndërhyrjet shtetërore përbëjnë ngarkesë për kasat publike, pengojnë shpesh zhvillimet në ekonominë private dhe zakonisht kanë karakter strukturor.

Megjithatë kufijtë e mbështetjes aktive për ekonominë dhe të ndërhyrjeve strukturore nuk janë të përcaktuar qartësisht. Prandaj politika ekonomike kristian-demokrate qëndron në një fushë tensioni midis gjykimeve parimore dhe detyrimeve politike, siç bëhet e qartë nga shembulli për subvencionimin e degëve të caktuara të ekonomisë. Nga njëra anë Partitë Kristian-Demokrate ndërkohë e kanë çuar përpara uljen e subvencioneve për ato degë të ekonomisë që

⁷ Komisioni i BE-së përcakton si sipërmarrje të mesme, ato që kanë një pronar, punësojnë deri në 250 persona dhe në vit nuk kanë xhiro më të lartë se 50 milionë euro.

⁸ Me gjithë veçoritë e sistemeve të taksave në Evropën Perëndimore mund të thuhet, se në vendet e drejtuara nga Kristian-Demokratët parimisht taksat janë më të ulëta se në vendet që për një kohë të gjatë janë drejtuar apo drejtohen nga Partitë Socialdemokrate. Kështu taksa për korporatat në Gjermani është 15%, në Zvicër mesatarisht 20%, në Luksemburg 22,9% si edhe në Holandë dhe Austri 25%. Kjo taksë është më e ulët se taksat në vendet skandinave “socialdemokrate”, ku ajo arrin mesatarisht në 28%. Edhe taksat për subjektet tregtare dhe të ardhurat në këto vende janë më të larta. Shteti skandinav i financon shërbimet e veta të sigurimeve shoqërore kryesisht nga të ardhurat nga taksat, ndërsa vendet e drejtuara nga Kristian-Demokratët kanë kryesisht sisteme të sigurimeve shoqërore të financuara nga kontributet. Këtu pasqyrohet edhe parimi i subsidiaritetit si edhe sigurimet shoqërore të organizuara në bazë korporate, tek të cilët shërbimet publike nuk mbulohen vetëm nga shteti, por nga njësitë vartëse në përgjegjësinë e tyre (në Gjermani p.sh. në kuaktë të ashtuquajturës “vetëadministrim”).

nuk janë rentabël (p.sh. minierat), nga ana tjetër me miratimin e tyre vazhdon subvencionimi i degëve të caktuara të ekonomisë, veçanërisht i bujqësisë. Edhe pse kjo në radhë të parë argumentohet me ruajtjen e aftësisë konkurruese të prodhuesve vendas, këtu luan një rol taktika zgjedhore.

Megjithatë politika financiare e Partive Kristian-Demokrate karakterizohet më shumë për disiplinë buxhetore (politika financiare restriktive) sesa politika financiare e Partive Socialdemokrate apo e Partive Socialiste. Ndërsa Socialdemokratët dhe Socialistët përkrahin më shumë aktivitetet shtetërore⁹ dhe kështu që pranojnë edhe deficite strukturore në buxhet, politika financiare kristian-demokrate është e orientuar parimisht drejt buxheteve të balancuar. Ky pozicionim, nga njëra anë, e ka origjinën nga koncepti kristian-demokrat për politikën shtetërore dhe financiare (“Aq shumë shtet sa është e nevojshme, sa më pak shtet që të jetë e mundur”), nga ana tjetër nga përvoja, të ardhurat kapitale dhe të ardhurat nga puna nuk duhet të ngarkohen shumë, në mënyrë që në ekonomi të lihen hapësira të lira për konsum dhe rifinancim privat (investime private)¹⁰.

3.2. POLITIKA SOCIALE

Politika sociale është një instrument për vendosjen e drejtësisë sociale dhe të balancës sociale. Ajo përfshin të gjitha masat e shtetit, të cilat shërbejnë për garantimin e të ardhurave bazë dhe të një jete me dinjitet në rast sëmundjesh, paaftësie të parakohshme për punë (aksident apo invaliditet), në rast vdekjeje të pjesëtarëve të familjes, në pleqëri apo në rast papunësie. Krahas kësaj pjesë e politikës sociale janë edhe ndihma për familjen (shiko 3.3), ndërtimi i banesave publike, ndihma për të rinjtë dhe ndihma sociale. Bazuar në dallimet ekzistuese midis njerëzve që burojnë nga prejardhja sociale, kushtet e banimit, shkalla e arsimimit apo mundësia për shkollim nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga risqet që mbart në vetvete tregu (i punës), arrihet në përfundimin se politika shtetërore sociale bëhet e domosdoshme për përmirësimin e situatës jetësore të personave në nevojë dhe për mbrojtjen nga risqet e tregut. Përkufizimi i “drejtësisë sociale” varion ndjeshëm, edhe midis shteteve dhe shoqërive të krahasueshme, p.sh. brenda BE-së (15) apo OECD-së. Dallime domethënëse shfaqen edhe tek

⁹ Dallimet midis politikës ekonomike socialdemokrate dhe kristian-demokrate shfaqen në drejtim të kuotës shtetërore (përqindja e shpenzimeve shtetërore për performancën e përgjithshme ekonomike) apo tek kuota e punësimit në shërbimin publik (administrata publike, sigurimi shoqëror, shëndetësia, policia, arsimit). E thënë më thjesht, kuota shtetërore në vendet e Evropës Perëndimore, të cilat për një kohë të gjatë janë qeverisur nga Kristian-Demokratët, është nën 50 % (në Gjermani për shembull 45%), në vendet e drejtuara nga Socialdemokratët përkundrazi është mbi 50% (Suedia p.sh. 55%). Kuotat e punësimit në sektorin publik në vendet e drejtuara nga Socialdemokratët është mesatarisht 20%, në vendet e drejtuara nga Kristian-Demokratët rreth 10%. Kjo do të thotë, se për të arritur një produkt të brendshëm bruto të lartë, të shoqëruar me zhvillim dhe mirëqenie, si edhe për krijimin e vendeve të punës Demokracia Sociale bazohet më shumë tek rendi ekonomik dhe social privat.

¹⁰ Edhe në krizën e tregjeve financiare dhe ekonomike në vitet 2008/09, gjatë së cilës politika ishte e detyruar të ndërhynte për stabilizimin e tregut me qëllim lehtësimin e pasojave, midis Partive Kristian-Demokrate dhe Partive të Qendrës së Majtë u shfaqën qëndrime të ndryshme. Ndërsa këto të fundit kërkonin gjithnjë paketa konjunkturale shtetërore dhe garanci nga ana e shtetit për sipërmarrjet e prekura, Partitë Kristian-Demokrate reagon parimisht më me vetëpërmbytje dhe kërkuan investitorë privatë, si p.sh. koncernin e prodhimit të automjeteve Opel apo ndërmoren negociata shpëtimi për industrinë e prekur detare.

argumentimi i politikës sociale, zgjedhjes së mjeteve të përdorura për arritjen e balancës sociale dhe tek masat shtetërore. Kjo varet nga fakti, se në çfarë botëkuptimi bazohemi dhe cilat qëllime social-politike duhen arritur.

Partitë Socialiste dhe Socialdemokrate e argumentojnë politikën sociale shtetërore me konceptin e tyre material për drejtësinë sociale. Ata, të cilët kanë pasuri apo te ardhura të larta, duhet të japin; ata që nuk kanë pasuri apo kanë vetëm të ardhura të pakta duhet të marrin “përkrahje sociale”. Pra nëpërmjet rishpërndarjes së pasurisë dhe të ardhurave nga shteti “nga sipër poshtë” Partitë Socialiste dhe Socialdemokrate përpiqen që të minimizojnë pabarazinë sociale midis njerëzve. Këtu shteti qëndron në qendër. Nëpërmjet autoriteteve të tij tatimore ai mbledh mjete, i administron ato dhe i përcjell të ashtuquajturat kontribute të transferueshme tek personat në nevojë. Simptoma të këtij shteti social socialdemokrat janë midis të tjerave taksa të larta për pasurinë dhe të ardhurat (p.sh. vlerat më të larta për tatimin mbi të ardhurat deri në 70%), të ardhura shumë të larta nga mbledhja e taksave dhe një sektor publik me një numë të lartë të punësuarish, veçanërisht në burokracinë publike, e cila administron mjetet për politikën sociale dhe i transferon ato.

Ky botëkuptim paternalist për shtetin dhe zbatimi i tij si një “makineri rishpërndarëse” social-politike mbërriti në limitet e aftësisë financuese në mes të viteve '90. Ai i çimento i në mënyrë të njëjtë kërkesat për shërbime social-politike, ka nxitur pasivitetin dhe për shkak të taksave të tij të larta ka kufizuar angazhimin në ekonominë private dhe ka nxitur largimin e kapitalit. Ndërkohë që Partitë Socialiste në disa shtete vazhdojnë ende t'i përmbahen fort këtij modeli, pjesa më e madhe e Partive Socialdemokrate të Evropës Perëndimore në mes të viteve '90 e kanë braktisur këtë model të shtetit gjithëpërfshirës dhe social, të mbështetur në traditë – pjesërisht duke u konfliktuar ashpër me të ashtuquajturit tradicionalistë dhe modernistë, por pjesërisht edhe duke paguar çmimin e shkatërrimit, ndarjes, humbjes së identitetit apo të dobësisimit masiv.¹¹

Partitë Kristian-Demokrate i argumentojnë shërbimet social-politike me mbrojtjen e dinjitetit individual të njeriut, i cili duhet të mbrohet pavarësisht nga pozicioni i përkohshëm në tregun e punës. Në dallim nga Socialdemokracia tradicionale në thelb të politikës sociale kristian-demokrate nuk ka qenë dhe nuk është aspak nivelimi i dallimeve sociale. Në vend të kësaj ajo ka si qëllim të japë mbështetje të përkohshme për njerëzit në vështirësi sociale, nëse ata apo familja nuk janë në gjendje që të kujdesen për veten – në përputhje të plotë me parimin e solidaritetit të Etikës Sociale Kristiane dhe me konceptin kristian-demokrat të subsidiaritetit.

¹¹ “Rruga e tretë” e Partisë Laburiste britanike nën drejtimin e Tony Blair, !Akhenda 2010” e SPD-së në Gjermani nën drejtimin e Gerhard Schröder apo reformat fiskale, të punësimit dhe social-politike të PvdA në Holandë nën drejtimin e Wim Kok, pjesërisht edhe SAP-ka suedeze nën drejtimin e Göran Persson janë shembull, se disa Parti Socialdemokrate në Evropën Perëndimore u larguan nga pozitat e tyre tradicionale dhe nëpërmjet koncepteve aspak tradicionale për socialdemokratët arritën një rritje të përkohshme të ekonomisë dhe të punësimit. Kursi i tyre i reformave ekonomike dhe social-politike përbëhej para së gjithash nga një ndërthurje midis uljes së taksave për gjallërimin e investimeve private dhe të konsumit të brendshëm, shkurtimit të shërbimeve sociale dhe rritjes së detyrimit për pranimin e tyre (“Mbështetje dhe detyrim”). Partitë e përmendura kanë paguar një çmim shumë të lartë për këtë ndryshim kursi, sepse përkrahësit e tyre tradicionale nuk ishin të përgatitur për ta përballuar këtë kurs të ri.

Ai synon t'i aftësojë vazhdimisht njerëzit që të marrin vendime të pavarura dhe t'i bëjë ata plotësisht të pavarur nga ndihma e vazhdueshme e shtetit dhe nga varësia prej tij (maturia).

Në sektorin e sigurimeve shoqërore, i cili në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Perëndimore përfshin sigurimin shëndetësor, sigurimin e pleqërisë, sigurimin shoqëror, dhe sigurimin ndaj papunësisë, pagesit e kontributeve fitojnë të drejtën ligjore për përfitimin e këtyre shërbimeve. Partitë Kristian-Demokrate nuk synojnë (synonin) në mënyrë primare, ashtu si Socialdemokracia tradicionale (veçanërisht në Skandinavi) aplikimin e sistemeve të organizuara shtetërore dhe të sistemeve të rishpërndarjes së të ardhurave nga taksat, por sigurimi shoqëror i financuar me kontribute të njëjta nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, i cili nuk mbështetet nga shteti, por vetëadministrohet. Edhe këtu shprehen parimet kristian-demokrate të përgjegjësisë individuale, decentralizimit dhe subsidiaritetit. Në kohën kur sistemi i financimit me kontribute të barabarta në fund të viteve '80 pësoi një krizë për shkak të kushteve të lëvizjeve demografike, globalizimit në rritje dhe rritjes së trysnisë së kostove, ishin përsëri veçanërisht Partitë Kristian-Demokrate, të cilat duke u qëndruar besnike bindjeve të tyre për përgjegjësinë individuale aplikuan elementë të sigurimit privat dhe sipërmarrës shtesë (veçanërisht në sektorin e sigurimit shëndetësor dhe të sigurimit shoqëror), por megjithatë ato nuk e braktisën asnjëherë qëndrimin solidar të Ekonomisë Sociale të Tregut.

Me gjithë parimet e përbashkëta në fushën e politikës sociale të Partive Kristian-Demokrate në Evropën Perëndimore, ka edhe dallime në detaje, të cilët të çojnë tek çështja e efikasitetit të politikës sociale (gjysmë)shtetërore. Në sektorin e politikës së punësimit dhe të tregut të punës Kristian-Demokratët gjermanë dhe austriakë i kanë përdorur prej kohësh të ardhurat nga kontributet për të ashtuquajturën “politikë pasive në tregun e punës”, pra për mbështetjen e të papunëve dhe të pensioneve të parakohshëm; veçanërisht kjo e fundit për të “pastruar” tregun e punës. Në kontrast me këtë në Holandë është vënë theksi tek masat “aktive” dhe “aktivizuese” si formimi, kualifikimi apo ritrajnimi i të papunëve (në moshë), dhe konkretisht në mënyrë të ngjashme si nga Kristian-Demokratët ashtu edhe nga Socialdemokratët. Kjo duhej të mundësonte para së gjithash riintegrimin në tregun e punës të punëmarrësve në moshë, por duhej shfrytëzuar përvoja e tyre në punë dhe kompetencat e tyre sociale, pa harruar faktin, që të punësuarit, pavarësisht nga mosha, janë taksapagues dhe pages kontributesh. Pa dyshim që për ekonominë është më e favorshme që ata të aktivizohen, dmth. atyre t'u jepet një shans në tregun e punës, sesa thjesht vetëm t'u japësh ndihmë financiare. Këtë teori aktivizuese e kanë ndjekur ndërkohë pjesa më e madhe e Partive Kristian-Demokrate të Evropës Perëndimore, sigurisht jo vetëm për shkak të efikasitetit të përgjithshëm të ekonomisë, por edhe, sepse ajo mundëson zbatimin e parimeve kristian-demokrate si një jete e denjë dhe e përgjegjshme në liri dhe jo në varësi të ndihmës sociale, aftësimi për të siguruar vetë të ardhurat dhe solidariteti.

“Puna (punësimi) në fakt nuk është gjithçka, por pa punë, para së gjithash pa të ardhura nga puna, çdo gjë është një hiç”, thotë një proverb i vjetër nga politika e tregut të punës. Qëllimet e politikës ekonomike dhe sociale kristian-demokrate janë që t'u ofrojnë njerëzve mundësinë e shpalosjes së tyre të lirë në treg, p.sh. si “pronarë-sipërmarrës” të mesëm dhe të mbështetin mekanizmat e tregut nëpërmjet monitorimit dhe kuadrit ligjor apo nëpërmjet pjesëmarrjes në tregun e punës, sigurimit të kushteve humane në punë dhe forcimit të sistemeve të qëndrueshëm të sigurimeve shoqërore për të mundësuar një jetë në liri, siguri sociale dhe

përgjegjësi shoqërore. Ekonomia Sociale e Tregut, si një lidhje midis ekonomisë së lirë dhe solidaritetit social është koncepti shoqëror, i cili synon që t'i realizojë këto qëllime. Një vështrim në historinë e zhvillimit të Kristian-Demokracisë në Evropë tregon, se kjo – me gjithë luhajat ciklike dhe tërheqjet e përkohshme, të cilat janë pothuajse të pashmangshëm në drejtimin politik të tregut – ka rezultuar shumë e suksesshme.

3.3 POLITIKA FAMILJARE

Politika familjare krijon kushtet bazë ekonomike, sociale dhe kulturore për një shpalosje sa më të mirë të familjeve. Në këtë mënyrë ajo lëviz në një fushë tensioni midis garantimit të lirisë familjare dhe drejtësisë sociale, po ashtu ajo duhet të ofrojë qëndrueshmëri dhe besueshmëri. Lidhja martesore dhe familja në Gjermani e gjejnë shprehjen e tyre në Kushtetutë; ato gëzojnë “mbrojtje të veçantë nga shteti” (neni 6 [1] i Kushtetutës). Politika familjare është konsoliduar pas Luftës së Dytë Botërore si një politikë gjithëpërfshirëse.

Familjet japin kontribute bazë dhe me mjaft rëndësi për njeriun dhe shoqërinë, të cilat përfshijnë si garantimin e vazhdimësisë së brezave, funksioneve qendrore edukuese dhe formuese ashtu edhe mbulimin e nevojave elementare jetësore të anëtarëve të familjes dhe forcimin e solidaritetit midis brezave. Për politikën familjare si politikë shoqërore ka rëndësi të madhe, që si marrëdhëniet midis prindërve ashtu edhe marrëdhëniet prindër-fëmijë të jenë mundësisht në përputhje me të gjitha strukturat shoqërore. Jo pa shkak, p.sh. Ligji për Ndhimën për Fëmijët dhe të Rinjtë në Gjermani parashikon për prindërit ofertën për këshillime në çështjet e partneritetit, e cila kontribuon, që në familje të ndërtohet një bashkëjetesë mbi baza partneriteti. Familjet dhe politika familjare në Gjermani gjatë viteve të fundit nga një çështje politike e dorës së dytë kanë zënë vend në qendër të interesit politik. Edhe politika familjare aktuale e CDU-së i përgjigjet ndryshimeve shoqërore. Ndryshimet e thella demografike, ndryshimet në strukturën familjare dhe ndryshimi i konceptit të vetëkuptimit si edhe konceptet e ndryshme kulturore dhe etnike, për të jetuar në familje, e kanë vendosur politikën familjare përpara sfidave të reja.

Për Unionin Kristian-Demokrat në Gjermani Familja është kudo ku prindërit mbajnë përgjegjësi për fëmijët dhe fëmijët për prindërit. Në këtë mënyrë ajo i përmbledh të gjithë brezat. Lidhja martesore është modeli kristian-demokrat i bashkimit midis burrit dhe gruas. CDU-ja respekton edhe vendimet e njerëzve, të cilët në jetën e tyre realizojnë forma të tjera partneriteti.

Me botëkuptimin e saj për familjen CDU-ja dallon nga partitë e tjera, pasi ajo përgjegjësinë për edukimin dhe shkollimin e fëmijëve ua ngarkon qartazi prindërve dhe në konceptin a saj për familjen ajo mbështetet në parimin e subsidiaritetit. Për pjesën më të madhe të njerëzve familje do të thotë siguri, mbrojtje dhe besim. Normalisht ajo është vendi i parë ku fëmijët mësojnë për vlerat e komunitetit dhe bashkëjetesës si dashuria për të tjerët dhe solidariteti. Në familje edhe praktikohet, çka është esenciale për solidaritetin e shoqërisë si një e tërë.

Sipas botëkuptimit kristian-demokrat mbështetës për politikën familjare nuk është vetëm shteti, por një sërë faktorësh shtetërorë, kishtarë dhe të pavarur (privatë), të cilët mundësojnë

oferta dhe aktivitete të diferencuara dhe në këtë mënyrë përpiqen që t'i përshtaten larmisë së nevojave jetësore familjare. Politika familjare reflektohet edhe në sistemet e tjera mbështetëse, furnizuese dhe plotësuese. Ajo përfshin masat e institucioneve publike si edhe aktivitetet e sektorit privat, të shoqatave dhe iniciativave.

Familja është vendi, ku formohen dhe jetojnë vlerat themelore të shoqërisë sonë. Për këtë arsye politika familjare është gjithnjë politikë për të ardhmen. Duke qenë se premissat shoqërore për familjet në dekadat e kaluara ndryshuan në mënyrë drastike, CDU-ja reagoi ndaj ndryshimit të nevojave të familjeve me një politikë familjare të qëndrueshme dhe u kujdes për kushte më të mira, në mënyrë që të mundësonte një jetë familjare. Për këtë gjatë viteve të shkuara u ristrukturoi dhe zgjeruar shërbimet dhe u aplikuan rregulla të reja, për të qenë më efikas.

Deri tani politika familjare kuptohej si pjesë e politikës sociale të shtetit. Pesë dekada më radhë ajo zbatohej nëpërmjet “tre pjesëve” të ngurtësuar të fjalisë, sipas të cilave 1) shteti 2) duhet t'u japë më shumë para 3) të gjitha familjeve – dhe mundësisht të gjithave njëloj. Ky konceptim i politikës familjare ishte pjesë përbërëse e një logjike të përbashkët të shtetit social, me vullm të konsiderueshëm financiar, por pak i vlerësuar nga aktorët kryesorë. Përballë ndryshimeve të mëdha që shkaktuan lëvizjet demografike, ndryshimit të botës së punës, koncepteve të ndryshme kulturore për familjen si edhe kërkesave të rritura për shkollim dhe edukim duhet të rindërtohet një politikë familjare e orientuar drejt së ardhmes.

Pikërisht CDU-ja, e cila mbështetet tek vlerat tradicionale dhe përkrah një ndryshim të orientuar drejt vlerave, angazhohet për politikë që mbështet familjen e qëndrueshme. **Togfjalëshin** e përbërë nga **transferimi financiar, politika e kohës dhe zgjerimi i infrastrukturës CDU-ja** e konsideron si politikë të qëndrueshme familjare. Të tre këta sektorë kanë njohur zhvillim gjatë viteve të fundit. Kështu krahas rritjes së *ndihmës financiare për fëmijët* në fillim të vitit 2007 është aplikuar¹² edhe *ndihma financiare për prindërit* si shtyllë e rëndësishme e një politike familjare moderne dhe të qëndrueshme. Ajo mundëson pas lindjes së një fëmije mbrojtjen e nevojshme për një start të mbarë në jetën komunitare të anëtarit të ri të familjes. Në fakt ndihma financiare për prindërit ka zëvendësuar *ndihmën financiare për rritjen e fëmijës* që jepej më parë. Kjo e fundit jepej kryesisht për familje me të ardhura të pakta financiare me të ardhura vjetore bruto deri në 30.000 Euro. Me aplikimin e ndihmës së re financiare për prindërit politika e sotme familjare mbërrin tek të gjitha familjet.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i politikës së qëndrueshme familjare është *koha*, sepse familjeve u nevojitet kohë për të qëndruar së bashku. Të mos kesh kohë për fëmijët, është një nga arsyet më të rëndësishme për të mos pasur familje apo fëmijë dhe kjo shkatërron shumë

¹² Mbështetja financiare për fëmijët jepet pavarësisht nga të ardhurat dhe është e përshkallëzuar në varësi të numrit të fëmijëve. Për fëmijën e parë dhe të dytë ajo është përkatësisht 184 euro, për fëmijën e tretë 190 euro dhe për fëmijën e katërt dhe për secilin nga fëmijët e tjerë është 215 euro në muaj. Kjo mbështetje financiare për fëmijët parimisht jepet për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare. Në rast se fëmijët vazhdojnë të jenë ende në shkollë ajo jepet deri në moshën 25 –vjeçare, për fëmijët “e papunë” deri në moshën 21 vjeçare. Mbështetja financiare për prindërit është sa 67% e një page mujore neto, por jo më shumë se 1.800 euro dhe më pak se 300 euro. Prindërit e papunë marrin një shumë minimale shtesë krahas të ardhurës së deritanishme familjare. Mbështetja financiare për fëmijët u paguhet baballarëve dhe nënave për një periudhë maksimale prej 14 muajsh, të dy mund ta ndajnë sipas dëshirës këtë periudhë kohore midis njëri-tjetrit.

familje. Strukturat e kohës nuk kanë ndryshuar dhe sfidat për familjet janë bërë të mëdha dhe të larmishme. “Marrëdhëniet e deritanishme normale të punës” me kohë pune të përcaktuara janë duke e humbur normalitetin dhe janë duke u bërë gjithnjë e më fleksibël. Kësaj i shtohet edhe fakti, që shërbimet mbështetëse për familjen nuk përshtaten me shoqërinë fleksible të shërbimeve dhe shkollat apo kopshtet rrallë marrin në konsideratë oraret në rritje të punës së nënave. Edhe nevoja në rritje për përkujdesje ndaj të moshuarve kërkon kohën e vet, kështu që për një periudhë kohe nuk është e mundur të shkohet në punë, por t’i përkushtohesh kujdesit shtëpiak. Për këtë vlen rregullorja e vitit 2007, sipas së cilës të afërmit për qëllime përkujdesjeje mund të shkëputen gjashtë muaj nga puna pa të drejtë rroge dhe më pas është e mundur, që ata të kthehen përsëri në vendin e tyre të dikurshëm të punës (koha e përkujdesjes).

Dhënia e mbështetjes për planifikimin kohor në favor të familjes është një detyrë komplekse. Ajo prek të gjitha strukturat kohore të ekonomisë, shoqërisë dhe administratës. Krahas punës me kohë të pjesshme, për shkak të familjes, dhënies së mbështetjes për punën shtëpiake dhe për instrumente të tjerë, *periudha prindërore*, si është pjesë përbërëse e ndihmës financiare për prindërit, është një element i rëndësishëm i kësaj politike në mbështetje të kohës së familjes.¹³

Treguesi i tretë për një politikë të qëndrueshme familjare është infrastruktura. Një kontribut i rëndësishëm për ndërthurjen e familjes me profesionin si edhe për përmirësimin e shkollimit fillestar të fëmijëve është *përmirësimi i kujdesit ditor për fëmijët*. Ligji për mbështetjen e fëmijëve, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor 2008, synon që deri në vitin 2013 në të gjithë Gjermaninë një në tre fëmijë në moshën nën tre vjeç të marrë përkujdesje ditore. Rreth një e treta e vendeve të reja do të krijohen në kopshtet ditore. Me këtë Ligj synohet, që në vitin 2013 çdo fëmijë që ka mbushur vitin e parë të jetës të gëzojë të drejtën ligjore për të shkuar në një institucion ditor për fëmijë ose të marrë një përkujdesje ditore. Arsimiti dhe dhënia e mbështetjes për fëmijët në moshën të vogla krijojnë shanse të barabarta dhe forcojnë aftësitë sociale. Prandaj institucionet për përkujdesjen ndaj fëmijëve kuptohen me të drejtë edhe si institucione arsimore.

Brenda pikës së tretë “infrastruktura” politika familjare kristian-demokrate ka aplikuar së fundmi edhe *shtëpitë me disa breza*. Deri tani në të gjithë Gjermaninë janë krijuar 500 shtëpi me disa breza, në të cilat përjetohet në mënyrë aktive bashkëjetesa midis brezave. Programi “shtëpitë me disa breza” është një program me përmbajtje dhe metodikë të re. Ai krijon një rrjet fqinjësie duke ofruar shërbime për familjen dhe brezat e ndryshëm. Programi ndjek rrugë të reja për ndërthurjen me ekonominë lokale dhe nxit kualifikimin e ndërsjellë nëpërmjet një miksimi të personelit të përbërë nga nëpunës me kohë të plotë pune dhe nga aktivistë vullnetarë. Në këtë mënyrë politika kristian-demokrate i përgjigjet ndryshimeve demografike.

¹³ Periudha prindërore zgjat jo më shumë se 14 muaj pas lindjes së fëmijës. Gjatë kësaj periudhe familja merr mbështetjen financiare për prindërit, e cila përforcon pavarësinë ekonomike të tyre. Periudhën prindërore prindërit mund ta ndajnë sipas dëshirës midis tyre. Njëri nga prindërit mund të përfitojë jo më shumë se 12 muaj, mund të ketë edhe dy muaj të tjerë, nëse gjatë kësaj kohe bashkëshortët kujdesen për fëmijën e tyre (e ashtuquajtura muajt e baballarëve). Personat që i rritin vetë fëmijët e tyre për shkak të mungesës së partnerit kanë të drejtë ta marrin mbështetjen financiare për prindërit për të gjithë periudhën prej 14 muajsh.

3.4. POLITIKA MJEDISORE

Modeli i politikës mjedisore kristian-demokrate është **ruajtja e krijesës**. Njeriu është pjesë e kësaj krijese dhe mban përgjegjësi për natyrën dhe mjedisin. Të marrësh përsipër këtë përgjegjësi do të thotë të krijosh politika të tilla, që të ruhen bazat natyrore të jetës. Brezi ynë i sotëm duhet të ruajë dhe të lerë trashëgim një botë, në të cilën do të mund të jetojnë edhe brezat e ardhshëm. Pasardhësit tanë kanë të drejtë që të gëzojnë një mjedis të shëndoshë dhe një vendlindje në të cilën ia vlen të jetosh; ne nuk duhet t'i kufizojmë shanset e jetës së tyre nga mënyra se si jetojmë sot. Ky parim i vazhdimësisë është një kërkesë kristiane dhe konservatore dhe pjesë përbërëse e pandashme e politikës kristian-demokrate. Ruajtja e bazave natyrore të jetës është një pjesë e lirisë për të cilën mbajmë përgjegjësi. Ai që në shkatërron bazat natyrore të jetës sot, dëmton solidaritetin midis brezave.

Vendet industriale e kanë siguruar mirëqenien e tyre për dekada me radhë në kurriz të natyrës. Përballë dëmtimeve të mëdha të natyrës në vitet '70 CDU-ja futi si një qëllim në programin e saj bazë të vitit 1978 ruajtjen e bazave natyrore të jetës. Pas marrjes së Qeverisë nga Helmut Kohl në vitin 1982 mbrojtja e mjedisit u shndërrua në një nga fushat kryesore të veprimit të Qeverisë Gjermane: Nën drejtimin e tij u themelua midis të tjerave Ministria e Mjedisit, u aplikua ekonomia ricikluese dhe u zbatua politika për mbrojtjen e klimës në të gjithë botën.

Mënyra e jetesës në vendet e industrializuara duke shpenzuar shumë resurse nuk mund të jetë njësia matëse për një zhvillim të qëndrueshëm. Vendet industriale duhet të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetës dhe në këtë mënyrë të bëhen shembull për shtetet e tjera, të cilat aktualisht janë duke përjetuar një zhvillim dinamik dhe në të cilat gjithnjë e më shumë njerëz dëshirojnë të jenë pjesë e mirëqenies.

3.4.1 Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet përdorimit të teknologjive

Ndryshimi vullnetar i mënyrës së jetesës do të gjejë pak përkrahje nga shoqëria dhe prandaj mund të jetë pjesërisht i suksesshëm. Mbrojtja e mjedisit me fokus nga e ardhmja ka si qëllim që të shfrytëzojë zhvillimin teknik dhe në këtë mënyrë të reduktojë ndotjen e mjedisit.

Përdorimi dhe zhvillimi i teknologjive që mbrojnë mjedisin dhe resurset janë shtylla të pamohueshme të politikës mjedisore kristian-demokrate. Njeriu ka mundësinë dhe detyrimin që të sillet në mënyrë të përgjegjshme me të dhe për këtë ai i ka mundësitë teknike. Realizimin i kësaj është pjesë e përcaktimit të tij si krijesë e Zotit. Ai ka fuqinë për të bërë përparime teknike dhe në këtë mënyrë të plotësojë kërkesat sociale dhe ekologjike.

Kjo vlen edhe për sektorin e qarkullimit rrugor. Mobiliteti është një nevojë bazë e shoqërive moderne dhe kusht për zhvillimin e ekonomik dhe një mirëqenie të gjerë. Ulja e ndotjes së mjedisit duhet të arrihet nëpërmjet zhvillimit të motorëve që nuk çlirojnë gazra të dëmshëm, masave për reduktimin e qarkullimit me qëllim shmangien e qarkullimit të panevojshëm dhe forcimit të qarkullimit publik. Duhet të garantohet gjithashtu edhe mbrojtja e klimës nëpërmjet përdorimit me efikasitet të energjisë dhe përdorimit më të lartë të energjive të rinovueshme.

3.4.2 Politika mjedisore në Ekonominë Sociale të Tregut

Mbrojtja e krijesës është një sfidë e veçantë për politikën e Ekonomisë Sociale të Tregut. Dy parimet themelore të Ekonomisë Sociale të Tregut – liria dhe përgjegjësia – vlejnjë edhe për mbrojtjen e mjedisit. Një politikë mjedisore e mbështetur tek koncepti kristian për njeriun e bashkon vullnetin për punë dhe performancën e gjithsecilit me mbrojtjen e vazhdueshme të mjedisit.

Shteti ka për detyrë që nëpërmjet krijimit të te dhënave bazë, ofertave dhe kufizimeve ta administrojë në mënyrë të tillë mbrojtjen e mjedisit që të mbeten të paprekura bazat natyrore të jetës. Për këtë elementët e ekonomisë së tregut si programet mbështetëse, stimulimi nëpërmjet taksave, tatimet, licencat, rregullat për mbajtjen e përgjegjësive apo detyrimet individuale mund të jenë instrumente të pranueshëm dhe të përshtatshëm të politikës mjedisore.

Zbatimi konsekuent i parimit të përkujdesjes dhe i parimit të shkaktarit janë bazat e politikës mjedisore kristian-demokrate. Mundësisht nuk duhet të shkaktohen aspak dëmtime të mjedisit, por të pengohen apo mundësisht të minimizohen. Në rast se janë shkaktuar të tillë, atëherë shkaktari i dëmit duhet të angazhohet për mënjanimin e dëmit dhe balancimin e kufizimeve mjedisore.

Zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja mjedisit nuk janë në kontradiktë me njëra-tjetrën. Lufta kundër varfërisë mundësohet nga rritja ekonomike. Prandaj rritja ekonomike është e mirëpritur duke mbajtur parasysh qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e mjedisit.

3.4.3 Dimensioni social dhe shoqëror i politikës mjedisore

Është detyrë e politikës që nëpërmjet arsimimit të zgjojë ndërgjegjen e gjithsecilit për të mbajtur përgjegjësi individuale ndaj mjedisit. Nisur nga parimi i subsidiaritetit arrihet në përfundimin, se politika mjedisore kristian-demokrate parashikon përfshirjen aktive të shoqërisë civile në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Përdorimi i iniciativave qytetare, shoqatave mjedisore dhe forumeve përbën një pasurim për formulimin dhe zbatimin e politikës mjedisore.

Njëkohësisht politika mjedisore mund të japë mbështetje edhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset politike dhe në këtë mënyrë për demokratizimin. Lëvizjet qytetare në Evropën Qendrore dhe Lindore, të cilat çuan në ndryshimet demokratike në vitet 1989/90, e kishin origjinën e tyre tek iniciativat për mbrojtjen e mjedisit dhe i bashkuan kërkesat e tyre me thirrjen gjithnjë e më të fuqishme për reforma politike.

3.4.4 Dimensioni i politikës mjedisore në politikën e jashtme dhe në politikën për zhvillim

Ndotja dhe dëmtimi i mjedisit i kalojnë kufijtë e një shteti dhe marrin karakter rajonal. Të bie gjithnjë e më shumë në sy, se të gjithë njerëzit duke ruajtur bazat natyrore të jetës, jetojnë në

një shoqëri risqesh mbarëbotërore. Kjo kërkon një bashkëpunim të ngushtë në rrafsh global. Politika ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e klimës është një shembull për këtë.

Vendet e varfra dhe të pasuara duhet të marrin së bashku masa për mbrojtjen globale të mjedisit. Kujdesi global për mjedisin dhe tejkalimi i problemeve gjatë zhvillimit janë të pandashme nga njëri-tjetri. Politika për mbrojtjen e mjedisit është një kontribut për drejtësinë globale dhe një pjesë përbërëse e rëndësishme e politikës së jashtme dhe e politikës për zhvillim. Një zhvillim ekonomik ekologjik mund të realizohet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.

INFORMACIONE SHITESË:

QËNDRIMET AKTUALE TË CDU-së NDAJ POLITIKËS MJEDISORE

Në verën e vitit 2008 kryesia e CDU-së miratoi një dokument parimor për politikën e mbrojtjes së klimës, mjedisit dhe të konsumatorëve. Dokumenti përmban kërkesat në vijim:

- Deri në vitin 2050 Gjermania duhet të mbulojë më shumë se gjysmën e nevojave të saj për energji nëpërmjet energjive të rinovueshme.
- Ulje e emisioneve të CO₂ në Gjermani me 40% në raport me vitin 1990.
- Përfshirja e rrjetit evropian të fluturimeve në tregtinë e emisioneve.
- Zëvendësimi i të gjithë centraleve me qymyr me pajisje më moderne.
- Vazhdimi i shfrytëzimit të fuqisë bërthamore për prodhimin e energjisë.
- Ulja e ndotjeve të mjedisit që shkaktohen nga qarkullimi nëpërmjet një takse për automjetet në varësi të emisioneve të CO₂ që çlirojnë, nëpërmjet sistemeve inteligjente të semaforëve për shmangien e bllokimeve të qarkullimit dhe mbështetjes për një teknikë më të mirë të motorëve.
- Rritje e efikasitetit energjetik nëpërmjet restaurimit të shtëpive, modernizimit të pajisjeve ngrohëse dhe ndërtimeve ekologjike.
- Intensifikimi i ekonomisë ricikluese për evitimin e mbeturinave.

3.5 POLITIKA E JASHTME DHE POLITIKA E SIGURISË

Sipas konceptimit kristian-demokrat garantimi i paqes dhe i lirisë në botë janë qëllimi kryesor i politikës së jashtme. Pikat kryesore të politikës së jashtme kristian-demokrate janë zhvillimi i mëtejshëm dhe thellimi i integritit evropian, zgjerimi i marrëdhënieve transatlantike dhe zgjidhja e çështjeve të ndryshme globale. Për këtë vlerat e përbashkëta si liria, demokracia dhe shteti i së drejtës përbëjnë bazat esenciale të politikës së jashtme.

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore Kristian-Demokratët luajtën një rol vendimtar dhe formues në procesin e bashkimit të Evropës. Kancelari gjerman Konrad Adenauer dhe Qeveria gjermane u bënë fuqia shtytëse për formimin e një njësie supranacionale dhe evropiane. Politika konsekuente e integritit perëndimor të Republikës Federale dhe përpyekjet e Adenauerit për vazhdimin e negociatave integruese nëpërmjet Unionit Evropian për Qymyr dhe Çelik (EGKS) u finalizuan me themelimin e Unionit

Ekonomik Evropian (EWG) dhe të Unionit Evropian për Energjinë Atomike (EURATOM), të cilët hynë në fuqi nëpërmjet Traktateve të Romës më 1 janar 1958 (shiko edhe 4.1).

Në vitet '70 dhe pas marrjes së drejtimit të Qeverisë në fillim të viteve '80 kancelari gjerman Helmut Kohl së bashku me Presidentin francez François Mitterand i dhanë impulse të rëndësishme Integritit Evropian. Kështu, Kohl u angazhua midis të tjerave për miratimin e një Kushtetute Evropiane. Për të ishte shumë e rëndësishme që procesi i ribashkimit të Gjermanisë të shihej në kontekstin e integritit evropian. Për meritat e tij ai u nderua me çmimin “Qytetar Nderi i Evropës!” (shiko 4.5).

Në kohën e rritjes së sfidave globale Bashkimi Evropian është pjesë përbërëse fundamentale e politikës së jashtme kristian-demokrate. Me BE-në nuk asociohen vetëm paqja, mirëqenia dhe zhvillimi, por ai u garanton qytetarëve të tij edhe më shumë liri si edhe garanci të brendshme dhe të jashtme. Përveç kësaj, vlerat e përbashkëta janë në përputhje me konceptin kristian-demokrat për politikën e jashtme. Për këtë është mjaft e rëndësishme që të respektohen si parimi i subsidiaritetit ashtu edhe një ndarje e qartë e kompetencave midis Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare, rajoneve dhe komunave.

Politika e jashtme kristian-demokrate shprehet gjithashtu për një politikë mbrojtëse evropiane, e cila i mundëson BE-së që të ketë një potencial ushtarak të vetin. Ashtu siç është përcaktuar në Traktatet e Romës integrimi evropian është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik thellimi dhe zgjerimi. Megjithatë vendimi për zgjerimin duhet të shoqërohet vazhdimisht me një vlerësim të saktë dhe kritik. Kështu është pranuar një “një partneritet i privilegjuar” me Turqinë në vend të një anëtarësimi në BE, sepse momentalisht ai është instrumenti më efikas për të garantuar zhvillimin demokratik, ekonomik dhe të shtetit të së drejtës në Turqi.

SHBA-ja është një partner i rëndësishëm dhe strategjik i Gjermanisë. Bazuar në vlerat e përbashkëta të lirisë dhe demokracisë marrëdhëniet transatlantike janë shumë të rëndësishme. Një aspekt tjetër esencial i partneritetit transatlantik është interesi kolektiv për mbrojtjen e sigurisë globale. Thellimi i integritit evropian nuk qëndron aspak në kontradiktë me partneritetin atlantik; të dy këto aspekte përbëjnë treguesit më të rëndësishëm të politikës së jashtme kristian-demokrate. Identiteti evropian nuk ka nevojë për kufij me SHBA-në, por për një partneritet të besueshëm. Për pasojë, NATO-ja është një instrument thelbësor për përmbushjen e interesave së përbashkëta në politikën e sigurisë. Ai është elementi kryesor lidhës i partneritetit transatlantik.

Krahas “lidhjes së dyfishtë” të integritit evropian dhe partneritetit transatlantik koncepti kristian për njeriun është një tregues tjetër i politikës së jashtme kristian-demokrate. Prej tij burojnë një sërë qëndrimesh në politikën e jashtme, për shembull për të drejtat e njeriut, politikën mjedisore dhe politikën për zhvillim. (shiko edhe 3.4 dhe 3.6). Nisur nga këndvështrimi kristian-demokrat realizimi global i të drejtave të njeriut është një kërkesë themelore për garantimin e lirisë, drejtësisë, dhe paqes në botë dhe në këtë mënyrë përbën një bazë elementare etike në politikën e jashtme. Prandaj është e rëndësishme, për përmirësimin global të të drejtave të njeriut të krijohen kushtet bazë shtetërore, politike dhe shoqërore – p.sh. nëpërmjet dialogëve bilaterale të shteteve të së drejtës, masave për përforcimin e shoqërisë civile dhe mbështetjes për demokracinë.

Edhe mbrojtja e mjedisit – në kuptimin e mbrojtjes së krijesës – është një kërkesë themelore e politikës kristian-demokrate, e cila gjatë demokratizimit ka zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në politikën e jashtme. Ndryshimi i klimës dhe ndotja e ajrit nuk ndalojnë përpara kufijve shtetërorë; ato madje as nuk mund të luftohen nga një shtet i vetëm, por nevojiten përpjekje të përbashkëta ndërkombëtare. Kjo nuk vlen vetëm për kërcënimin ndaj sigurisë në Gjermani, i cili mund të shkaktohet nga shkatërrimi i mjedisit në rajone të largëta.

Për të njëjtat arsye, nisur nga përgjegjësia për njerëzit, bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim është duke u bërë gjithnjë e më i rëndësishëm në tregtinë e jashtme kristian-demokrate. Komuniteti ndërkombëtar duhet ta bëjë detyrë të vetën forcimin e dinamikës ekonomike të vendeve në zhvillim, krijimin e shanseve tregtare të barabarta dhe mbështetjen për sigurinë sociale dhe shtetin e së drejtës. Ndhma ndërkombëtare për zhvillim u shërben edhe interesave gjermane. Në ditët e sotme ajo është pjesë e strategjive kryesore për stabilizimin e rajoneve në krizë dhe është pjesë përbërëse e pandashme e konceptit të gjerë për sigurinë – fjala kyç “rrjeti i sigurisë”. Rreziqet globale dhe në rrjet mund të luftohen me efikasitet vetëm nëpërmjet procedurave të integruara. Për këtë nevojiten partneritete strategjike, politike dhe ekonomike, të cilët duhet të mbështeten dhe thellohen nëpërmjet ndihmës për zhvillim.

Kjo vlen edhe në drejtim të një prej çështjeve më të ndjeshme në politikën e sigurisë, për luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, kryesisht terrorizmit islamik. Toleranca ndaj kulturave dhe feve të tjera si edhe respekti i ndërsjellë janë të lidhura në mënyrë të pandashme me besimin kristian. Nga synon krijimin e një bashkëjetese miqësore dhe paqësore me botën islamike, e cila kërcënohet masivisht nga terrorizmi dhe fundamentalizmi. Prandaj për këtë nevojitet një luftë e vendosur kundër çdo forme të terrorizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Siç e tregon edhe shembulli i Afganistanit, tejkalimi me sukses i këtyre sfidave kërkon jo vetëm përdorimin e koordinuar të mjeteve ushtarake dhe civile, por edhe shumë durim, fleksibilitet dhe qëndrueshmëri. Politika kristian-demokrate për paqe dhe liri në botë nuk mund të mos trajtojë edhe detyra të tilla komplekse dhe për këtë i nevojitet bashkëpunimi intensiv me aleatët si edhe drejtim i guximshëm politik brenda vendit.

3.6. SOLIDARITETI NDËRKOMBËTAR DHE BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM

Pas vitit 1961 në Gjermani nëpërmjet formimit të një Ministrie të mëvetësishme lindi politika për zhvillim, si një sektor politik më vete. Nga njëra anë politika për zhvillim duhej të shkëputej nga tradita e punës misionare kristiane dhe nga ana tjetër të gjente vendin e saj në politikën e jashtme dhe sektorët e tjerë politikë. Direktivat dhe drejtimi për një koncept të pavarur kristian-demokrat në politikën për zhvillim ishin dhe janë nga njëra anë detyrimi kundrejt konceptit kristian për njeriun dhe nga ana tjetër në jetën politike, krijimi i kushteve bazë në mbarë botën për një jetë me dinjitet, kushte të ndershme tregtare, si edhe për një siguri globale dhe për politikë gjithëpërfshirëse për resurset dhe klimën.

Nga etika sociale kristiane buron një lidhje e fortë midis personalizmit kristian dhe solidaritetit ndërkombëtar. Nga kjo buron ndërthurja konstitutive midis njeriut, subsidiaritetit dhe solidaritetit, e cila përcakton, se

1. Njeriu është gjithmonë përgjegjës për zhvillimin e tij,
2. Aktiviteti njerëzor duhet të jetë gjithnjë subsidiar (përgjegjësi individuale e njësisë më të vogël shoqërore), dhe se
3. Solidariteti si “ndihmë për të ndihmuar vetveten” përbën bazën e politikës për zhvillim.

Respekti për dinjitetin e çdo njeriu formon bazën e politikës kristian-demokrate për zhvillim. Nga këndvështrimi kristian dinjiteti i njeriut është i paprekshëm dhe i patjetërsueshëm. Ajo e ve theksin tek e drejta për të jetuar dhe tek kërkesa për drejtësi, liri dhe paqe në botë. Barazia e të gjithë njerëzve dhe universaliteti i të drejtave njerëzore janë vlerat bazë, prej të cilave burojnë si përgjegjësia morale, ashtu edhe detyrimi politik për të vepruar. Për politikën e zhvillimit kjo do të thotë partneritet me vullnet të lirë.

Solidariteti nuk kërkon vetëm dhënien e ndihmës së menjëhershme në raste emergjente, por edhe angazhim për një zhvillim ekonomik, social dhe ekologjik të të gjithë njerëzve. Kjo kërkon më shumë sesa luftimin e simptomave. Kjo kërkon luftimin e shkaqeve të varfërisë, urisë, sëmundjeve dhe mungesës së shkollimit. Një zhvillim i qëndrueshëm politik i të gjithë njerëzve është i mundur vetëm në kushtet e shtetit të së drejtës, të demokracisë dhe të ekonomisë së tregut. Në këtë kuadër Kristian-Demokratët theksojnë veçanërisht, se një qeverisje e mirë kërkon marrjen përsipër të përgjegjësive individuale. Ata duan të mbështetin shpirtin sipërmarrës dhe të mundësojnë edhe krijimin e pronave për personat pa prona. Kjo kërkon vetëvendosje politike në kushtet e një qeverisjeje të mirë. Vetëm kështu mundësohet një jetë në liri, mirëqenie dhe paqe.

Nga këndvështrimi kristian-demokrat politika për zhvillim në fakt ka qenë gjithmonë e motivuar në mënyrë altruiste, por asnjëherë përjashtuese. Krahas konsolidimit normativ politika për zhvillim merr në konsideratë edhe interesat kombëtare. Në dekadat e konfliktit Lindje-Perëndim kontradikta ideologjike dhe politike midis sistemeve ka luajtur një rol të rëndësishëm. Sfida e ditëve të sotme është që pasojat e globalizimit të kenë një formë sa më sociale, veçanërisht tek vendet në zhvillim. Zbutja e presionit nga migracioni, përmirësimi i sigurisë në botë, mbrojtja e klimës dhe e mjedisit, tregtia e dyanshme dhe mundësitë për eksport si edhe format e përcaktuara të bashkëpunimit ndërkombëtar nuk janë vetëm në interesin kombëtar të të ashtuquajturës palë donatore. Paqja, një rend i drejtë ekonomik dhe social, mbrojtja e krijesës dhe aftësia e të gjitha shteteve në tokë për të ndërtuar të ardhmen janë edhe në interes të vendeve përfituese.

Si ndërthurja e vlerave ashtu edhe ndërthurja e interesave të politikës për zhvillim shihen si legjitime nga këndvështrimi i Demokracisë Kristiane dhe janë të lidhura fort me njëra-tjetrën. Ato nuk mund të argumentohen të ndara, por vetëm të ndërthurura me njëra-tjetra. Fokusimi i politikës për zhvillim tek vlerat kontribuon herë pas here që të mos kalohet në egoizëm, joshje për përfitime dhe përfitim avantazhesh si qëllim në vetvete. Në të njëjtën kohë, kundërshtimet nisur nga interesat kombëtare mund të bëjnë që të mos humbet nga sytë ajo çka mund të bëhet realisht dhe kostot e pasojave politike. Është një kërkesë e politikës social-demokrate për zhvillim që të mos bihet në kurthin e vendosjes së “vlerave universale” kundër “interesave kombëtare” apo që këto të dyja të deklarohen si të papajtueshme me njëra-tjetrën. Vlera në politikën e zhvillimit ofrojnë edhe direktivat orientuese, të cilat mund të përcaktojnë logjikën

dhe veprimet jo vetëm të aktorëve individualë, por edhe të qeverive. Kjo nuk vlen vetëm për Gjermaninë, por ajo përcakton njëkohësisht edhe llojin e bashkëpunimit me shtet partnere më shumë apo më pak të zhvilluara.

Zhvillimi është një proces i gjerë, i cili para së gjithash karakterizohet nga një përmirësim i kushteve të përgjithshme të jetës dhe nga forcimi i lirive individuale. Përpjekjet konkrete për zhvillim duhet t'i bëjnë vetë njerëzit, politika e të cilëve ka këtë synim. Të gjitha përpjekjet, për të dhënë mbështetje nga jashtë për këto procese nuk duhet të pasqyrojnë vetëm qëllimet e atyre që japin mbështetjen, por ato duhet të mbajnë parasysh traditat, lidhjet dhe identitetet sociale dhe ekonomike, kulturore dhe fetare si edhe ekologjike dhe politike të atyre që e marrin mbështetjen. Për ta ndërmjetësuar këtë nevojitet patjetër dialog. Sa kohë që ky dialog do të kontribuojë, që të përmirësohet jo vetëm mirëkuptimi i ndërsjellë, por në rast se ka dallime të theksuara të jepet edhe ndihmë për vendimmarrje, ai duhet të marrë në konsideratë edhe njësitë e matjes së vlerave, të cilat nuk përfaqësohen vetëm nga njëra palë e përfshirë.

Politika për zhvillim nuk mund të realizohet vetëm me kritere teknike, monetare apo sasiore. Sipas opinionit të Partive të Unionit në Gjermani argumentimi i përmbajtjes dhe i politikës kërkon orientimin drejt vlerave të sipërpërmendura. Në kuptimin e ngushtë të fjalës detyra e tyre pa dyshim është mundësimi i një jete të denjë dhe në liri dhe vetëvendosje për njerëzit në vendet më të varfra të botës si edhe për njerëzit në shtetet në prag-tranzicioni apo në tranzicion. Nga këndvështrimi kristian-demokrat kjo detyrë mund të përmbushet vetëm, në rast se këmbëngulet në përmbushjen e saj. Prandaj politika e zhvillimit duhet të jetë pjesë e një politike globale, e cila i integron edhe vendet më të varfra në përcaktimin e kushteve globale.

4. KRISTIANDEMOKRATË TË NJOHUR NË EVROPË

4.1. KONRAD ADENAUER (1876-1967)

Konrad Adenauer ishte Kancelari i parë i Republikës Federale Gjermane dhe në vitet 1950 deri 1966 ai ishte kryetari i CDU-së gjermane.

Konrad Adenauer ka lindur më 5 janar 1876 në Këln. Ai vinte nga një familje nëpunësish katolike. Karriera politike e juristit të diplomuar filloi në vitin 1906, kur ai mori detyrën e një të zgjedhuri lokal në qytetin e tij të Lindjes. Në vitin 1917 u zgjodh Kryetar i Bashkisë së Këlnit. Këtë detyrë Adenaueri, i cili ishte anëtar i Partisë Katolike të Qendrës, e ushtroi deri në vitin 1933, vit në të cilin atë e larguan nga detyra nacional-socialistët. Vitet e diktaturës nacional-socialiste i kaloi duke qëndruar përkohësisht në manastirin Maria Laach dhe në Potsdam në Rëndorf/Bon, deri sa në vitin 1944 atë e arrestoi Gestapo-ja dhe e burgosi për muaj të tërë. Pasi trupat amerikane e çliruan dhe e pushtuan Këlnin, Qeveria Ushtarake në fillim të majit 1945 e emëroi Konrad Adenauerin përsëri si Kryetar Bashkie. Në qershor 1945 kontrollin në hapësirën e Renit e mori administrata ushtarake britanike. Ajo e liroi nga detyra Adenauerin në tetor 1945 dhe e ndaloi atë përkohësisht që të aktivizohej në politikë.

Pas rilargimit nga posti i Kryetarit të Bashkisë Adenaueri u angazhua intensivisht për krijimin e Unionit të ri Kristian-Demokrat. Qysh në fillim ai u ngarkua me një sërë funksionesh kyçe brenda partisë dhe në këtë mënyrë kontribuoi ndjeshëm në ndërtimin organizativ dhe në hartimin e programit të partisë së tij. Që në momentet e para ai shprehu mendimin që të formohej një CDU si një parti popullore që qëndronte mbi fenë, e cila të ishte e hapur njësoj si për katolikët edhe për protestantët. Qysh prej vitit 1946 Adenaueri ishte kryetar i CDU-së në rajonin e Renit dhe i zonës së pushtuar nga britanikët si edhe kryetar i grupit parlamentar në Parlamentin e Landit Nordren-Vestfalen. Më 1 shtator 1948 ai u zgjodh kryetar i Këshillit Parlamentar. Në këtë funksion ai u angazhua fuqimisht për hartimin e Kushtetutës së Republikës Federale Gjermane, e cila hyri në fuqi më 23 maj 1949.

Pas zgjedhjeve të para të Bundestag-ut në datën 14 gusht 1949 Adenaueri krijoi një koalicion qeverisës, i cili përbëhej nga CDU-ja, nga Partia simotër e Bavarisë CSU, nga Partia Demokratike Liberale e Lirë (FDP) dhe nga Partia Konservatore Gjermane (DP). Në datën 15 shtator 1949 ai u zgjodh Kancelari i parë i Republikës Federale Gjermane. Këtë detyrë Konrad Adenaueri e ushtroi për më shumë se 14 vite. Deri ditën e dorëheqjes së tij më 15 tetor 1963 ai drejtoi gjithsej 5 kabinete. Nga marsi 1951, data e themelimit të Ministrisë së Jashtme Federale Gjermane, dhe deri në qershor 1955 Konrad Adenaueri nuk ishte vetëm Kancelari i Gjermanisë, por ushtronte edhe funksionin e Ministrit të Jashtëm.

Në vitin 1957 CDU/CSU-ja nën drejtimin e tij fitoi me 50,2% të votave shumicën absolute në zgjedhjet për Bundestag-un gjerman. Nga data 22 tetor 1950 deri në 22 mars 1966 Adenaueri ishte Kryetari i CDU-së gjermane dhe më pas Kryetar Nderi i saj. Deri ditën e vdekjes së tij më 19 prill 1967 ai ishte anëtar i Bundestag-ut gjerman.

Gjatë të ashtuquajturës “Era e Adenauerit” në periudhën 1949 deri 1963 u morën shumë vendime të rëndësishme në politikën e brendshme dhe të jashtme, të cilat e karakterizojnë imazhin e Republikës Federale Gjermane dhe orientimin e saj politik deri në ditët e sotme. Në politikën e brendshme theksohet veçanërisht themelimi i Unionit Kristian-Demokrat si një parti popullore demokratike ndërfetare, zbatimi i Ekonomisë Sociale të Tregut si një koncept ekonomik dhe social-politik i Republikës Federale Gjermane dhe i ashtuquajturi “kompensimi financiar” për dëmshpërblimin financiar të shtetasve gjermanë të prekur nga shkatërrimet e luftës dhe nga dëbimet. Edhe pensioni dinamik që u aplikua nën drejtimin e Adenauerit në vitin 1957 me qëllim garantimin e standardit të jetesës në pleqëri vazhdon të jetë ende në fuqi. Në fushën e politikës së jashtme Adenaueri synoi rifitimin e sovranitetit të Republikës Federale Gjermane dhe integrimin e saj në komunitetin e Demokracive perëndimore si edhe bashkimin ekonomik dhe politik të Evropës.

Motivet kryesore për politikën e integritit perëndimor ishin shqetësimi i Adenauerit për një ekspansion sovjetik dhe antikomunizimi që e karakterizonte atë, por edhe bindja, “se origjina jonë dhe botëkuptimi ynë është pjesë e Evropës Perëndimore”, ashtu siç u shpreh ai në deklaratën e tij të parë në Qeveri. Me pozicionimin e tij të vendosur drejt Perëndimit Adenaueri fitoi besimin e Fuqive pushtuese perëndimore. Me hyrjen në fuqi të Traktateve të Parisit në datën 5 maj 1955 Republika Federale Gjermane fitoi pothuajse sovranitetin e plotë dhe u pranua në NATO. Një shprehje e rifitimit të sovranitetit ishte krijimi i ushtrisë

gjermane, e cila ishte e lidhur me NATO-n dhe mbante (dhe mban) përgjegjësi para Parlamentit, si edhe aplikimi i detyrimit të përgjithshëm për shërbimin ushtarak në vitin 1956.

Ashtu si edhe Ministri i Jashtëm francez Robert Schuman edhe Konrad Adenaueri ishte një mbrojtës i angazhuar i procesit të bashkimit të Evropës. Krijimi i Unionit Evropian për Qymyr dhe Çelik (EGKS) nën vitin 1952, të Unionit Ekonomik Evropian (EWG) dhe Unioni Evropian për Energjinë Bërthamore (EURATOM) në 1958 u realizuan të gjitha gjatë periudhës së qeverisjes së tij. Kusht dhe njëkohësisht pjesë e pandashme përbërëse e politikës pro-perëndimore të Adenauerit ishte pajtimi me Francën. Kjo politikë kulmoi në fillim të vitit 1963 me Traktatin e Miqësisë franko-gjermane të nënshkruar nga Konrad Adenaueri dhe Charle de Gaulle.

Krahas pajtimit me Francën një çështje tjetër që Adenaueri e kishte për zemër ishte pajtimi me popullin çifut. Madje qysh pas disa javësh pas ardhjes së tij në Qeveri ai u përpoq të vendoste kontakte me përfaqësues çifutë, sepse ai riparimin moral dhe financiar, e cila në fund të fundit mund të kishte vetëm karakter simbolik, e shikonte si një pjesë morale dhe pjesë e rindërtimit të shtetit të së drejtës në Gjermani. Një intervistë me botuesin e “Gazetës javore të çifutëve në Gjermani” në nëntor 1949 ishte fillimi i marrëdhënieje të vendosur me vështirësi midis Qeverisë Federale dhe përfaqësuesve të shtetit të Izraelit. Në shtator 1952 Adenaueri dhe Ministri i jashtëm Izraelit Moshe Sharett nënshkruan në Luksemburg marrëveshjen e parë midis Republikës Federale Gjermane dhe shtetit të Izraelit për kontribute riparimi. Pas realizimit të marrëveshjes së riparimit midis Gjermanisë dhe Izraelit më 29 mars 1966 Adenaueri pak muaj pasi kishte mbushur 90 vjeç udhëtoi në maj 1966 për në Izrael dhe vizitoi në shtëpinë e tij private themeluesin e shtetit David Ben Gurion. Me angazhimin e tij Adenaueri forcoi ndërgjegjen e përgjegjësisë gjermane ndaj Izraelit, e cila edhe në ditët e sotme është një pjesë përbërëse e panegociueshme e politikës së jashtme gjermane.

Përballë përshkallëzimit të konfliktit Lindje-Perëndim, garantimi i demokracisë dhe i lirisë në Republikën Federale Gjermane si edhe Integrimi Perëndimor kishin për Adenauerin një prioritet të lartë politik. M.q.se sipas mendimit të tij në rrethanat ekzistuese nuk kishte asnjë alternativë të përgjegjshme për politikën e bashkimit me Perëndimin, ai ishte i detyruar të pranonte thellimin e përkohshëm të ndarjes së Gjermanisë. Adenaueri theksonte vazhdimisht, se një ribashkim në paqe dhe liri mund të arrihej vetëm nëpërmjet rrugës së integritit evropian dhe qetësimit të konfliktit Lindje-Perëndim. Por për këtë nevojitej një qëndrim i njësuar dhe i fortë i Perëndimit. Me rënien e murit në 1989 dhe ribashkimit të Gjermanisë në vitin 1990 politika gjermane përjetoi justifikimin e saj historik.

Si Kancelari i parë gjerman Konrad Adenauer vendosi piketat jo vetëm për zhvillimin demokratik në paqe dhe mirëqenie të Republikës së re Federale Gjermane; vendosmëria e tij për t’ia bashkëngjitur Republikën Federale Gjermane Aleancës së vlerave perëndimore dhe përpjekjet e tij për pajtimin me shtetet fqinje si edhe për bashkimin e Evropës janë gjithashtu kontribute historike shumë të rëndësishme.

4.2 LUDWIG ERHARD (1897-1977)

Ludwig Erhard në periudhën nga 1949 deri 1963 ishte Ministër Federal për Ekonominë, në periudhën 1963-1966 Kancelar i Republikë Federale Gjermane dhe nga 1966/77 Kryetar i CDU-së.

Ludwig Erhard ka lindur më 4 shkurt 1897 në Fyrth. Pas mbarimit të shkollës dhe të një praktike tregtare ai punoi fillimisht si një tregtar pakice në biznesin e tekstit të babait të tij. Për shkak të një plagosjeje të rëndë, të cilën ai e kishte marrë në Luftën e Parë Botërore si ushtar artilerie, ai nuk ishte në gjendje të vazhdonte ushtrimin e profesionit të tij. Në vitin 1919 ai filloi studimet për Shkenca Ekonomike dhe Sociologji në Shkollën e Lartë Tregtare në Nyrenberg. Më vonë ai u transferua në Universitetin e Frankfurt mbi Main, ku në vitin 1929 u promovua si Dr.rer.pol.tek Franz Oppenheimer.

Pas promovimit të tij Erhardi punoi fillimisht si bashkëpunëtor shkencor dhe më vonë si zëvendës drejtor i Institutit për Vëzhgime Shkencore në fushën e prodhimeve të gatshme gjermane në Nyrenberg. Në këtë funksion ai midis të tjerave ishte përgjegjës për botimin e gazetës mujore të Shoqatës, e cila trajtonte edhe çështje aktuale të politikës ekonomike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai i përqendroi kërkimet e tij tek hartimi i një rendi ekonomik pas luftës, çka i krijoi atij probleme me regjimin nacional-socialist: në vitin 1942 atë e larguan nga posti i zëvendës drejtorit të Institutit. Erhardi e vazhdoi privatisht punën e tij dhe në vitin 1944 ai përfundoi shkrimin e tij *Financimi i Luftës dhe konsolidimi i borxheve*, i cili në Qarqet e Rezistencës u konsiderua si baza për rindërtim.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore Erhardi, si një person i pastër politikisht, u emërua nga autoritetet pushtuese amerikane si Ministër Shteti për Ekonominë në Bavari. Dy vite më vonë, nga 1947 deri 1948, ai drejtoi “Zyrën e posaçme Para dhe Kredi”, e cila u përpoq seriozisht për përgatitjen e një reforme monetare. Në mars 1948 Këshilli Ekonomik e zgjodhi Erhardin Drejtor të Administratës për Ekonominë në Rajonin e Bashkuar Ekonomik të zonës së pushtuar nga amerikanët dhe britanikët. Në këtë funksion ai drejtoi përgatitjet legislative për një liberalizim të ekonomisë së planifikuar dhe për liberalizimin e çmimeve. Kur më 20 qershor 1948 në të tre zonat perëndimore të pushtuara në Gjermani u realizua reforma monetare, Erhardi e shfrytëzoi këtë rast – pa marrë miratimin e Këshillit të Landeve dhe të Qeverisë Ushtarake – për ta gërshtuar reformën monetare me një reformë të thellë ekonomike: ai deklaroi publikisht hyrjen në një rend ekonomik të çliruar nga një ekonomi e planifikuar dhe nga kontrolli i çmimeve. Faktin që ky akt, sipas mendimit të Erhardit i nevojshëm, por që për të cilin nuk ishte siguruar mbështetja politike, nuk solli pasoja personale për të, ai ia di për nder miratimit të mëvonshëm nga ana e Guvernatorit Ushtarak amerikan Lucius D. Clay si edhe legjitimitet nga ana e Këshillit të Landeve që u realizua në mbrëmjen e datës 21 qershor.

Sukseset e para të arritura me përpjekje luftarake i dhanë Erhardit mbështetjen më të madhe politike midis politikanëve gjermanë në zgjedhjet e para të Bundestag-ut në vitin 1949. Kancelari gjerman Konrad Adenauer ia doli mbanë që ta bënte Erhardin pjesë të CDU-së. Fushata zgjedhore u karakterizua nga politika ekonomike e Erhardit, e cila në direktivat e Dyseldorfit ishte bërë pjesë e programit të CDU-së si koncepti i Ekonomisë Sociale të Tregut. Si kandidati kryesor i CDU-së në Vyrtemberg-Baden Erhardi fitoi një mandat të drejtpërdrejtë

në Qarkun Ulm/Haidenhaim dhe në datën 20 shtator 1949 u emërua Ministër Federal i Ekonomisë në kabinetin e parë qeveritar të Kancelarit Konrad Adenauer.

Që në fillim të periudhës së mandatit të tij si Ministër Ekonomie që zgjati deri në vitin 1963 Erhardi u angazhua për një ekonomi tregu në përputhje me rrethanat shoqërore, e cila i garantonte mjaftueshëm hapësira të lira veçanërisht ndikimit në rritje të tregjeve të lira. Për këtë ai e përqendroi politikën e tij tek parimet e ekonomisë së tregut dhe tek perfeksionimi i ekonomisë së tregut. Krahas angazhimit të tij për liberalizimin e tregtisë së jashtme ai vendosi në fokus të politikës së tij veçanërisht parimin e konkurrencës së arritjeve. Si “parim bazë” të ekonomisë Erhard konsideroi Ligjin e miratuar në vitin 1957 kundër kufizimeve të konkurrencës (“Ligji kundër karteleve”), i cili nëpërmjet ndalimit të marrëveshjeve në treg që kufizonin konkurrencën mbështeti sovranitetin e konsumatorëve dhe në këtë mënyrë formoi bërthamën e Ekonomisë Sociale të Tregut.

Sukseset e politikës së tij u shfaqën qysh në mes të viteve '50 dhe e bënë të njohur Erhardin si “babai i mrekullisë ekonomike gjermane”: rritja e lartë ekonomike dhe rritja e konsiderueshme e pagave në kushtet e pandryshueshmërisë së çmimeve krijuan vende pune për të gjithë si edhe siguri sociale me buxhete publike të balancuar. Për vetë Erhardin këto suksese ishin më pak një “mrekulli” sesa pasojat e një konceptimi të menduar mirë dhe të një politike konsekuente, siç ishte përpjekur ta paraqiste ai në formë të kuptueshme për të gjithë në librin e tij *Mirëqenie për të gjithë* (1957).

Për Erhardin Ekonomia Sociale e Tregut nuk ishte vetëm teori ekonomike, por një etikë sociale, tek e cila ekzistonte një “lidhje e pandashme” midis politikës ekonomike dhe politikës sociale. Kjo shprehej në faktin, që politika ekonomike mund të jetë shumë me e suksesshme, sa më pak të nevojshme të jenë ndërhyrjet dhe masat ndihmëse (social)politike. Këtu Erhardi paralajmëron në mënyrë të përsëritur për “rrugën e rrezikshme drejt një shteti social”, i cili mund të shmangej vetëm nëpërmjet lirisë dhe përgjegjësisë së gjithsecilit. Në këtë mënyrë politika sociale nuk duhet të synojë që ta mbrojë njeriun nga të gjitha prapësitë e jetës që në momentin e lindjes. Sepse vetëm nëpërmjet garantimit të një shkalle të konsiderueshme të lirisë, iniciativës private dhe të kujdesit për vetveten mund të shpaloset fuqia, arrijtet si edhe “vlerat më të mira njerëzore” të një Ekonomie Sociale Tregu që bazohet tek iniciativa personale.

Megjithatë politika e Erhardit mund të ishte çdo gjë, vetëm jo dogmatike. Ai theksonte, se edhe një politikë ekonomike shumë e mirë në shtetet industriale moderne kishte nevojë për plotësime me masa social-politike. Ndër masat e tij më të rëndësishme social-politike përmendim p.sh. aplikimin e një pensioni të bazuar në shpërndarje (1957) dhe rritja e ndjeshme e pensioneve që lidhte me këtë si edhe aplikimi i një takse progresive mbi të ardhurat (1958). Në çështjet e banimit Erhardi pranoi ndërhyrjet masive të shtetit, sepse përballë dëmeve të shkaktuara nga lufta kushtet për funksionimin e tregut duhet të krijoheshin në mënyrë graduale.

Që Erhardi hasi në kundërshtime për zbatimin e koncepteve të tij, këtë e qartësojnë para së gjithash greva e përgjithshme e 1948, e cila në kushtet e një papunësie të rritur ndjeshëm për një periudhë të përkohshme kohe drejtohej kundër masave të Erhardit të iniciuara me

reformën monetare për eliminimin e rregullave të ekonomisë së planifikuar dhe kontrollit të çmimeve, si edhe rezistenca masive nga ana e industrisë kundër Ligjit të Karteleve të vitit 1957. Por edhe marrëdhënia e tij me Adenauerin karakterizohej nga mosmarrëveshje. Një pikë konfliktuale ishte politika evropiane. Kështu për shembull gjatë hartimit të Unionit Montan (1951) dhe të Traktateve të Romës (1957) lindën diskutime midis dy protagonistëve më të rëndësishëm të politikës së pasluftës në Gjermaninë Perëndimore. Për Erhardin garantimi i një ekonomie tregu funksionale dhe i besimit tek fuqia produktive e lirisë ekonomike ishin shumë të rëndësishme. Këto të dyja sipas tij rrezikoheshin nga institucionalizimi në rritje i Evropës.

Gjatë gjithë periudhës së mandatit të tij si Ministër i Ekonomisë Erhardi ishte një garant për popullaritetin e Qeverisë Federale si edhe për sukseset në zgjedhje të CDU-së. Kur pas zgjedhjeve për Bundestag-un në vitin 1961 Adenaueri u detyrua të japë dorëheqjen në mes të periudhës së legjislaturës nga presioni i partisë së koalicionit FDP, Erhard u përcaktua nga partia e tij si pasuesi i Adenauerit dhe në datën 16 tetor 1963 u zgjodh nga Bundestag-u si Kancelari i dytë i Republikës Federale Gjermane.

Periudha qeverisëse e Erhardit si Kancelar nuk ishte shumë e suksesshme. Nga radhët e CDU-së ai u akuzua, se nëpërmjet përparësisë që i kishte dhënë politikës transatlantike ai ishte përgjegjës për ftohjen e marrëdhënieve gjermano-franceze. Në politikën e brendshme ai dëshironte të çonte përpara reformat dhe t'i ndërmyetësonte komunitetit një klimë të hapur shpirtërore dhe një stil të ri politik. Megjithatë modeli i paraqitur prej tij për një “shoqëri të formuar”, i cili duhej të mobilizonte fuqitë integruese të Ekonomisë Sociale të Tregut për një qëndrim themelor të orientuar drejt mirëqenies komunitare të interesave të organizuara, nuk u përkrah aspak.

Megjithëse Erhardi në vitin 1965 u konfirmua në detyrë në një mënyrë triumfuese (CDU/CSU fituan 47,6% të votave), ai nuk ia doli mbanë që nga zgjedhjet e Bundestag-ut të ecte më fuqimisht përpara. Aftësia e tij drejtuese u lëkund ndjeshëm. Edhe prestigji i tij si specialist për ekonominë pësoi të çara, kur në vitin 1966 u shfaqën probleme në ekonomi dhe në buxhet, si edhe me shfaqjen e recensionit të dytë pas periudhës së luftës, i cili u shoqërua me rritje të numrit të papunësisë. Pas disfatave të rënda për CDU-në në disa zgjedhje për Parlamentet e Landeve, veçanërisht më 10 korrik 1966 në Nordren-Vestfalen, dhe dorëheqjes së partnerit të koalicionit FDP nga Qeveria, Erhardi në datën 1 dhjetor 1966 dha dorëheqjen nga detyra e Kancelarit.

Me emrin Ludwig Erhard lidhet veçanërisht zbatimi i Ekonomisë Sociale të Tregut në Republikën Federale Gjermane. Nëpërmjet vendosjes së piketave nga ana e tij u hodhën themelet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës Federale Gjermane të admiruar në mbarë botën, i cili ka hyrë në histori edhe me emrin “mrekullia ekonomike”.

Ludwig Erhard u nda nga jeta në moshën 80 vjeçare në datën 5 maj 1977 në Bon.

4.3 ALCIDE DE GASPERI (1881-1954)

Alcide De Gasperi ka qenë Kryeministër i Italisë në periudhën 1945 deri 1953 dhe në periudhën 1944 deri 1946 si edhe 1953 deri 1954 ishte Sekretar i Përgjithshëm i *Democrazia Cristiana*.

Alcide De Gasperi lindi më 3 prill 1881 në Pieve Tesino, në Tresinon e dikurshme austriake, si djali i një xhandari katolik. Në vitin 1900 ai filloi studimet për Filozofi, Letërsi dhe Histori në Vjenë, të cilat ai e përfundoi në vitin 1905 me mbrojtjen e Doktoraturës. Qysh në periudhën studentore Alcide De Gasperi mori pjesë në jetën e shoqërisë civile të Monarkisë së Habsburgëve. Në moshën 21 vjeçare ai u bë anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Akademikëve Katolikë në Trentin. Pas përfundimit të studimeve ai punoi fillimisht si redaktor, qysh prej vitit 1906 si drejtor i gazetës *Il Trentino*, organ i *Partito Popolare Trentino* (Partia Popullore e Trentinës), e cila angazhohej për më shumë autonomi kulturore dhe politike për provincën italiane.

Karriera e vërtetë politike e Alcide de Gasperit filloi në vitin 1911 me zgjedhjen e tij në Dhomën e Deputetëve të Parlamentit Gjerman. Krahas kësaj në vitin 1914 ai u zgjodh në Parlamentin e Landit të Tirolit. Si përfaqësues i provincës së tij Trentino ai u angazhua atje për më shumë demokraci dhe kundër politikës centraliste të Qeverisë së Vjenës.

Pas disfatës së Austro-Hungarisë në Luftën e Parë Botërore dhe aneksimit të Tirolit Jugor nga Italia nëpërmjet Marrëveshjes së Paqes të shtatorit 1919 në Saint Germain Alcide de Gasperi ishte një nga bashkëthemeluesit e *Partito Popolare Italiana* (Partia Popullore Italiane, PPI), e cila kishte drejtim katolik. Pas zgjedhjeve të vitit 1921 ai hyri si deputet në Parlamentin italian dhe atje iu besua drejtimi i grupit të tij parlamentar.

Pas ardhjes në fuqi të Benito Mussolinit në vitin 1922 filloi edhe lufta politike dhe publicistike e Alcide De Gasperit kundër regjimit fashist. Qysh prej vitit 1923 ai nuk vazhdonte detyrën as si kryetar i grupit të tij parlamentar, dhe as si Sekretar i Përgjithshëm i PPI-së. Me gjithë klimën politike të karakterizuar nga terrori De Gasperi e çoi më tej rezistencën e tij kundër Mussolinit dhe mbeti kritik ndaj fashizmit. Në vitin 1926 u ndalua publikimi i gazetës së tij, e cila pas marrjes së Trentinos nga Italia u quajt *Il Nuovo Italiano*, dhe u ndalua aktiviteti i PPI-së. De Gasperi vetë u arrestua në vitin 1927. Pas 16 muajsh burgim ai u la i lirë pas ndërhyrjes së Kishës Katolike. Qysh prej vitit 1929 ai gjeti mbrojtje dhe punë në bibliotekën e Vatikanit.

Para rrëzimit të Mussolinit në vitin 1943 Alcide De Gasperi e ushtronte në fshehtësi aktivitetin e tij dhe në vitin 1942 kontribuoi aktivisht në themelimin e *Democrazia Cristiana* (Demokracia Kristiane) si organizata pasuese e PPI-së. Pasi forcat aleate e çliruan Romën nga trupat pushtuese gjermane në qershor 1944 ai u angazhua si përfaqësues i *Democrazia Cristiana* (DC) në rolin e Ministrit pa Portofol në Qeverinë Teknike Postfashiste. Qysh prej dhjetorit 1944 Alcide De Gasperi ishte Ministër i Jashtëm në Kabinetin e Qeverisë Teknike. Madje Kongresi i partisë së tij e kishte zgjedhur atë qysh më parë Sekretar të Përgjithshëm. Në dhjetor 1945 ai mori postin e Kryeministrit. Deri në momentin e dorëheqjes së detyruar të tij si pasojë e një mocioni mosbesimi në vitin 1953 ai drejtoi koalicionet e ndryshme qeverisëse. Ai drejtoi gjithsej tetë kabinete. Në vitin 1951 ai mori përsëri drejtimin e Ministrisë së Jashtme.

Si shef i Qeverisë De Gasperi duhej të përballej me shumë sfida. Ndër tyre përmenden nënshkrimi i Marrëveshjes së Paqes me Aleatët në Paris në vitin 1947, ripërtëritja shpirtërore dhe morale e Italisë, e cila për më shumë se dy dekada kishte qëndruar nën diktaturën fashiste dhe vuante pasojat e një lufte të humbur, rindërtimi material, kalimi nga Monarkia në Republikë, i cili u vendos me referendumin popullor të vitit 1946, si edhe vendosja e shtetit të së drejtës dhe demokracisë parlamentare.

Ashtu si Konrad Adenauer edhe Alcide De Gasperi u angazhua me vendosmëri për bashkimin e vendit të tij me Perëndimin dhe kundër qëndrimit prosovjetik të partive të majta. Me shpërthimin e konfliktit Lindje-Perëndim menjëherë pas përfundimit të luftës, ai kërkoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe të Demokracive të tjera të Perëndimit. Me vendosmëri ai e çoi vendin e tij drejt Aleancës Perëndimore të mbrojtjes dhe të vlerave. Në vitin 1949 Italia ishte një nga anëtarët themelues të NATO-s.

Si vizionar i një Evrope politikisht dhe ekonomikisht të bashkuar dhe që jeton në paqe Alcide De Gasperi mbështeti fuqishëm projektin për integrimin evropian. Krahas Schuhman, Konrad Adenauer dhe Joseph Bech ai me të drejtë cilësohet si një nga iniciatorët e procesit të Bashkimit Evropian. Ai luajti një rol drejtues për themelimin e Unionit Evropian për Qymyr dhe Çelik (EGKS) në vitin 1952. Sigurisht që Alcide De Gasperi nuk ishte i kënaqur vetëm me integrimin ekonomik të shteteve anëtare. Qëllimi i tij ishte krijimi i një bashkësie politike të shteteve evropiane. Prandaj gjatë negociatave për EGKS-në ai u angazhua me sukses për themelimin e Asamblesë Parlamentare, në mënyrë që Bashkësisë t'i shtohet edhe një dimension politik dhe demokratik. Nga Asambleja Parlamentare e EGKS-së lindi më vonë Parlamenti Evropian. Edhe planet për një Bashkësi Politike Evropiane (EPG) bazohen në iniciativën e De Gasperit. M.q.se projekti i EPG-së lidhej ngushtësisht me Traktatin për Unionin Evropian të Mbrojtjes (EVG), ai dështoi në vitin 1954, kur Asambleja Kombëtare Franceze nuk e ratifikoi Traktatin e EVG-së.

Më 11 maj 1954 Alcide De Gasperi u zgjodh President i Asamblesë Parlamentare të EGKS-së. Për meritat e tij në bashkimin e Evropës në vitin 1952 atij iu akordua Çmimi i Karlit i Bashkisë Ahen. De Gasperi u nda nga jeta në datën 19 gusht 1954 në Borgo Valsugana. Si një politiken dhe burrë i shquar shteti, i cili pas viteve të diktaturës dhe të terrorit e drejtoi Italinë drejt rrugës së demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të pluralizmit, si edhe i dha formë dhe çoi përpara integrimin evropian, Alcide De Gasperi ka mbetur i paharruar deri në ditët e sotme.

4.4 ROBERT SCHUHMAN (1886-1963)

Në vitet 1947 deri 1948 Robert Schuhman ishte Kryeministër dhe në vitet 1948 deri 1952 Ministër i Jashtëm i Republikës së Katërt Franceze.

Robert Schuhman lindi më 29 qershor 1886 në Klozen, një rrethinë e Luksemburgut, si biri i një familje katolike dhe me pozita të mira. Babi i tij, pas aneksimit të Lorenës nga Rajhu Gjerman në vitin 1871, u largua prej andej. Në vitin 1904 Robert Schuhman filloi studimet e tij për Jurisprudencë në Bon. Këto studime ai i vazhdoi në Mynih dhe në Berlin dhe i përfundoi në Strasburg në vitin 1910 me mbrojtjen e titullit “Dr.jur.”. Dy vite më vonë ai hapi

në Metc të Lorenës një zyrë avokatie. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore në vitin 1914, Robert Schuhman, i cili në vitin 1908 ishte liruar nga shërbimi ushtarak, u angazhua me palën gjermane në shërbime ndihmëse civile në Metc dhe Bolei.

Me ribashkimin e Alzas-Lorenës me Francën në vitin 1919 Robert Schuhmanit iu akordua shtetësia franceze. Në të njëjtin vit ai hyri në skenën politike kombëtare. Pas zgjedhjes së Dhomën e Deputetëve në nëntor 1919 Robert Schuhmani ishte deputet i *Union Républicaine Lorraine* dhe përfaqësues i Lorenës në Parlamentin francez. Këtë mandat ai e mbajti deri në vitin 1940 për parti te ndryshme, fillimisht për *Entente Républicaine Démocratique*, qysh prej vitit 1932 për *Parti Démocratique Populaire*. Në *Chambre des députés* ai u aktivizua para së gjithash në Komisionin për Alzasën dhe Lorenën, i cili përfaqësonte interesat e rajonit brenda Francës. Nga viti 1919 deri 1927 Robert Schuhman ishte Sekretar Parlamentar i Shtetit, qysh prej 1927 Zëvendëskryetar dhe nga 1929 deri 1936 Kryetar i këtij komisioni.

Qysh para marshimit të Ushtrisë Gjermane në Francë në maj 1940 Robert Schuhman ishte emëruar si Nënsekretar Shteti për çështjet e emigrantëve në Qeveri. Pas kapitullimit të Francës në qershor 1940 dhe pushtimit të Francës Veriore nga trupat gjermane Robert Schuhman e refuzoi ofertën për marrjen e një detyre ministrore në Qeverinë Vichy dhe shkoi në Metz. Atje ai u arrestua nga Gestapo më 14 shtator 1940. Në gusht 1942 ai u largua nga Noishtat an der Vainshtrese në Renland-Pfalc për në Francë. Deri në vitin 1944 ai jetoi në fshehtësi dhe mbante kontakte me *Résistance*. Pasi trupat aleate e çliruan Francën nga trupat pushtuese gjermane, Robert Schuhman në nëntor 1944 u aktivizua për themelimin e partisë kristian-demokrate *Mouvement Républicaine Populaire*, ku ai ishte një nga personalitetet e saj drejtuese në vijim.

Në vitet 1945 dhe 1946 Robert Schuhman ishte anëtar Asambleve Nacionale Kushtetuese , në nëntor 1946 ai si kandidat i *Mouvement Républicaine Populaire* u rizgjodh në *Assemblée Nationale*, pjesë e së cilës ai ishte si deputet deri në vitin 1962. Prej qershorit 1946 Schuhman ishte emëruar Ministër i Financave në Qeverinë e Përkohshme. Në datën 24 nëntor 1947 ai u zgjodh Kryeministër i Republikës së Katërt Franceze. Nga kjo detyrë ai dha dorëheqjen në datën 19 korrik 1948, vetëm shtatë ditë më vonë ai u ngarkua me funksionin e Ministrit të Jashtëm. Në pesë Kabinete jetëshkurtra Robert Schuhman mbajti postin e Ministrit të Jashtëm deri në janar 1953. Gjatë kësaj periudhe ai garantoj vijimësinë e politikës së jashtme franceze. Nga viti 1955 deri në fillim të 1956 Robert Schuhman ishte Ministër Drejtësie.

Gjatë inicimit dhe negocimit të të gjitha Traktateve ndërkombëtare me rëndësi në periudhën e pasluftës Robert Schuhman ka luajtur një rol kyç si Ministër i Jashtëm francez. Gjatë mandatit të tij u realizua themelimi i Këshillit të Evropës dhe i NATO-s (1949) si edhe nënshkrimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950). Në qendër të përpjekjeve të Robert Schuhmanit në politikën e jashtme ishin pajtimi me Gjermaninë dhe ndërtimi i institucioneve evropiane me pjesëmarrjen e Republikës Federale. Qëllimet e tij ishin garantimi i paqes dhe lirisë në Evropë, por edhe krijimi i prosperitetit dhe i mirëqenies. Krahas kësaj u synua edhe lidhja e Republikës Federale me organizatat supranacionale, mbështetur në nevojën e Francës për siguri kundrejt Gjermanisë, konstatuar në gjysmën e parë të shekullit. Më 9 maj 1950 Robert Schuhman propozoi që gjithë prodhimi i qymyrit dhe i çelikut në Francë dhe Gjermani të ishte nën administrimin e një autoriteti më të lartë të përbashkët, i cili duhej të organizonte

dhe të rregullonte tregun përkatës. Sipas planeve franceze kjo organizatë e përbashkët duhej të ishte e hapur edhe për shtetet e tjera evropiane, të përbënte themelin e një Unioni ekonomik dhe politik në Evropë dhe në këtë mënyrë të kontribuonte në ruajtjen e paqes në Kontinentin Evropian. Këtë propozim të Robert Schuhmanit, i cili njihet si “Plani Schuhman” dhe të cilin e përpunoi drejtori i Autoritetit Francez të Planifikimeve Jean Monnet, e përshëndeti edhe Konrad Adenaueri, si edhe shtetet e Benelux-it dhe Italia. Ministrat e Jashtëm të Francës, Gjermanisë, Italisë, Belgjikës, Luksemburgut dhe Holandës nënshkruan më 18 prill 1951 në Paris Traktatin për Unionin Evropian për Qymyr dhe Çelik (EGKS), i cili hyri në fuqi në datën 23 korrik 1952. “Montanunion”, siç quhet ndryshe EGKS-ja, përbën qelizën bazë të procesit të bashkimit të Evropës.

Projektet për Unionin Evropian të Mbrojtjes (EVG) dhe të Unionit Evropian Politik (EPG), të iniciuara dhe mbështetura edhe nga Schuhmani, dështuan në vitin 1954 sepse nuk u ratifikuan nga *Assemblée Nationale*.

Nga viti 1958 deri 1960 Robert Schuhman ishte President i Parlamentit Evropian, i cili pas dorëheqjes së tij në vitin 1960 e emëroi President Nderi. Më 15 maj 1958 “në shenjë mirënjohjeje për meritat e tij të larta në hedhjen e themeleve të para praktike të Federatës Evropiane në fushën politike dhe ekonomike dhe të së ardhmes së përbashkët të Gjermanisë dhe Francës në paqe dhe siguri” ai u nderua me çmimin ndërkombëtar të Bashkisë Ahen. Robert Schuhman ndërroi jetë më 4 shtator 1963 në Scy-Chazelles në Metc në moshën 77 vjeçare. Ai ka hyrë në histori si vizionar dhe iniciator i një Evrope të bashkuar.

4.5 HELMUT KOHL (*1930)

Helmut Kohl ishte në vitet 1982 deri 1998 Kancelar i Republikës Federale Gjermane dhe nga viti 1973 deri 1998 Kryetar i CDU-së gjermane.

Helmut Kohl ka lindur në datën 3 prill 1930 në Ludvigshafen mbi Ren dhe u rrit si biri i një financieri në një familje katolike dhe qytetare. Ai u aktivizua në politikë përpara mbarimit të maturës në vitin 1950. Qysh në rini ai u angazhua tek Unioni Rinor, në vitin 1947 ai u bë anëtar i CDU-së. Që student Kohli i ngjiti shkallët e partisë: në vitin 1953 ai u bë anëtar i Kryesisë së CDU-së në Qarkun Pfalc, në vitin 1955 ai u ngjit tek Kryesia e CDU-së në Landin Renland-Pfalc.

Pas fillimit të studimeve të tij për Histori, Shkenca Politike, të Drejtë Shteti dhe të Drejtë Publike në Universitetet e Frankfurtit dhe Haidelbergut, ku ai ishte punonjës shkencor në vitet 1956 deri 1958 dhe mbrojtjes së titullit “Dr.phil.” (1958) Helmut Kohli në moshën 29 vjeçare hyri në Parlamentin e Landit Renland-Pfalc. Deri në vitin 1976 ai mbajti mandatin në Parlamentin e Landit, nga viti 1963 deri 1969 ai ishte Kryetar i Grupit Parlamentar të CDU-së në Parlamentin e Landit. Krahas kësaj Helmut Kohli në vitin 1966 u zgjodh me detyrën e Kryetarit të CDU-së për Landin Renland-Pfalc. Në vitin 1969 ai u ngarkua – në gjysmën e legjislaturës – me detyrën e Kryeministrit të Landit Renland-Pfalc. Gjatë zgjedhjeve për Parlamentin e Landit në vitet 1971 dhe 1975 CDU-ja me në krye Helmut Kohlin mori shumicën absolute të votave. Helmut Kohli qëndroi si Kryeministër deri në vitin 1976.

Arritjet më të mëdha gjatë periudhës së qeverisjes së tij ishin një reformë e përgjithshme territoriale dhe administrative si edhe reforma të thella në sistemin arsimor si edhe në sistemin social dhe shëndetësor të Renland-Pfalcit.

Në vitin 1973 Helmut Kohli zgjidhet Kryetar i CDU-së në Gjermani. Këtë funksion ai e ushtroi për 25 vite me radhë. Nën drejtimin e tij u arrit që CDU-ja të modernizohej në mënyrë të vazhdueshme dhe të profesionalizohej puna e partisë. U fuqizua programi, u rrit numri i bashkëpunëtorëve të partisë dhe u fuqizuan strukturat lokale. Partia, numri i anëtarëve të së cilës i kaloi 700.000, i integroi me sukses mbështetësit nga të gjitha shtresat e popullsisë. Helmut Kohli në këtë mënyrë e shndërroi CDU-në në një parti popullore moderne dhe performante.

Gjatë zgjedhjeve për Bundestagun në vitin 1976 Helmut Kohli, si kandidat për Kancelar i Unionit, për pak nuk arriti të siguronte shumicën absolute gjatë votimit të dytë, dhe në këtë mënyrë socialdemokrati Helmut-Schmidt krijoi sërisht një koalicion qeverisës midis SPD-së dhe FDP-së. Kohli u zgjodh Kryetari i grupit parlamentar CDU/CSU dhe ishte drejtuesi i opozitës në Bundestagun gjerman. Në zgjedhjet për Bundestagun në vitin 1980 ai ia la radhën Kryetarit të Partisë simotër Bavareze CDU, Franz Josef Strauß. Pas fitores së përsëritur të SPD-së dhe FDP-së Kohli qëndroi drejtuesi i opozitës në Bundestagun gjerman. Pas shpërbërjes së koalicionit social-liberal ai, për herë të parë në histori, u zgjodh në datën 1 tetor 1982 nëpërmjet një mocioni mosbesimi konstruktiv dhe të suksesshëm si Kancelari i ri i Gjermanisë. Pas zgjedhjeve të suksesshme në vitet 1983, 1987, 1990 dhe 1994 Kohli u konfirmua në detyrë nga një shumicë parlamentare kristian-liberale. Vetëm pas zgjedhjeve të Bundestagut në vitin 1998, tek të cilat CDU/CSU dhe FDP nuk fituan shumicën në Parlament, Helmut Kohli u largua nga detyra e tij si Kancelar, të cilën e kishte ushtruar për 16 vite me radhë dhe ai dha dorëheqjen edhe si kryetar i partisë së tij. Në nëntor të vitit 1998 Konventa e Partisë në Bon i akordoi atij Kryesinë e Nderit të CDU-së. Nga kjo detyrë ai u tërhoq në datën 18 janar 2000 për shkak të aferës së sponsorizimit të partisë së tij.

Në fillim të mandatit të tij si Kancelar në vitin 1983, Helmut Kohli zbatoi vendimin e dyfishtë të NATO-s të vitit 1979, i cili parashikonte stacionimin e raketave atomike amerikane me valë të shkurtra në territorin e Republikës Federale, me gjithë protestat e fuqishme të Lëvizjes për Paqe. Në lidhje me politikën ekonomike dhe të rendit ai kishte shpallur që në deklaratën e tij qeveritare në vitin 1982 mbështetjen në parimet e Ekonomisë Sociale të Tregut. Me politikën e tij konsekuente të konsolidimit dhe stabilizimit koalicioni kristian-liberal deri në vitin 1989 stabilizoi ndjeshëm kuotat e kontributeve të sigurimeve shoqërore si edhe uli normën e inflacionit. Përveç kësaj produkti i brendshëm bruto u rrit vazhdimisht, numri i të punësuarve në periudhën 1982 deri 1989 u rrit me 2,24 milionë persona dhe borxhi i ri vjetor u ul.

Pas rënies së Murit në datën 9 nëntor 1989 Helmut Kohli e administroi me konsekuencë këtë rast historik dhe dha një kontribut vendimtar në realizimin e “Bashkimit në Liri” që synonte CDU-ja gjermane që nga periudha e Adenauerit. Me prezantimin e programit tij me dhjetë pika, një plani gradual me qëllim ribashkimin e Gjermanisë, në datën 28 nëntor 1989 ai ndërmori një iniciativë politike në Gjermani. Shumica e gjermano-lindorëve nënvijëzoi vullnetin e saj për një ribashkim të shpejtë, midis të tjerash edhe nëpërmjet fitores së “Aleancës për Gjermaninë” në zgjedhjet e para dhe të vetme të lira për Dhomën e Popullit në

DDR në datën 18 mars 1990. Më 1 korrik 1990 u krijua Unioni Monetar, Ekonomik dhe Social midis Republikës Federale dhe DDR-së, në datën 31 gusht 1990 u nënshkrua Traktati i Bashkimit, i cili përcaktonte detajet e ribashkimit gjerman. Hapin vendimtar në politikën e jashtme Helmut Kohli e hodhi në korrik 1990 gjatë takimit me Gorbaçovin në Kaukaz, kur ky miratoi anëtarësimin e Gjermanisë së bashkuar në NATO. Njëpërmjet “Traktatit Dy Plus Katër” të nënshkruar midis Republikës Federale dhe DDR-së më 12 shtator 1990, katër Fuqitë Fituese të Luftës së Dytë Botërore i kaluan Gjermanisë së Bashkuar sovranitetin e plotë. Në datën 3 tetor 1990 Landet që ndodheshin në territorin e DDR-së Meklemburg-Forpomern, Brandenburg, Saksoni-Anhalt, Tyringen, Saksoni, si edhe rajonet e Berlinit Lindor kaluan nën kompetencën e Kushtetutës. Helmut Kohli kishte arritur kulmin e karrierës së tij politike. Ribashkimi gjerman u realizua.

Si evropian i bindur Helmut Kohli u angazhua për një thellim të procesit të bashkimit evropian. Ndër sukseset më të mëdha të politikës së tij evropiane përmendim Traktatin e Shengenit në vitin 1985, i cili kishte si qëllim heqjen e kontrolleve të brendshme kufitare, Traktati i Mastrihtit i nënshkruar në vitin 1992, i cili themeloi krijimin e Bashkimit Evropian (BE) dhe synonte krijimin e një Unioni Ekonomik dhe Monetar, si edhe Traktati i Amsterdimit i datës 2 tetor 1997, i cili reformonte strukturat e BE-së.

Në gjysmën e dytë të periudhës së tij qeverisëse Helmut Kohli u konfrontua me sfidën e integritetit të pesë Landeve të reja me një ekonomi pjesërisht shumë të dobët. M.q.se gjendja e ekonomike e ekonomisë gjermano-lindore paraqitej shumë më e keqe se sa e prisnin ekspertët, kostot e ribashkimit u rritën shumë më tepër nga parashikimi. Rritjet e taksave si edhe rritja e borxhit të ri me qëllim mbulimin e kostove të ribashkimit duhet të shmangeshin ashtu si edhe rritja e numrit të papunësisë në kuadër të ristrukturimit të ekonomisë në Gjermaninë Lindore. Por projektet e rëndësishme reformuese të koalicionit qeverisës kristian-liberal, si p.sh. reforma e gjerë për taksat në vitin 1997, u bllokuan nga shumica e SPD-së në Dhomën e Lartë të Parlamentit gjerman.

Për meritat e tij në bashkimin e Gjermanisë dhe të Evropës Helmut Kohlit i janë akorduar çmime të shumta si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Midis të tjerave në tetor 1998 atij iu akordua Kryqi i Madh i Meritave i Republikës Federale Gjermane me kurorë dafinash dhe në vitin 1999 Presidenti amerikan Bill Clinton i akordoi atij “Presidential Medal of Freedom”. Në dhjetor të vitit 1998 Presidentët dhe Kryeministrat e BE-së e shpallën atë “Qytetar Nderi të Evropës” – një dekoratë e cila i ishte akorduar më parë vetëm njërit prej baballarëve të themelimit të Bashkësisë Evropiane, francezit Jean Monnet.

4.7 JEAN-CLAUDE JUNCKER (*1954)

Jean-Claude Juncker është Kryeministër i Luksemburgut qysh prej vitit 1995. Nga 1989 deri 2009 ai mbante edhe postin e Ministrit të Financave. Nga 1990 deri 1995 ai ishte Kryetar i Partisë Popullore Kristian-Sociale.

Jean-Claude Juncker ka lindur më 9 dhjetor 1954 në Redonzhë-Syr-Atert në Perëndim të Luksemburgut si djali i një punëtori çeliku. Pas maturës dhe hyrjes në Partinë Popullore

Kristian-Sociale (CVS) në vitin 1974 ai në vitin 1975 filloi studimet e tij për Shkenca Juridike në Strasburg. Këto ai i përfundoi në vitin 1979 me marrjen e diplomës juridike.

Që në periudhën studentore Jean-Claude Juncker ra në sy për angazhimin dhe talentin e tij politik. Që nga viti 1979 ai mbajti postin e sekretarit të grupit parlamentar të CVS-së. Në dhjetor 1982 Juncker u emërua Sekretar Shteti për Punë dhe Siguri Sociale. Gjatë zgjedhjeve për Parlamentin e Luksemburgut në vitin 1984 Jean-Claude Juncker fitoi për herë të parë një mandat në Parlament dhe më pas në moshën 29 vjeçare u caktua Ministër i Punës dhe Ministër për Çështjet e Buxhetit. Në Evropë Jean-Claude Juncker ra në sy në vitin 1985, kur në kuadër të Presidencës së Luksemburgut në Këshill ai mori përsipër drejtimin në Këshillin Social dhe të Buxhetit të Unionit Evropian (BE).

Pas zgjedhjeve të vitit 1989 Jean-Claude Juncker u emërua Ministër i Financave dhe i Punës. Në këtë cilësi ai u zbatoi Ligjin e amenduar të Luksemburgut për Punën dhe të Papunët. Krahas kësaj në vitin 1992 ai paraqiti në Parlament një reformë të rëndësishme për taksat, e cila hyri në fuqi në datën 1 janar 1993. Jean-Claude Juncker ka luajtur një rol të rëndësishëm në uljen e borxhit shtetëror relativisht të ulët. Në vitin 1994 Luksemburgu ishte i vetmi shtet, i cili përmbushte rregullat e konvergencës të përcaktuara në Traktatin e Mاستrihtit për anëtarësim në Unionin Ekonomik dhe Monetar. Në janar 1990 Jean-Claude Juncker mori postin e kryetarit të CVS-së. Këtë funksion ai e ushtroi deri në fillim të vitit 1995. Nga viti 1989 deri 1995 ai ishte Guvernator i Bankës Botërore.

Si kryetar i Këshillit të EU për Ekonomi dhe Financa (Këshilli Ecofin) Jean-Claude Juncker në vitin 1991 ushtroi një ndikim të rëndësishëm në hartimin e Traktatit të Mاستrihtit, i cili ishte baza e Bashkimit Evropian (BE) dhe çoi përpara zhvillimin e Unionit Evropian Ekonomik dhe Monetar. Vetëm shpikja prej tij e parimit *opting out* (parimi i mospjesëmarrjes) për Britaninë e Madhe shmangu dështimin e negociatave për Unionin Ekonomik dhe Monetar.

Pas fitores së përsëritur në Parlament në vitin 1994, Jean-Claude Juncker u konfirmua si Ministër i Financave dhe i Punës. Në janar 1995 ai u zgjodh Kryeministër. Ish-kryeministri i mëparshëm Jacques Santer ishte zgjedhur më parë President i Komisionit Evropian. Jean-Claude Juncker mbajti kompetencat e tij të deritanishme dhe krahas tyre mori përsipër edhe drejtimin e Ministrisë së Thesarit. Qysh prej 1995 ai është edhe Guvernator i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh).

Si Kryeministër Jean-Claude Juncker ndërmori një politikë evropiane të qëndrueshme dhe të angazhuar dhe kundërshtoi vazhdimisht dobësimin e Traktatit të Mاستrihtit dhe të kriterëve të konvergencës të përcaktuara atje. Në fokus të publikut të gjerë ndërkombëtar Jean-Claude Juncker hyri në dhjetor 1996, kua ai ia doli mbanë që të ndërmjetësonte midis Presidentit francez Jacques Chirac dhe Kancelarit gjerman Helmut Kohl për çështjen e Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit dhe në këtë mënyrë e përmbylli me sukses Këshillin Evropian të Dublinit. Krahas kësaj Jean-Claude Juncker në gjysmën e vitit 1997 në cilësinë e Presidentit të Këshillit të BE-së vendosi piketa të rëndësishme brenda Komunitetit. Në dhjetor 1997 Këshilli Evropian i mbledhur në Strasburg filloi negociatat për anëtarësim me dhjetë shtete të Evropës Lindore. U themelua gjithashtu edhe një forum informal, “Grupi 11 Euro”, për koordinimin e

politike dhe financiare në Eurozonë, pjesë e të cilit ishin anëtarët e Unionit Monetar. Qysh prej fillimit të vitit 2005 Jean-Claude Juncker është Kryetari i parë i përhershëm i këtij Forumi, i cili ndërkohë e ka ndryshuar emërtimin në “Eurogrup”.

CSV-ja i fitoi zgjedhjet parlamentare në qershor 1999 dhe krijoi një koalicion qeverisës me Partinë Demokratike (PD). Kryeministri mbeti në detyrë. Nga viti 1999 deri në 2004 ai drejtoi edhe sektorët Financë dhe Komunikim. Pas fitores bindëse të CSV-së në vitin 2004 dhe krijimit të Qeverisë me Partinë Socialiste të Punës të Luksemburgut (PSPL), e cila gjatë viteve 1984 deri 1999 kishte drejtuar në krah të CVS-së, Jean-Claude Juncker u konfirmua në postet e Kryeministrit, Ministrit të Shtetit dhe Ministrit të Financave.

Falë ndërmjetësimit të Kryeministrit të Luksemburgut Këshilli Evropian në mars 2005, kur Luksemburgu mori përsëri Presidencën e BE-së, ra dakord për një reformë të Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit. Ai u angazhua gjithashtu edhe për rigjallërimin e strategjisë së Lisbonës të vitit 2002, për të nxjerrë dukshëm në pah aspektet sociale dhe ekologjike të procesit të integrimit evropian. Kur më 10 korrik 2005 do të mbahej në Luksemburg referendumi për Kushtetutën Evropiane, e cila ishte refuzuar më parë nga shumica e francezëve dhe e holandezëve, Jean-Claude Juncker u angazhua me vendosmëri dhe me sukses për pranimin e Kushtetutës në vendin e tij.

Pa Jean-Claude Junckerin procesi i bashkimit të Evropës nuk do të kishte qenë aq i suksesshëm sa është në ditët e sotme. Këmbëngulja dhe angazhimi i tij, por para së gjithash talenti për gjetjen e kompromiseve kanë çuar drejt suksesit shumicën e samiteve të shkuara të BE-së. Ai, për të cilin bashkimi i Evropës është në radhë të parë një projekt për paqe, ka luajtur një kyç në të gjithë hapat integrues gjatë të shkuarës së afërt.

Jean-Claude Juncker ka marrë një sërë dekoratash. Për vlerësimin e veprimtarisë së tij për një Evropë sociale dhe të bashkuar në datën 26 maj 2006 atij i është akorduar Çmimi Ndërkombëtar i Karlit i Bashkisë Ahen. Më parë ai është vlerësuar midis të tjerave në vitin 2003 nga “Shoqëria Werkstatt Deutschland” me titullin “Evropiani i vitit”.

4.8 ANGELA MERKEL (*1954)

Qysh prej prillit 2000 Angela Merkel është Kryetare e CDU-së në Gjermani dhe qysh prej nëntorit 2005 Kancelare e Republikës Federale Gjermane. Më parë, në vitet 1991 deri 1994, ajo ishte Ministre për Gratë dhe Rininë, nga 1994 deri 1998 Ministre për Mjedisin, Mbrojtjen e Natyrës dhe Sigurinë e Reaktorëve dhe prej vitit 1998 deri 2000 Sekretare e Përgjithshme e CDU-së në Gjermani.

Pak javë pas lindjes së Angela Merkelit në vitin 1954 në Hamburg prindërit e saj u shpërngulën nga ky qytet, në të cilin babai i saj kishte mbaruar studimet për Teologji, dhe shkuan në DDR. Babait të saj, i cili e kishte origjinën nga Berlini Lindor, iu ngarkua nga Kisha e Landit të tij, Kisha Evangjeliste në Berlin-Brandenburg, funksioni si prift në fshatin Kuicov në Perleberg. Në vitin 1957 ai u bë pastor dhe drejtues i një Seminari për Formim Kishtar në qytetin Templin në Brandenburgun Verior.

Angela Merkel binte në sy në shkollë për rezultatet e saj të shkëlqyera, veçanërisht në rusisht dhe matematikë. Ajo nuk mori pjesë në festën rinore socialiste të bashkëmoshatarëve të saj, por në vend të saj ajo u konfirmua. Në vitin 1973 ajo mbaroi maturën. Në vijim ajo studioi Fizikë në Laipcik. Studimet i përfundoi në vitin 1978. Nga viti 1978 deri 1989 ajo punoi në Institutin Qendror për Kimi Fizikale në Akademinë e Shkencave në Berlin; atje ajo përfundoi doktoraturën dhe mori titullin “Dr.rer.nat.”.

Në vjeshtën e vitit 1989 Merkel iu bashkëngjiti *Fillimit Demokratik* (DA). Atje ajo mori detyrën e zëdhënësës së shtypit. Në zgjedhjet e para të lira për Dhomën e Popullit në datën 18 mars 1990 Fillimi Demokratik mori vetëm 0,9% të votave. CDU-ja Lindore me kandidatin Lothar de Maiziere, e cila bashkë me FD-në dhe Unionin Social Gjerman (DSU) kishte krijuar aleancën zgjedhore “Aleanca për Gjermaninë”, mori 41% të votave. U formua një koalicion i gjerë me CDU-në, DSU-në, DA-në, Socialdemokratët dhe Liberalët. Angela Merkel u caktua zëvendës/zëdhënës e shtypit të Qeverisë së DDR-së të dalë nga këto zgjedhje të para dhe të vetme të lira. CDU-ja Lindore dhe DA-ja u bashkuan në datën 1/2 Tetor 1990 me CDU-në e Gjermanisë Perëndimore. Në këtë mënyrë edhe Angela Merkel u bë anëtare e CDU-së. Me ribashkimin e Gjermanisë më 3 tetor 1990 përfundoi edhe aktiviteti i saj si zëvendës/zëdhënës e shtypit e Qeverisë në DDR.

Gjatë zgjedhjeve të para të përbashkëta të Bundestagut në datën 2 dhjetor 1990 Angela Merkel fitoi zgjedhjet në qarkun Stralsund/Rygen/Grimen me 48,5% të votave. Kancelari Helmut Kohl e emëroi atë Ministre për Gratë dhe Rininë në kabinetin e tij. Krahas detyrës së saj si Ministre në vitet 1992 deri 1993 ajo ishte Kryetare e Grupit Evangjelist të Punës (EAK) të CDU/CSU-së; në vitin 1993 ajo u bë Kryetare e CDU-së së Landit Meklenburg-Forpomern.

Pas zgjedhjeve të Bundestagut në vitin 1994 Angela Merkel u emërua Ministre për Mjedisin, Mbrojtjen e Natyrës dhe Sigurinë e Reaktorëve. Katër vite më vonë, 1998, CDU/CSU-ja dhe FDP-ja i humbën zgjedhjet për në Bundestagun gjerman. Në Konventën e parë të Partisë të CDU-së pas disfatës në zgjedhje Kryetar i ri i CDU-së u zgjodh Wolfgang Schäuble. Merkel u bë Sekretarja e re e Përgjithshme e CDU-së gjermane. Ajo dorëzoi postin e saj si Kryetare e CDU-së në Landin Meklenburg-Forpomern. Në muajt vijues CDU-ja arriti rezultate të mira në zgjedhjet për Parlamentet e Landeve dhe në qershor 1999 fitoi bindshëm 48,7% në Zgjedhjet Evropiane.

Pas aferës së sponsorizimeve, e cila e tronditi CDU-në në vitet 1999/2000 dhe për pasojë Helmut Kohli dha dorëheqjen si Kryetar Nderi dhe Wolfgang Schäuble dha dorëheqjen si Kryetar i Partisë, në datën 10 prill 2000 Merkel u zgjodh Kryetare e re e CDU-së.

Në zgjedhjet e Bundestagut në vitin 2002 Angela Merkel synonte të fitonte si kandidate e CDU dhe CSU-së, por kishte shumë pak mbështetje nga forumet drejtuese të të dy partive. Shumë kryeministra të CDU-së dhe kryetarë të Landeve favorizuan Kryeministrin e Bavarisë dhe Kryetarin e CSU-së Edmund Stoiber, i cili në fund u propozua nga Merkel si kandidat për Kancelar i CDU dhe CSU-së në zgjedhjet e Bundestagut kundër kancelarit në detyrë Gerhard Schröder. Me një diferencë shumë të vogël votash ai nuk arriti të fitonte. Pas zgjedhjeve për Bundestagun në vitin 2002 Merkeli u ngarkua me detyrën e kryetares së grupit parlamentar të

CDU/CSU-së dhe në këtë mënyrë ishte pasuese e Friedrich Merz si kryetare e opozitës në Bundestagun Gjerman.

Në zgjedhjet e parakohshme për Bundestagun Gjerman në vitin 2005 Angela Merkel ishte kandidate për Kancelare e Partive të Unionit. Në rezultatet e zgjedhjeve për Bundestagun më 18 shtator CDU-ja dhe CSU-ja morën së bashku 35,2% të votave dhe në këtë mënyrë ishin shumë pak përpara SPD-së, e cila mori 34,2% të votave duke qenë edhe grupi parlamentar më i fuqishëm në Bundestagun Gjerman. U formua një koalicion mbi baza të gjera midis CDU-së, CSU-së dhe SPD-së, i cili e zgjodhi Merkelin si Kancelaren e parë të Republikës Federale Gjermane. Në moshën 51 vjeçare ajo ishte edhe mbajtësja me moshën më të re e këtij posti në historinë e Republikës Federale Gjermane. Ajo është gjithashtu edhe personi i parë me biografi DDR-je dhe përfaqësuesja e parë e Shkencave Natyrore në këtë detyrë. Si Kancelare e Koalicionit mbi baza të gjera Angela Merkel ndoqi një stil qeverisjeje objektiv dhe jo pretencioz. Rëndësi të madh ajo i kushtoi marrëdhënies së fqinjësisë së mirë me Poloninë dhe Francën, me Shtetet e Bashkuara dhe natyrisht me BE-në. Ajo dha shtypa për krijimin e Traktatit të Lisbonës. Impulse të rëndësishme ajo dha në çështjet për të drejtat e njeriut: kështu në vitin 2007 ajo priti në Zyrën e saj Dalai Lamën, megjithëse Republika e Kinës, e cila ishte duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme në ekonomi dhe politikë, u shpreh e pakënaqur.

Si Shefe e Qeverisë Gjermane gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 ajo mori kryesimin e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe të G8. Angela Merkel ka merita të mëdha në Bashkimin Evropian, i cili për të – bashkë me miqësinë ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Izraelin – përbën themelin e politikës gjermane. Ajo vlerësoi njëkohësisht rëndësinë e partneritetit strategjik me Rusinë dhe të fuqizimit të marrëdhënieve me Kinën dhe Indinë si edhe me Kontinentin Afrikan.

Qysh prej periudhës së saj si Ministre e Mjedisit Angela Merkel është shumë e angazhuar për mbrojtjen e klimës në mbarë botën. Ajo ishte organizatorja e Konferencës së parë të Kombeve të Bashkuara në vitin 1995 në Berlin, e cila vendosi reduktimin e gazrave që shkaktojnë efektin serë. Si Kancelare Angela Merkel e angazhoi Gjermaninë për një reduktim të vazhdueshëm dhe të shpejtë të CO₂. Fundi i mandatit të parë të Angela Merkelit u karakterizua nga kriza e tregjeve financiare dhe ekonomike në mbarë botën.

Në vitin 2009 ajo u rizgjodh për herë të dytë si Kancelare e Gjermanisë.

Edhe muajt e parë të Qeverisë së re nën drejtimin e Angela Merkelit ishin nën ndikimin e krizës së tregjeve financiare dhe ekonomike në mbarë botën. Në fokus të politikës së brendshme gjatë mandatit të saj të dytë janë krahas mbështetjes për kërkime dhe arsimin edhe tejkalimi i krizës ekonomike dhe financiare, konsolidimi i buxhetit, reforma në sektorin e shëndetësisë si edhe politika për energjinë.

Bilanci i parë i ndërmjetëm i mandatit të dytë të Angela Merkelit duket të jetë pozitiv në këtë moment të hershëm. Në marrëveshje me partnerët e BE-së u arrit stabiliteti i Euros, u siguruan kursimet private, filloi rritja ekonomike e Gjermanisë pas krizës ekonomike dhe financiare mbarëbotërore, Republika Federale gëzon një pozitë të kënaqshme në krahasim me shtetet e

tjera sa i përket zhvillimeve financiare dhe atyre në tregun e punës. Gjermania është në rrugë të mbarë dhe ka dalë më e fortë nga kriza, se sa hyri në fillim.

Qysh prej datës 30 dhjetor 1998 Angela Merkel është e martuar me Joachim Sauer, Profesor Kimie në Universitetin e Humboldt në Berlin. Merkel ka marrë çmimin e Karlit në vitin 2008 si edhe disa tituj nderi. Revista *Forbes Magazine* e ka quajtur atë si gruaja më e fortë e botës për periudhën midis viteve 2006 dhe 2009 dhe për *Time* ajo bën pjesë tek 100 personat, që e kanë karakterizuar më shumë botën tonë.

AUTORËT DHE KONTRIBUESIT

Dr. Manfred Agethen është bashkëpunëtor shkencor në Departamentin Qendror (HA) për Shërbime Shkencore / Arkiva për politikën Kristian-Demokrate në Fondacionin Konrad Adenauer (KAS), Shën Augustin.

Christopher Beckmann është bashkëpunëtor shkencor në Departamentin Qendror (HA) për Shërbime Shkencore / Arkiva për politikën Kristian-Demokrate të Fondacionit Konrad Adenauer (KAS), Shën Augustin.

Dr. Nino Galetti është drejtuesi i Kryesisë së KAS-it. Deri në fund të 2009 ai ishte ekspert në zyrën e shtabit për çështje parimore të HA-së për bashkëpunimin evropian dhe ndërkombëtar (EIZ), Berlin.

Dr. Habil Karsten Grabow është ekspert për bashkëpunimin ndërpartiak dhe parlamentar në HA EIZ të KAS-it, Berlin.

Isabel von Griesheim studion për Shkenca Politike dhe Ekonomike në Universitetin e Hajdelbergut. Në verën e vitit 2010 ajo përfundoi një praktikë tek Departamenti për Amerikën Latine në KAS, Berlin.

David Jonathan Grunwald është bashkëpunëtor shkencor në HA për Formimin Politik, Qendra e Formimit Schloß Eichholz e KAS-it, Veseling.

Christine Henry-Huthmacher është koordinatore e sektorit të politikës familjare në HA Politika dhe Këshillimi (PuB) të KAS-it, Shën Augustin.

Tim Kallweit ishte deri në fund të 2009 asistent projekti në HA EIZ të KAS-it, Berlin.

Dr. Patrik Keller është koordinator për politikën e jashtme dhe të sigurisë në HA PuB të KAS-it, Berlin.

Prof.Dr. Hans Jürgen Küsters është drejtuesi i HA Shërbimet Shkencore / Arkiva për Politikën Kristian-Demokrate të KAS-it, Shën Augustin.

Dr. Helmut Reifeld drejton zyrën e shtabit për çështje parimore në HA EIZ të KAS-it, Berlin.

Matthias Schäfer është drejtuesi i ekipit për Politikën Ekonomike në HA PuB të KAS-it, Berlin.

Frank Sprengler është zëvendës drejtor i Departamentit Qendror për Bashkëpunimin Evropian dhe Ndërkombëtar të KAS-it , Berlin.

Prof.Dr. Wolfgang Stock është Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë Convincent GmbH me seli në Berlin.

Prof.Dr. Rudolf Uertz është bashkëpunëtor shkencor në Departamentin Qendror (HA) për Shërbime Shkencore / Arkiva për politikën Kristian-Demokrate në Fondacionin Konrad Adenauer (KAS), Shën Augustin.

Prof. Dr. Hans-Joachim Veen është drejtuesi i Fondacioni Ettersberg në Vajmar i cili merret me hulumtimin krahasues të diktaturave në Evropë dhe tejkalimin e tyre. Nga viti 1983 deri në vitin 2000 ai ishte drejtuesi i institutit dhe drejtues i hulumtimeve në Fondacionin Konrad Adenauer.

Prof. Dr. Bernhard Vogel, ish-kryeministër është Drejtues Nderi i Fondacionit Konrad Adenauer qysh prej fillimit të vitit 2010, pasi e kishte qenë dy herë drejtues i KAS-it (1989-1995; 2001-fund 2009). Përveç mandatit në Bundestagun gjerman (1965-1967), Parlamentit të Landeve Rainland-Pfalz (1971-1988) dhe Tyingen (1994-2004) dhe shumë funksioneve të tjera politike profesor Fogeli ishte Kryeministër i Landeve Rainland-Pfalz (1976-1988) dhe Tyingen (1992-2003).

Klaus Weigelt në periudhën e viteve 1981 dhe 1992 ishte drejtuesi i Akademisë së KAS-it. Më pas ai ishte i ngarkuari i Fondacionit në Venezuelë dhe Hungari. Ndërkohë ai drejtonte Zyren Evropiane të KAS-it në Bruksel (1992-1998).

Reinhard Willig është ekspert për Argjentinën, Brazilin, Kilin dhe Uruguain si edhe për programet rajonale Politika Sociale në Amerikën Latine (SOPLA) dhe shteti i së drejtës (Montevideo dhe Meksikë DF) në ekipin e Amerikës Latine, HA EIZ e KAS-it, Berlin.

Anika Wirtz studion për Shkenca Evropiane në Universitetin e Mastrihtit. Në verën e vitit 2009 ajo përfundoi një praktikë në departamentin e politikës së jashtme të HA PuB të KAS-it në Berlin.